



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i shkencave (PI) në
Mjekësi Veterinare,
Universiteti Bujqësor i Tiranës**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.As. Dr. Valbona Aliko

Prof.As.Dr. Fatgzim Latifi

Gusht/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, përmbush misionin e tij për diplomimin e Mjekëveveterinerë të kualifikuar për të përballuar sfidat e zhvillimit të brendshëm dhe integritimit European, i përbërë nga një staf pedagogjik i kualifikuar, prej vitesh ku institucioni ka bërë përpjekje të vazhdueshme individuale dhe kolektive për të ngritur si nivelin e mësimit ashtu dhe të njohurive praktike dhe profesionale që i jepen studentëve.

Gjithsesi mbetet shumë për të bërë sidomos në këto momente kur përvojat e mësimdhënies në botë po përsosen vazhdimisht. Për shkak të një mangësie të vazhdueshme që ndjehet në edukimin veterinar për krijimin e një profili klinik tek studentët, mbetet detyrë e këtij institucioni forcimi i komponentit kërkimor dhe praktik si dhe lidhja e Fakultetit me praktikën e gjerë veterinarë ku studentët të kenë mundësi të marrin pjesë aktive në të gjitha fushat e aplikimit veterinar. Është kërkesë e kohës ristrukturimi i programit të studimit me qëllim përafrimin e tij me standartet e BE. Duke mbajtur në konsideratë faktin se cilësia në Arsimin e Lartë është më së pari përgjegjësi e vetë Institucioneve të Arsimin të Lartë, ky proces akreditimi duhet të shërbejë si bazë për ngritjen e një strukture të qëndrueshme për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe përmirësimin e performancës së njesisë bazë dhe atyre ndihmëse.

Ky raport është bazuar në Raportin e vetëvlerësimit 2019 që është realizuar nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, nga vizitat që ekspertët e jashtëm vlerësues realizuan pranë institucionit në datat 6 dhe 7 Qershor, 2019, në takimet e tij me stafin dhe studentët, si dhe në gjithë dokumentacionin e depozituar pranë ASCAL-it.

Fakulteti i përmbush **kryesisht** Standardet për fushën I “OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE”.

Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka përgatitur një program studimi i cili është në përgjithësi në përputhje të plotë me planet strategjike kombëtare dhe synon të përgatisë profesionistë të ardhshëm veterinerë, dhe është duke menduar të riorganizoje kurrikulën tërësisht. Në kushtet e reja të zhvillimit të tregut, rekomandohet që institucioni të ristrukturojë programin mësimor duke synuar përafrimin e tij me atë të vendeve europiane. Programi i propozuar ndjek rregulloren e BE-se 2005/36 dhe është gjithashtu në përputhje me statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Ai është përshtatur pjesërisht me modelin e Bolonjës me një program 3 + 2 vjet (BSC dhe Msc) të integruar dhe përmban konceptin e ECTS. Prandaj është pozitiv fakti që programi aktual është plotësuar me lëndë me zgjedhje që në vitin e parë.

Fakulteti i përmbush **kryesisht** Standardet për fushën II “ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË”

Nga shqyrtimi i programit të studimit të Mjekësisë Veterinare, tregon se, programi është ndërtuar në përputhje me legjislacionin dhe me aktet ligjore dhe nënligjore shqiptare. Kurrikula e kursit të studimit që realizohet me 300 ECTS dhe me kohëzgjatje normale pesë vite akademike është ndërtuar mbi bazën e Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ETCS) në përputhje të plotë dhe me Statutin e Universitetit dhe me Legjislacionin Shqiptar në Fuqi. Grupi i eksperteve të jashtëm rekomandon se ka nevojë për rishikimin tërësor të programit të studimit me qëllim arritjen e standardeve evropiane në fushën e mjekësisë veterinarë.

Fakulteti i përmbush **pjesërisht** Standardet për fushën III “MËSIMDHËNIA, MËSIMNËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT”

Statusi i kualifikimit të stafit përshtatet mirë me kërkesat e tregut të punës. Të diplomuarit kualifikohen për shërbim në institucione publike, shërbime dhe pozita menaxhuese në veterinarë dhe në zinxhirin e

furnizimit ushqimor. Duhet të zgjerohet elementi praktik në kuadër të programit sic janë vizitat dhe praktika në terren, ftesa për profesionistë të fushës nga sektori i veterinarisë, praktika të dorës së parë në klinika dhe thertore etj. Po ashtu duhet të mendohet që të krijohen kushte më të mira në laboratorët aktualë, të furnizohen ato me kimikate dhe pajisje laboratorike.

Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që cilësia e laboratorëve të mësimdhënies të përmirësohet, për të përmbushur mësimin e bazuar në praktikë dhe që çështjet e ngritura nga Anketimi i studentëve për përvojat e tyre të vlerësimit të hulumtohen.

Një vëmendje më e madhe duhet t'u kushtohet mjeshtrëve gjuhësorë, të prezantimit dhe negocimit.

Fakulteti i përmbush **kryesisht** Standardet për fushën IV “BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT”

Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se në Universitetin Bujqësor të Tiranës, respektivisht në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, rekrutimi, stafit bëhet sipas konkursit publik, duke u mbështetur në ligjin e Arsimit të lartë, statutin si dhe rregulloret për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrative. Dosjet e personelit Akademik ruhen në zyrën e Burimeve Njerësore pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Bëhet ruajtja dhe regjistrimi i të gjitha procesverbaleve të provimeve që i nënshtohen studentët në ZSS deri në diplomim, ruajtja e të dhënave është konfidenciale për secilin student të gjitha niveleve.

Gjatë vizitës së klasave, laboratorëve dhe mjediseve të tjera në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare GVJ konstaton se shumica e mjediseve mësimore janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies, por një pjesë e tyre ishin në procesin e rinovimit tërësor të tyre.

GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare buxhetin të cilin e harton për kryerjen e veprimtarive mësimore e shkencore nuk është i mjaftueshëm për realizimin e nevojave për programin cikli i dytë Master i Shkencave në Mjekësi Veterinare, por si të ardhura llogariten edhe të ardhurat nga donacionet dhe projektet.

Laboratorët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare shumica e tyre ishin të pajisura me pajisje laboratorike të cilat shërbenin për hulumtimet shkencore të Stafit Akademik, po ashtu edhe në klinikat kishte pajisje që ishin në shërbim të studentëve.


GVJ rekomandon Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka nevojë për pajisje të reja me qëllim të zhvillimit të programit e sidomos kërkimit shkencor, që të mbështetet nga Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Ministria e Arsimit.

GVJ rekomandon që të ripërtrihen marrëveshjet kombëtare dhe ndërkombëtare sidomos kushtet e veprimt në interes të zhvillimit të programit, po ashtu të zhvillohen edhe marrëveshjetë tjera.

Të pasurohet biblioteka me një numër më të madh titujsh tekstesh apo periodikësh në gjuhë të huaj.

Fakulteti i përmbush **kryesisht** Standardet për fushën V. “STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE”.

Ngritja e qëndrës së karrierës për studentët është një praktikë e mirë që ndihmon në informimin, orientimin e tyre në përmbushjen e pritshmërive të tyre. Grupi i ekspertëve të jashtëm rekomandon që kjo qëndër duhet të konsolidohet dhe të punojë më shumë në drejtim të gjurmimit të punësimit të studentëve pas përfundimit të programit të studimit.



Fakulteti i përmbush **kryesisht** standardet për fushën VI “SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT”

Pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës funksionon Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI). Pjesë e strukturës së kësaj dege është Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI). Në faqen ueb ofrohet edhe informacion i duhur për dokumentacionin e ofrimit të cilësisë.

GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare respekton Statutin e UBT-së dhe ligjin e Arsimit të lartë, si dhe rregulloret e brendshme të cilësisë të cilët në aktet juridike parashohin metodat e mundshme për sigurimin e cilësisë. Në bazë të Informacionit të ofruar nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare para tre viteve është caktuar komisioni për vlerësimin e cilësisë së brendshme, por ky komision nuk ka dhënë ndonjë kontribut sa i përket sigurimit të cilësisë brendshme.

GVJ rekomandon që të punohet më shumë në këtë drejtim.

Në përfundim: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se Standardet e Cilësisë së programit të integruar të MV janë përmbushur kryesisht në pesë fusha dhe janë përmbushur pjesërisht në një fushë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i programit të integruar Mjeksi Veterinare i ofruar nga FMV pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës u zhvillua nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (më tej GVJ) nëpërmjet konsultimit të kujdeshëm të gjithë dokumentacionit të depozituar pranë Agjensisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), si dhe vizitës së kryer në institucion, gjatë datave 6 dhe 7 Qershor, 2019.

GVJ përbëhej nga dy ekspertë të lartë vlerësimi të arsimit të lartë nga Tirana dhe Kosova.

GVJ iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe paketa e dokumentacionit mbështetës dy javë përpara vizitës së vlerësimit, të plotësuar me vonë me dokumentacion shtesë që u kërkua gjatë vizitës. Në tërësi, rreth 540 dokumente i mundësuan GVJ të njihet me strukturën, politikat, procedurat e drejtimit dhe administrimit dhe natyrën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të ndërmarrë nga FMV. Dokumentet përfshinin Statusin e Fakultetit, raportet vjetore, CV e stafit, programet e lëndeve, planin mësimor, listën e marrveshjeve ndër-institucionale, listën e publikimeve dhe projekteve të ndryshme të bashkëpunimit, shembuj të informacioneve të programeve dhe dokumentacion të anketimit të studenteve.

GVJ u takua me drejtuesit e lartë të FMV, grupin e punës për hartimin e raportit të vetëvlerësimit (GVB), studentët, lektorët, stafin administrativ dhe atë mbështetës, gjatë vizitës së vlerësimit. Diskutimi mbështeti sqarimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Në të gjitha takimet u mbajtën shënime.

Gjatë vizitës shëtitëse në kampusin kryesor dhe infrastrukturën ndihmëse, GVJ vizitoi auditorët, laboratorët, zyrat, sekretarinë, bibliotekën dhe ndoqi një demonstrim të sistemeve informative elektronike.

GVJ u mbështet nga përfaqësuesi i ASCAL, ME Renata Qatipi.

Më datë 09.08.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 44/60 Prot., datë 19.08.2019 "Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm", FMV, UBT është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm të programit të studimit *Master i Shkencave (PI)* në "Mjekësi Veterinare".

Më datë 20.08.2019, UBT përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 288 Prot., datë 19.08.2019, "Dërgohen komentet e FMV mbi Draft RVJ për programin e studimit të Ciklit të Dytë *Master i Shkencave (PI)* në "Mjekësi Veterinare", UBT. Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

GVJ, pasi u njoh me komentet e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm të FMV, mbi draft-Raportin e hartuar prej tij pas vlerësimit të Programit të studimit Msc (Program i të Integruar) në "Mjekësi Veterinare", pranë FMV, sqaron se:

Komenti i Institucionit

Nga leximi i raportit por edhe nga vlerësimi që kanë bërë edhe vetë ekspertët e jashtëm, konstatojmë që nga 6 standarte që përfshin fusha e parë, 3 prej tyre (sipas edhe vete mendimit të eksperteve) janë të përmbushur në masën "Kryesisht" dhe tre të tjerët në masën "Pjesërisht". Dekanati i FMV konsideron se për këtë fushë, vlerësimi më i pranueshëm për shkallën e përmbushjes duhet të jetë në nivelin "Kryesisht". Dekanati e argumenton këtë vlerësim mbështetur edhe në konstatimet e eksperteve për tre nga standartet e kësaj fushe që në mendimin tonë nuk janë thelbësore deri në atë masë sa të konsiderohen në shkallë e përmbushjes "Pjesërisht". Dekanati argumenton që edhe mesatarja e vlerësimit të standarteve të kësaj fushe është më pranë nivelit të përmbushjes "Kryesisht".

Në lidhje me vlerësimin e fushës së III "Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat", përsëri grupi i vlerësimit të brendshëm dhe anëtarët e dekanatit gjykojnë që

shkalla e përmbushjes e konstatuar nga ekspertet e jashtëm nuk reflekton tërësisht nivelin e konstatuar. Nga 8 standarte që ka kjo fushe, bazuar në vlerësimin e vetë ekspertëve, 5 prej standarteve janë vlerësuar nga ekspertët që përmbushen në shkallën “Kryesisht” dhe 3 standarte janë vlerësuar prej tyre që përmbushen në masën “Pjesërisht”. Më konkretisht, Dekanati në FMV sugjeron që standarti III.3 dhe standarti III.7 duhen rivlerësuar nga GVJ pasi mbështetur në komentet dhe vlerësimin e tyre, këto standarte duhet të konsideroheshin të përmbushura në një shkallë më të lartë sesa është paraqitur, d.m.th në shkallën e përmbushjes “Kryesisht”. Nga realizimi i procesit të rivlerësimit për dy fushat e përmendura më lartë, mendojmë se vlerësimi do të përputhet plotësisht me realitetin e FMV. Sidoqoftë, Dekanati i FMV është i ndërgjegjshëm që ka shumë punë për të bërë për të përmbushur në shkallë edhe më të larta të gjitha standartet e cilësisë së programit dhe raporti i GVJ do shërbejë si një pikënisje pozitive për të adresuar në të ardhmen zgjidhjen e të gjithë problematikave kryesore që ne kemi në fakultet.

Përgjigje e GVJ: Në hartimin e raportit të vlerësimit për programin e integruar të Mjekësisë Veterinare, grupi i ekspertëve të jashtëm, GVJ, është mbështetur në gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni pranë ASCAL, në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, në takimet me Drejtuesit e Institucionit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, takimin me stafin, studentët, vizitën në institucion dhe mjediset e tij. Në profesionalizmin dhe përgjegjësinë e tij të plotë, GVJ siguron drejtuesit e institucionit, se ai ka qenë realist në vlerësim, dhe rekomandimet e dhëna kanë qëllim vetëm përmirësimin e cilësisë së programit të ofruar. Si të tilla, ato kanë të bëjnë vetëm me ato lloj ndryshimesh që varen drejtëpërsëdrejti nga FMV, duke patur shumë mirë parasysh vështirësitë që lidhen me gjithë Arsimin e Lartë Shqiptar. E thënë kjo, mendojmë se gjetjet dhe rekomandimet e GVJ, veçanërisht lidhur me kriteret që vlerësojnë cilësinë e programit të studimit, janë me rëndësi të vecantë në sigurimin e cilësisë së standarteve të vlerësimit, dhe si të tilla, pavarësisht numrit të kriterëve të vecanta të vlerësuar si kryesisht të përmbushur, e çenojnë arritjen e standardit III në masën që të përligjë vlerësimin “I përmbushur pjesërisht”.

Në përfundim, duke u nisur nga fakti se verejtjet dhe rekomandimet kryesore të dhëna për Fushën I, kanë të bëjnë kryesisht me cilësinë e laboratorëve mësimorë dhe programit të studimit të cilat gjykohen më gjerësisht në Fushën III, GVJ vendosi të ndryshojë vlerësimin e përgjithshëm të Fushës I nga “I përmbushur pjesërisht” në “I përmbushur kryesisht”. Vlerësimi i Fushës II dhe III mbetet si më parë, respektivisht “I përmbushur kryesisht”, dhe “I përmbushur pjesërisht”.

Në mënyrë më të detajuar, GVJ paraqet argumentat për secilin koment të bërë nga Institucioni më poshtë”

Fusha I

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ: ‘GVJ konstatoi se pjesa më e madhe e tezave të diplomave janë teorike, dhe vetëm një numër shumë i vogël i tyre ka karakter kërkimor. GVJ pohon se mungesa e tezave të diplomës me karakter kërkimor çënon ...’ (në Standardin I.1 Kriteri 5)

Komenti i IAL¹: Duhet sqaruar se nuk është specifikuar qarte që një numër i konsiderueshëm i temave të diplomave janë në drejtim të shëndetit publik dhe sigurse ushqimore dhe kësaj nga vete karakteri i këtyre studimeve, pjesa më e madhe e tyre janë me drejtim epidemiologjik, studime të cilat konsiderohen gjithashtu kërkimore. Gjithashtu duhet sqaruar që në fusha të tilla si siguria ushqimore një pjesë të studimeve të tyre e kanë të lidhur drejtpërsëdrejti me legjislacionin veterinar, kontrollin në thertore apo si edhe studime mbi aplikimit të sistemit të HASAP-it në sigurinë ushqimore. Studime të tilla nuk mund të interpretohen si studime të drejtpërdrejta kërkimore shkencore por si studime mbi efektivitetin e aplikimit të një ligji në sigurinë ushqimore, apo tema të tjera si mbi edukimin në vazhdim, Vlen të përmendet që një

¹ Komentet e IAL janë marrë IDEM sic janë bërë në draftin e Raportit të dërguar në Institucion.

pjese e ketyre studimve te temave te diplomes ne drejtim te shendetit publik kane qene pjese e projekteve nderkombetare te fakultetitne keto fusha. Temat e Departamentit klinik kane qene teresisht

Përgjigje e GVJ: GVJ i qëndron këtij pohimi, pasi mendon se, pavarësisht përpjekjeve të FMV për të realizuar tema në epidemiologji apo fusha të ngjashme teorike, duhet punuar që studentët të kenë më shumë akses në kërkimin shkencor me natyrë laboratorike, i cili krijon eksperiencën e mjaftueshme dhe shprehitë e duhura praktike dhe jo vetëm deduktive, gjë që ndikon ndjeshëm në rritjen e aftësive kërkuese dhe zgjidhjes së problemeve praktike me të cilat do të përballlet një mjek veteriner në profesion. Ky pohim mbështetet edhe në mendimet e marra gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ: Nga takimi i GVJ me studentët, u pa qartë se programi mësimor ka nevojë për një rishikim të thellë, për të vënë në raport të drejtë lëndët bazë profesionale me lëndët dytësore, si në drejtim të shtrirjes së tyre në semestra, ashtu edhe të shlyerjes së detyrimit vjetor. GVJ pohoi se mosruajtja e një ekuilibri të drejtë midis informacionit të ofruar mëpërmjet syllabuseve mbi kafshët bujqësore/ekonomike dhe atij mbi kafshët e shoqërimin, do kishte rrezik për përmbushjen e Standardit 1.2' (në Standardin 1.2 Kriteri 3)

Komenti i IAL: Kurikulumi i Fakultetit ne disa raste ka lende te cilat nuk duhet te shtrihen gjate gjithë vitit. Ne kuadrin e nderhyrjes 20% te kurikulimit keto disbalance do te rregullohen. Informacioni teorik dhe praktik sasior qe marrin studentet mbi Kafshet bujqesore dhe Kafshet e shoqerimit eshte ne raport te drejte. Shtrirja e tyre ne semestra duhet rishikuar ne varesi te ndryshimve kurikulare qe do te realizohen ne kete fillim viti akademik

Përgjigje e GVJ: GVJ i qëndron fort nevojës për një rishikim të thellë të programit të studimit, për disa arsye:

- Kurrikula e MV ka një shpërndarje të pabarabartë të krediteve ndër semestra dhe ndër vite: Viti I dhe II kanë një shpërndarje në kredite ndërmjet semestrave, por ajo është e pabarabartë duke rënduar më shumë semestrin e II; ndërsa Viti III dhe IV ka shpërndarje tërësisht të pabarabartë, të përqëndruara vetëm në semestrin II. Ky kriter vjen në kundërshti me Procesin e Bolonjës.
- Sipas Bolonjës, lëndët duhet të organizohen me module që mbyllen me provime në fund të një semestri. Edhe ky kriter është i cënuar. Psh. Lënda e të ushqyerit, lëndë vjetore, jepet si firmë, apo Anatomia që ngjeshet duke qenë lëndë e gjerë (në një kohë që koncepti firme nuk ekziston sipas Bolonjës). Ka lëndë që kanë të njëjtin numër orësh në auditor dhe kanë numër të ndryshëm kreditesh.
- Teza e Diplomes figuron pa kredite.
- Kohëzgjatja e studimeve (9 +1 semestra) kur programe analoge në vendet e Evropës e kanë 12 semestra (p. sh. Universiteti i Zagrebit). Kjo pikë mendojmë që kërkon rishikim sidomos në kushtet që FMV aktualisht nuk afron ende asnje program specializimi në kuadër të ciklit të tretë.
- Nga analiza e shpërndarjes së orëve dhe diskutimit me studentët, duket se pjesa më e madhe e lëndëve zhvillohet nga 1 pedagog. Mendojmë se zhvillimi i moduleve të një lënde nga të paktën 2 pedagogë (theksojme se lënda ka gjithnjë vetem 1 titullar) do të shmangte krijimin e monopolit në një lëndë, do të krijonte mundësinë që studentët të përthithnin dijen nga këndvështrime të ndryshme ekspertesh, do të mundësonte dhe lehtësonte zhvillimin e lëndëve ndërdisiplinore gjë që do të zgjeronte larinë e kurseve të ofruara nga institucioni për t'ju përgjigjur më mirë ndryshimeve shpejta të tregut të punës, dhe së fundi do të përmirësonte cilësinë e mësimdhënies dhe kontrollit të saj.

- Programet (syllabuset) e lëndëve të caktuara nuk janë në përputhje me sasinë dhe cilësinë e informacionit qëi duhet një veterineri (p.sh. botanika programi i së cilës është i njëjtë për të gjitha programet e studimit të UBT, pa specifika sipas degëve);
- Në kurrikulën e FMV ka lëndë që shtrihen 1 vit ose më gjatë. Sipas Bolonjës lënda duhet të ndahet në module që përfundojnë me provime në 1 semestër. Kjo do të sillte edhe rregullimin e krediteve për modul dhe shpërndarjen e tyre ndër semestra.
- GVJ mendon se ndryshimet e kërkuara i kalojnë përmirësimet e programit (të lejuara (deri 20%, pa nevojën e rishikimit të dosjes në Ministrinë e Arsimit) dhe në këto kushte, Institucioni duhet ta shohë këtë pikë më përparësi; Kjo edhe me synimin për tu përafuar me kurrikulat e fakulteteve të veterinarisë në evropë. GVJ nënvizon se në këto përfundime ka arritur edhe vetë GVB në Raportin e tij të vetëvlerësimit. GVJ nuk mund të gjykojë mbi ndryshime të programit të pretenduara nga institucioni dhe të pambështetur me dokumenta zyrtarë (kujtojmë se gjatë takimeve me drejtuesit dhe GVB u pranua se ka ndërmendje për të ndryshuar programin duke u bazuar mbi disa modele, por ende s'ka iniciativa konkrete të dokumentuara).

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.2 Kriteri 4): Fakulteti i Mjekësisë Veterinare nuk është i vetmi institucion i lartë arsimor në fushën e Mjekësisë Veterinare në Shqipëri dhe trojet shqipfolëse, ashtu sikundër pretendon raporti i vetëvlerësimit. Tashmë, një i tillë prej 10 vitesh funksionon në Kosovë/ Prishtinë

Komenti i IAL: Nga institucionet e Arsimit te Larte ne trojet shqipfolëse, FMV është I vetmi Institucioni Veterinar I cili egziston si Fakultet nderkohe qe ne Prishtine dhe Maqedonine e Veriut ky institucion është ne shkalle Departamenti. Fakulteti I Mjekësisë Veterinare ka dhene kontribut te rendesishem ne themelimin dhe vazhdimesine e procesit mesimor te Departamentit te Veterinarise prane Fakultetit te Bujqesise dhe Veterinarise ne Prishtine. Prej vitit 2000 deri 2010 stafi akademik I FMV ka qene pjese aktive dhe e rendesishme ne ecurine e ketij Departamenti.

Përgjigje e GVJ: GVJ i qëndron këtij pohimi, sepse pavarësisht se në Kosovë, Veterinaria është Departament dhe jo Fakultet, ka tashmë mbi 10 vite (20 vjet) që funksionon dhe me një prurje mesatare 70 studentë/vit. Në këto kushte, FMV është unik në territorin shqiptar dhe kjo mbetet përparësi e tij. Gjithsesi ky pohim nuk është esencial në vlerësimin e standardit të cilit i përket.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.3 Kriteri 2): Institucioni duhet të punojë më shumë për të vendosur lidhje me biznesin vendas për realizimin e praktikave të punësimit (internship) me synim punësimin e studentëve më të mirë.

Komenti i IAL: Vlen te ritheksohet se Fakulteti I Mjekësisë Veterinare deri me sot ka krijuar marrveshje bashkpunimi nderinstitucionale me: Ministrine e Bujqsise dhe Zhvillimit Rural ku vit pas viti studentet shume cilsore jane punesuar ne sektorin e veterinarise nga Programi Kombetar i Punsimit si edhe nga Projekte te ndryshme si psh. Projekti Paza (Projekti I Mbrojtejes se Konsumatorit nga Semundjet Zoonotike, I financuar nga Bashkimi Europia).Nderkohe shume studente te Fakultetit tone jane angazhuar ne Institucione Nderkombetare si kerkimore dhe ne Kompani private te huaja. Vlen te permendet gjithashtu edhe punesimi I studenteve te sapodiplomuar ne qendra private biznesi, klinika dhe spitale veteriare, ferma te ndryshme, industri ushqimore, si edhe ne AKU, ISUV etj, është tregues I praktikave te realizuara paraprakisht nga studentet ne te tilla institucione.

Përgjigje e GVJ: GVJ e ka vlerësuar si praktikë të mirë lidhjet që FMV aktualisht ka vendosur me disa biznese private, por duke parë listën e marveshjeve të vendosura, mendon se duhet punuar më shumë për tu lidhur me biznese private fermash, industry ushqimore etj, ku studentët të praktikohen efektivisht. Ky problem u evidentua edhe nga studentët të cilët duan të jenë pjesë aktive e fermave apo kompanive ku shkojnë dhe jo thjesht vzhgues. Pse jo të importohen edhe praktika të mira të vendeve fqinje, si Zagrebi p.sh, ku të organizohen praktika me klinika të lëvizëshme ku studenti i drejtuar nga stafi (raporti 4 staf-15 studentë) duke lëvizur në territor të jetë më afër rasteve praktike. Vetë GVB në raportin e tij të vetëvlerësimit thekson se: *Megjithatë duhen shtuar këto marrëveshje edhe me aktorë të tjerë*;.. *Këto marrëdhënie zyrtare në përgjithësi nuk janë shumë të mbikqyrura nga punëdhënësit dhe konsiderohet një mangësi në zbatimin e programit të studimit*".

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.3 Kriteri 7): GVJ konstaton se përqindja e studentëve të përfshirë në këto mobilitete është ende i ulët dhe më shumë punë duhet bërë për njohjen e krediteve të transferuar me qëllim rritjen e numrit të studentëve përfitues

Komenti i IAL: Duke u nisur nga statistikat e tre viteve të fundit Fakulteti I Mjeksisë Veterinare është një nga fakultet me aktive në kuader të realizimit të mobiliteteve të studenteve nepermjet Projektit Ceepus dhe Projektteve Erasmus. Se fundmi janë realizuar edhe programet sezonale të intershipeve. Por duhet theksuar dhe sqaruar që studentent të cilët dergohen në institucionet respektive në baze të programve të siperpërmendura duhet të kenë minimumet e kriterëve si (mesatarja, gjuha e huaj), Nderkohe ecuria e mobiliteteve varet edhe nga performance individuale të studenteve dhe pedagogëve në institucionet përkatëse nderkombetare.

Përgjigje e GVJ: Nga konsultimi me listën e lëvizjes së studentëve me programe ERASMUS në rang Universiteti shihet se janë rreth 100 studentë në vit. Ky numër i ulët i lëvizjes, përveç shkaqeve të tjera, ndikohet edhe nga transferueshmëria e krediteve, gjë që sipas GVJ vështirësohet edhe nga tipologjia e lëndëve në kurrikulën e FMV (lëndë të shtrira në më shumë se 1 vit dhe numri i krediteve). Kjo u pranua edhe në takimin e GVJ me GVB bërë në institucion.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.3 Kriteri 7): GVJ verëson se Fakulteti nuk ka ndërtuar një proces për vlerësimin dhe transferimin e krediteve të fituara në institucionet e huaja të arsimit të lartë, si dhe të ofrimit të leksioneve në gjuhë të huaj. GVJ sugjeron se ky duhet të jetë synimi afat shkurtër i stafit të FMV

Komenti i IAL: Studentet që kanë qene pjese e projekteve Erasmus dhe Ceepus kanë realizuar transferimin e krediteve prane Fakultetit bazuar ne Rregulloren e FMV dhe Universitetit Bujqesor. Nderkohe ka filluar procesi I realizimit te leksioneve ineraktive te inequara ne gjuhe te huaj. Prane Biblotekes se Fakultetit eshte ngritur nje salle per realizimin e mesimdhënies në distance (Teaching in distance) me infrastrukturen e videokonferencave.

Përgjigje e GVJ: GVJ nuk gjeti ndonjë dokument mbi këtë procedurë.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.5 Kriteri 1): Komisioni i Praktikës nuk funksionon si duhet. Mungon monitorimi i studentëve dhe formimi i tyre profesional lë për të dëshiruar

Komenti i IAL: Monitorimi i studenteve, realizohet edhe nga drejtusit e institucionit (ne vendet ku realizohet praktika si Instituti I Sigurise Ushqimore te Veterinarise, Autoriteti kombetar I Ushqimit, Spitali Veterinar, Klinika dhe Farmaci Veterinare) nga supervizoret e autorizuar. Prane Fakultetit eshte ngritur Komisioni I Praktikave Profesionale qe drejtohet nga nje Kordinator te cilet ne bashkepunim me supervizoret e autorizuar monitorojne Praktikate Profesionale.

Përgjigje e GVJ: Këtë përfundim GVJ e mbështeti në mendimet e dala nga takimi me studentët si dhe me stafin gjatë vizitës në laboratore. Studentët pranuan se shkojnë në praktika dhe më së shumti nuk kanë kontroll nga ana e pedagogëve; stafi gjithashtu pranoi se ndjekja e praktikave është e vështirë për shkak të ngarkesës së madhe që ata kanë si dhe numrit të madh të studentëve në grup-praktika. Gjithashtu, GVB në raportin e tij të vetevlerësimit thekson se: *“Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, komisioni i praktikave profesionale nuk funksionon si duhet për të siguruar një mbarëvajtje të mirë të programit. Në shumicën e rasteve studentët nuk monitorohen gjatë kësaj periudhe dhe formimi i tyre profesional nuk është i kënaqshëm”*.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.6 Kriteri 1): *‘...ndërkohë që theksojnë se mbështetja financiare është shumë e vogël’....*

Komenti i IAL: Per kerkime te thelluara shkencore fondi eshte I limituar.

Përgjigje e GVJ: GVJ për këtë konfirmim nuk ka koment. Kjo është e vërtetë edhe pse institucioni mundet vetëm të bëjë vazhdimisht presionin e duhur pranë autoriteteve të UBT për rishikimin e fondeve si dhe të përpiqet më shumë për të thithur projekte ndërkombëtare.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 1.6 Kriteri 4): *‘...konstaton, se nuk ka ende programe funksionale të kontrollit të plagjaturës në nivel Departamenti apo Fakulteti, c’ka çënon përmbushjen e kriterit 4 të Standardit I-6.*

Komenti i IAL: Rregullorja e plagjatures eshte ne process. Procesi I implementimit te programeve kompjuterike te kontrollit te plagjatures do te menaxhohet ne shkalle Universiteti. Per kete qellim jane pergatitur dhe miratuar ne Senatin Akademik te UBT Rregulloret dhe teknikalitetet e ketij procesi.

Përgjigje e GVJ: GVJ mendon se ky konstatim është i saktë dhe gjithashtu pranon se është një politikë e varur nga UBT. Për këtë arsye, sic është sqaruar edhe në hyrje, GVJ e rishikoi vlerësimin e Fushës I.

Përfundime:

Vlerësimi i Standardit I.6 ndryshon nga “Përmbushet pjesërisht” në “Përmbushet Kryesisht”

Vlerësimi tërësor i ‘Fushës I’ ndryshon nga “Përmbushet pjesërisht” në “Përmbushet Kryesisht”

Fusha II

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.1 Kriteri 2): *‘...por vëren se ka mangësi në formimin e mjekut veteriner për kafshët bujqësore.*

Komenti i IAL: Klinikat e kafsheve perfshjne Klinikat e kafsheve te medha (stacionet veterinare ku dergohen nje pjese e konsiderueshme e studenteve per praktika profesionale) dhe Klinikat e kafsheve te vogla.

Se fundmi po investohet fuqishem nga Ministria e Bujqesise dhe Zvhvillimit Rural per permirsimin e Qendres Didaktike dhe Eksperimentale Studentore ne UBT. Ne kete qender zhvillohen pjesa me madhe e praktikave didaktike mesimore kryesisht te kursit te IV dhe te V te studenteve. Nje nga fokuset kryesore te programit te studimeve ne Fakultet eshte pergatitja e Mjekeve te ardhshem veteriner per Kafshet e Fermave. Tradicionalisht ne FMV drejtimi kryesor ka qene dhe eshte problematika e kafsheve te fermave.

Përgjigje e GVJ: GVJ i qëndron vlerësimit të mësipërm, sepse ka parasysh formimin praktik në lidhje me kafshët e mëdha, për shkak të mungesës së infrastrukturës (spitalit të kafshëve të mëdha, fermës, thertorës) pranë FMV dhe eficiencës së ulët të praktikave mesimore. Të gjitha përpjekjet për ndryshimin e situatës, edhe pse në fillesa, janë vlerësuar si praktike të mirë, por derisa këto të realizohen konkretisht, duhet të jenë të pranishme në raport. GVJ thekson se ai nuk mund të bazohet mbi deklaratime të pambështetura me dokumentacion apo vëzhgime në institucion.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.2 Kriteri 5): ‘... (laboratori i cilësisë së ushqimit) ...

Komenti i IAL: Ne fakultet ka disa laboratore që kryejnë aktivitete cilësisht formuese, akademike dhe didaktike. Disa nga personeli ndihmes iu është krijuar mundësia për tu trajnuar në kuadrin e projekteve Erasmus, Cost, etj. Një pjesë të punëve në laboratore e kanë mbuluar dhe personeli kerkimor së bashku me studentet e doktoraturave.

Përgjigje e GVJ: Mungesën e politikave për trainimin e vazhdueshëm profesional të personelit ndihmës, dhe në ndonjë rast të mungesës së personelit ndihmës ku rolin e tij e kryen pedagogu, GVJ e konstatoi gjatë takimit me stafin gjatë vizitave në laboratore (Laboratori i cilësisë së ushqimit theksoi mungesën e stafit teknik që të ketë përgatitjen e duhur shkencore dhe profesionale). Gjithashtu, mungesën e politikave e thekson edhe GVB në raportin e vetëvlerësimit.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.3 Kriteri 7): ‘Gjatë kësaj kohe nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë për rishikimin thelbësor të kurrikulës, gjë që rrezikon përmbushjen e Standardit II-3

Komenti i IAL: Ne muajin mars të vitit akademik 2018/2019 është realizuar një mbledhje asambleje pas marrjes së opinioneve në nivel departamentesh për rishikimin e kurrikulës sipas modeleve europiane. Aktualisht po punohet për rishikimin e kurrikulës së fakultetit bazuar në kërkesat e studenteve si dhe përshtatjen me përvojat me të mira europiane (Itali, Zagreb, Budapest).

Përgjigje e GVJ: Ky është një konfirmim i bërë nga vetë GVB si dhe i konstatuar gjatë takimit me drejtuesit, grupin e hartimit të raportit të vetëvlerësimit dhe stafin akademik.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.4 Kriteri 7): ‘GVJ pohon se përmbajtja dhe strukturimi i programit të studimit në mjekësi veterinarë nuk garanton arritjen e objektivave të tij dhe nuk përshtatet me nivelin e studimit të integruar të ciklit të dytë për formimin e figurës së mjekut veterinar të përgjithshëm.

Komenti i IAL:Mendojme se ky pohim eshte shume I rende per rastin e Fakultetit te Mjekesise Veterinare. Programi I FMV eshte I mbeshtetur ne pervojat me te mira bashkekohore Europiane. Shume nga studentet tane e kane ekuivalentuar diplomen e Mjekut veteriner dhe sot punojne me shume sukses ne vendet e Europes dhe me gjere. Pas vitit 2000 ne kemi implementuar dhe po ecim ne baze te modelit gjerman. Shume pedagoge jane trajnuar dhe kane marre eksperiencia ne kuadrin eprojekteve Tempus ne vende te tilla si Gjermani, Itali, Austri, Zagreb, etj. Aktualisht shume student qe kane levizur me studime te tipit intership jane paraqitur ne menyre ekselente dhe jane vleresuar ne praktika shume pozitivisht, madje shume me mire se sa studentet nga fakultetet e tjera te BE. (Kjo eshte e dokumentuarnga raportet qe kane dhene supervizoret e institucioneve nderkombetare).Edhe nga raportet e disa Institucioneve nderkombetare (si p.sh. EAVE, FVE) Programi I studimeve te Fakultetit tone eshte vleresuar shume pozitivisht.

Përgjigje e GVJ: GVJ pranon se formulimi i frazës së mësipërme ka dale i rënduar dhe ka nëvojë për një riformulim për të ndarë faktin që emërtimi i lëndëve është i krahasueshëm me atë të programeve të ngjashme të vendeve të tjera, dhe se gjithë rekomandimet e GVJ janë të lidhura me strukturën e programit. Në këto kushte, ky pohim është riformuluar (shiko në raport).

Megjithatë, GVJ i mbetet rekomandimit të tij për rishikim të thellë të programit të studimit, për të gjitha arsyet e renditura edhe më lart.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.4 Kriteri 10): '...nuk ka ende nje program studimi të nivelit të tretë funksional

Komenti i IAL:Per kete qellim po behen tentative qe ne miratimin e buxhetit te ardhshem, nje pjese e fondit per kerkim dhe praktika profesionale te shfrytezohet per realizimin e kerkimit ne Masterin Shkencor. Cikli I trete I studimeve eshte ndrepre qe ne vitin 2013, por programet e studimit per kete cikël egzistojne te miratuara. Nderkohe cdo kandidat per doktorature ben paraprakisht nje deklarate vetfinacimi sipas se ciles mbulohet cdo shpenzim financiar I lidhur me kerkimin nga vete doktoranti.

Përgjigje e GVJ: GVJ pohon gjetjet aktuale, të 5 viteve të fundit për të cilat bëhet edhe vlerësimi i programit.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.6 Kriteri 2): 'Studentët pranojnë se mendimi i tyre nuk merret në konsideratë; ndërkohë që stafi akademik mendon se opinionet e studentëve nuk jepen me përgjegjësi, dhe si të tillë e bëjnë të vështire marrjen parasysh të tyre në vlerësimin e performancës së stafit akademik.

Komenti i IAL:Ne Janar te 2019 u realizua nje anketim ku student u shprehen per disa fenomene negative.Keto anketime u diskutuan ne mbledhjen e Asamblese Akademike te Fakultetit dhe u shoqeruan me disa masa kundrejt disa pedagogeve. Nderkohe, po mbi bazen e ketyre anketimeve u hartua dhe u realizua ne muajt ne vijim nje Plan masash (I cili ndodhet ne Dekanat). Javen e fundit te procesit mesimor te Semestrit te dyte, u realizua ne nivel fakulteti nje anketim nominal per performance e pedagogeve. Rezultatet e ketij anketimido te pasqyrohet ne formen analitike statistikore ne mbledjen e ardhshme te Asamblese Akademike ne muajin Shtator 2019.

Përgjigje e GVJ: Në këto përfundime GVJ doli nga takimet me stafin akademik, studentët dhe me përfaqësuesin e zyrës së Cilësisë Mësimi dhe Vlerësimit të Kurrikulës. Studentët pranuan se mendimet e tyre edhe pse adresohen pranë autoriteteve nuk marrin zgjidhje, dhe se lëvizjet e fundit, të cilave IAL i referohet, ishin në përgjigje të grevës së studentëve. Gjithashtu edhe stafi pohoi se mendimi i studentëve, përgjithësisht nuk është në lartësinë e duhur për t'u marrë në konsideratë. Të gjitha këto, tregojnë se rekomandimi i GVJ për të adresuar shqetësimet e studentëve, qëndron.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.7 Kriteri 5): Lidhur me mbështetjen financiare të kërimit shkencor, GVJ pohon se prej shumë vitësh ka patur një mungesë të mbështetjes për kërkim shkencor nga Universiteti për departamentet.

Komenti i IAL: Ne kuader të mbështetjes së UBT qeveria shqiptare nepermjet Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural ka akorduar nje fond prej 1 000.000 euro per kerkimi dhe zhvillim. Nderkohe qe kemi fituar nje projekt per ngritjen e nje qendre laboratorike me qellim kerkimor dhe sherbim ndaj te treteve.

Përgjigje e GVJ: Sqarimi që GVB bën në lidhje me këtë pikë, ka të bëjë me iniciativa, realizimi i të cilave i takon të ardhmes së afërt, por GVJ vlerëson mbi atë ç'ka gjen në dokumentacion dhe konkretisht, edhe pse është i vetëdijshëm që problematika është komplekse dhe varuar nga shumë aktorë. Pavarësisht nga kjo, GVJ ka patur kujdesin të rekomandojë detyra që varen plotësisht nga autoritetet drejtuese të institucionit.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 2.8 Kriteri 1): Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se infrastruktura shkencore është e vjetëruar dhe e pamjaftueshme për të mbështetur kërkimin cilësor'

Komenti i IAL: Prane Fakultetit egzistojne dy laboratore (Lab. semundjeve infektive dhe lab. i Sigurise ushqimore) me aparatura modern bashkekohore.

Ne kete kuader eshte aplikuar dhe fituar nje projekt "Building Capacity " per ngritjen e nje qendre laboratorike kerkimore/ didaktike, me infarstruktura moderne, sipas standarteve te Bashkimit Europian prane Fakultetit te Mjeksise Veterinare.

Përgjigje e GVJ: Ky konstatim është një fakt dhe i pranuar edhe nga vetë GVB. Vlerësimi i GVJ,i takon pjesës më të madhe të laboratorëve, përtej 2 apo 3 laboratorëve shkencorë (të cilët janë vlerësuar si praktikë e mirë).

Përfundim: Vlerësimi tërësor i 'Fushës II' nuk ndryshon

Fusha III

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 3.2 Kriteri 4): '...kategorive Profesor dhe Doktor'

Komenti i IAL: Ne FMV ka dhe nje numer te konsiderueshem Profesor i asocuar te cilet kane pervoje bashkekohore dhe jane titullare lendesh apo grupp lendesh.

Përgjigje e GVJ: Kjo vërejtje është irrelevante, pasi kategoria Profesor përfshin si titullin Prof. Dr ashtu edhe Prof. Asociuar. Dr (në Ligjin e Arsimit të lartë nr. 80/2015).

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 3.3 Kriteri 2): '...FMV nuk ka një thertore'

Komenti i IAL:Gjithe aktivitetin e tij praktik klinik Fakulteti e realizon prane Ferme Didaktike Eksperimentale. (FDE). Kjo ferme ka fituar projektin kombetar prej 1 million Euro dhe eshte ne kuadrin e ristrukturimit. Nderkohe Fakulteti ka kontrata me disa thertore prane ambjenteve te tij te cilat furnizojne fakultetin gjate gjithe vitit me organe si dhe ku studentet kryejne praktika profesionale.

Përgjigje e GVJ: GVJ mendon se kjo gjetje është një fakt dhe nuk mendon se duhet hequr nga raporti.

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin 3.3 Kriteri 3): ‘...Infrastruktura IT nuk është shumë e konsoliduar në FMV.

Komenti i IAL:Sistemi kompiuterik dhe internet ne fakultet kane funksionuar normalisht me ndonje perjashtim kur ne rrethinat e Universitetit Bujqesor nuk ka patur furnizim me energji elektrike. Ne Webin e Universitetit jane pasqyruar dhe freskohen azhdimish materialet didaktike ne ndihme te studenteve si dhe aktivitete te rendesishme kerkimore shkencore.


Përgjigje e GVJ: Për të dhënë këtë konstatim, GVJ u bazua në problematikat e dala nga takimet me stafin dhe studentët. Gjithashtu, kjo është në përputhje edhe me vlerësimin e GVB në raportin e vetëvlerësimit: “*Infrastruktura IT nuk është shumë e konsoliduar në FMV*”. Aktualisht në FMV platforma on-line (e-learning) nuk funksionon në mënyrë korrekte përveç dy lëndëve që e përdorin në mënyrë të zakonshme” (citim nga raporti i vetëvlerësimit).

Mosdakortësia e Institucionit për paragrafin e RVJ (në Standardin III.7 Kriteri 10): ...CEEPUS

Komenti i IAL:Edhe projekti Erasmus eshte realizuar dhe vleresuar shume mire.

Përgjigje e GVJ: Komenti është i pavend, sepse dhe mungesa e fjalës ERASMUS nuk është penalizim. Jemi mjaftuar me një shembull (CEEPUS) në këtë rast.

Përfundim: Vlerësimi tërësor i ‘Fushës III’ nuk ndryshon



Vlerësimi i Programit të Integruar të Studimit të Ciklit të Dytë,

Master i Shkencave në “MJEKËSI VETERINARE”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi master i shkencave në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron program të integruar studimi “Master i shkencave” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	GVJ vlerëson se Universiteti Bujqësor ofron një program të integruar të studimeve “Master i shkencave” në Mjekësi Veterinare, i cili është hartuar në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe mbështet politikat kombëtare dhe planet strategjike të parashikuara të Qeverive Shqiptare (L. 80/2015: Neni 1, Shkr “d”; Statuti UBT, Neni 2, pika 1, 7 dhe neni 59, pika 1).
Kriteri 2. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Gjithashtu programi synon të kontribuojë në përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm veterinerë, i udhëhequr nga koncepti bashkëkohor i mjekut veteriner si specialist që zbatojnë vlerat dhe parimet më të mira të profesionit të veterinerit sipas objektivit “Një Botë Një Shëndet”. Në këtë mënyrë programi i integruar synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kontribon në edukimin me vlerat më të mira morale për të siguruar praninë e specialistëve të aftë profesionalisht dhe të pastër moralisht në gjendje për të çuar përpara procesin e zhvillimit ekonomik e shoqëror në Shqipëri. (L. 80/2015: Neni 5, Pika 2, ç; Plani Strategjik UBT 2016-2025, Pjesa e Parë, Kapitulli 1, faqe 5-7 dhe kapitulli 4, faqe 33-34).
Kriteri 3. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi është hartuar duke mbajtur parasysh zhvillimin ekonomik të vendit dhe perspektivën e integritit evropian, si dhe korrespondon me Deklaratën e Profesioneve të Rregulluara. Gjithashtu në hartimin e programit të studimit ishte mbajtur parasysh dhe realizuar pjesërisht unifikimi me programe të Universiteteve evropiane. Që programi i ofruar të ishte në përputhje me zhvillimin ekonomik lokal/kombëtar, kishte përpjekje për ta orientuar drejt mjeksisë së kafshëve individuale (kafshë të vogla, qen dhe mace) me argumentimin se kjo krijon mundësi më të mëdha punësimi në klinikat veterinarë të kafshëve të vogla dhe farmacive veterinarë, numri i të cilave vitet e fundit është rritur ndjeshëm në vendin tonë.
Kriteri 5. Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor;	Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë në FMV, realizohet me 300 kredite dhe me kohëzgjatje normale prej pesë vite akademike. Studimet përfundojnë me realizimin e tezës së diplomës (L. 80/2015: Neni 75, Pika 3, 4). Si i tillë vlerësojmë se Programi i integruar i studimit garanton formimin e duhur teorik për ndjekjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve si doktoratë ose kurseve të ndryshme të kualifikimit profesional. GVJ konstatoi se pjesa më e madhe e tezave të diplomave janë teorike, dhe vetëm një numër shumë i vogël i tyre ka karakter kërkimor. GVJ pohon se mungesa e tezave të diplomës me karakter kërkimor çënon

	formimin e plotë profesional dhe aftësimin e studentëve për të ndjekur studimet e thelluara të ciklit të tretë, duke rrezikuar kështu edhe përmbushjen e <i>Standardit 1.1</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi I.2	
Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” në “Mjekësi Veterinare” është i hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p> <p><i>(Plani strategjik UBT, Pjesa e Parë, Kapitulli 1, faqe 5, 13 Statuti, neni 2, pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7; neni 59 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6).</i></p> <p>Grupi i vlerësuesve të jashtëm konstatoi se studentëve u ofrohen mundësi për vazhdimin e formimit të tyre në specialitete më të ngushta dhe në nivele të mëtejshme të studimeve profesionalizuese dhe kërkimore shkencore, të cilat përputhen me strategjitë zhvillimore të Universitetit, Plani strategjik</p> <p><i>(Pjesa e Parë, kapitulli 3, faqe 14-27, kapitulli 4, faqe 33-41; Mendimi i Dekanit, dok.nr.3)</i></p> <p>GVJ vlerëson si eksperiencë pozitive trainimet e ndryshme në vazhdimësi që ju jepen studentëve, pas mbarimit të studimeve, si përpjekje për të përafruar ata me nevojat e tregut</p> <p><i>(Trainimet, dok.nr.549).</i></p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se ka mangësi në aftësimin e studentëve në profilin praktik klinik, si rrjedhojë e mungesës së klinikave funksionale, sidomos për kafshët e mëdha bujqësore (janë në rikonstruksion të zgjatur për mungesë fondesh).GVJ vlerëson si praktikë të mirë, përpjekjen e Fakultetit për lidhjen me bizneset privatë për të siguruar një lidhje të mësimit me praktikën e gjerë veterinare ku studentëve ju mundësohet të marrin pjesë aktive në të gjitha fushat aplikimit veterinar</p> <p><i>(Lista e Marveshjeve, dok.nr.434).</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i integruar i studimit “Master i shkencave” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” është i hartuar në përputhje dhe në zbatim të drejtimeve prioritar akademike të përcaktuara në statutin dhe Rregulloren e institucionit</p> <p><i>(Statuti, neni 2, pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7; neni 59 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6; Plani strategjik, Pjesa e Parë, kapitulli 3, faqe 14-27, kapitulli 4, faqe 33-41).</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në</p>	<p>Gjatë vizitës dhe diskutimeve GVJ vuri re se programi i studimit realizohej nga një bashkëpunim deri diku i suksesshëm ndërmjet katër Departamenteve. U konstatua se Programi i studimit nuk ishte përditësuar</p>

<p>përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>prej disa vitesh dhe po bëheshin përpjekje për ta rishikuar.</p> <p>GVJ rekomandon që programi i studimeve duhet përafruar me modelet më të mira dhe të suksesshme rajonale/evropiane në fushën e veterinarisë (Modeli Hungarez, Kroat, Italian).</p> <p>Nga takimi i GVJ me studentët, u pa qartë se programi mësimor ka nevojë për një rishikim të thellë, për të vënë në raport të drejtë lëndët bazë profesionale me lëndët dytësore, si në drejtim të shtrirjes së tyre në semestra, ashtu edhe të shlyerjes së detyrimit vjetor. GVJ pohoi se mosruajtja e një ekuilibri të drejtë midis informacionit të ofruar mëpërmjet syllabuseve mbi kafshët bujqësore/ekonomike dhe atij mbi kafshët e shoqërimin, do kishte rrezik për përmbushjen e <i>Standardit 1.2</i>.</p> <p>Përdoret gabimisht termi “firmë”, për lëndët me vlerësim të vazhduar. Grupi ekspertëve pohon se ky term duhet hequr duke respektuar detyrimin që rrjedh nga Sistemi i Bolonjës.</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga institucioni si dhe nga takimet që GVJ beri me titullarët dhe stafin e institucionit, u konstatua se Fakulteti i Mjekësisë Veterinare nuk është i vetmi institucion i lartë arsimor në fushën e Mjekësisë Veterinare në Shqipëri dhe trojet shqipfolëse, ashtu sikundër pretendon raporti i vetëvlerësimit. Tashmë, një i tillë prej 10 vitesh funksionon në Kosovë/Prishtinë.</p> <p>Programi i integruar i studimit “Master i shkencave” në “Mjekësi Veterinare” në FMV/UBT mbështetet në konceptin global 'One Health', i cili përfshin përpjekje bashkëpunuese të disiplinave të shumfishta për të arritur shëndetin e përsosur të njerëzve, kafshëve dhe mjedisit tonë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.3</p>	
<p>Programi i integruar i studimit synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i integruar i studimit të ciklit të dytë ju mundëson studentëve të punojnë si praktikues të pavarur me lloje të ndryshme kafshësh shtëpiake, të promovojë shëndetin e njeriut dhe të ruajë cilësinë e ushqimit me origjinë shtazore.</p> <p>Përveç sektorit privat si mjek veteriner ikafshëve të shoqërimin, punëdhënësi më i madh i veterinerëve në Shqipëri është Agjencia Kombëtare e Ushqimit, Drejtoria e Shërbimit Veterinar në MBZHR dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar</p>	<p>UBT ka ngritur prej 5 vitesh Qendrën e Karrierës dhe Alumni (QKA) dhe në cdo fakultet Zyrën e Karrierës dhe Studentëve. Qëllimi kryesor i QKA është të informojë, orientojë dhe mbështesë studentët e UBT, në funksion të paraprirjes së një karriere të suksesshme.</p>

<p>me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Prej një viti, QKA është funksionale pranë Fakultetit të Veterinarisë. Ajo ka krijuar nja database me të dhënat e studentëve me qëllim gjurmimin e ecurisë së tyre për një periudhë 5-vjecare nga përfundimi i studimeve. GVJ konstatoi nga takimet e bëra me studentët dhe specialistët e kësaj qëndre se procesi i ndërtimit të portalitinteraktiv të QKA është në fazën e fillimit të tij (<i>Raporti i QKA; Gjurmimi i studentëve, dok.415, 416</i>). Si i tillë ai ende nuk ka mundësi të ofrojë të dhëna mbi mundësitë e punësimit apo numrin e studentëve të punësuar. Institucioni duhet të punojë më shumë për të vendosur lidhje me biznesin vendas për realizimin e praktikave të punësimit (internship) me synim punësimin e studentëve më të mirë.</p> <p>GVJ vlerësoni praktikë të mirë organizimin e Panairit të Karrierës, përmes të cilit kompanitë e ndryshme promovojnë veten dhe përzgjedhin studentët duke realizuar intervista pune me ta.</p> <p>Institucioni nuk ka studime të mirëfillta për nevojat e tregut të punës, gje që ndikon në planifikimin vjetor të numrit të studentëve që pranohen në këtë program studimi, duke bërë pranimin e një numri të lartë studentësh dhe ulur cilësinë e pranimit.GVJ mendon se mospërbushja e këtij kriteri rrezikon përmbushjen e <i>Standardit I-3</i>.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të integruar të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Ka analiza përmbajtësore e programit të formimit të mjekut veteriner, GVJkonstatoi se në vija të përgjithshme programi ka objektiva të qarta formuese për të garantuar përfundimin e dijeve dhe aftësive e kompetencave të specialistit të ardhshëm.</p> <p>Nga takimi me stafin dhe studentët, GVJ vërejti se objektivat e programit të integruar të studimit realizohen në mënyrë të kënaqëshme në aspektin teorik. Për këtë, studentëve u vihen në dispozicion material të ndryshëm si tekste mësimorë në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara dhe material ndihmës të aksesueshme nepërmjet sistemit online.Mangësitë në infrastrukturën e kampusit dhe shërbimeve si p.sh., Ferma didaktike, financimi i ulët dhe jo eficient në bazë materiale dhe kërkim shkencor, nuk garantojnë gjithnjë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përafrohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare, me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p> <p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.</p> <p>Kriteri 6. Programi i integruar përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva</p>	<p>Programi i studimit që zhvillohet në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, në vija të përgjithshme në formë dhe strukturë përafrohet me programe studime të ofruara nga institucione ndërkombëtare. GVJ konstatoi se programi ka disa vite që nuk është përditësuar duke bërë që ndërhyrjet e pjesëshme në programtë krijojnë raporte jo të drejta (në orë dhe përmbajtje) ndërmjet lëndëve formuese profesionale dhe atyre dytësore plotësuese. GVJ mendon që kjo dukuri ndikon në përmbushjen e kriterit 4 të Standardit I-3.</p> <p>Programi është i organizuar në lëndë dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Proçesi didaktik është i organizuar në kurse të integruara të cilat përfshijnë një ose më shumë lëndë të ndryshme me përmbajtje logjike të ndërthurura me njëra-tjetrën. Programi i studimit për sa i përket emërtimit të lëndëve, është në përputhje me Direktivën</p>

<p>ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>e BE-së 2005/36 për profesionet rregulluara (<i>Directive 2005/36/EC of the European Parliament and of the Council of 7 September 2005 on the recognition of professional qualifications</i>).</p> <p>Programi i studimit që zhvillohet në FMV ende nuk është plotësisht i barasvlefshëm me atë të vendeve të BE. Për këtë studentëve ende u duhet ti nënshtrohen dhënies së disa provimeve për njohjen e diplomës. GVJ konstaton se aftësimi profesional nëpërmjet praktikave profesionale nuk realizohet plotësisht, duke mos përmbushur në standard kriteret 5 dhe 6.</p>			
<p>Kriteri 7. Në programin e integruar duhet të përfshihen elementë të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Fakulteti administron një sërë marrveshesh bashkëpunimi me Universitete të tjera si ai i Milanos, Peruxhias, Foxhia (Itali), Ankarasë, Giessen (Gjermani), Ljubjanë (Slloveni), Zagrep, Poloni, Lituani, në kuadër të Projekteve të shkëmbimit ERASMUS dhe CEEPUS, si përpjekje për ndërkombëtarizimin e programit të studimit, (<i>dok. nr.490_Lëvizjet e stafit dhe studentëve</i>). GVJ e vlerësoi këtë eksperiencë si të dobishme për rritjen e mobiliteteve të studentëve dhe stafit si një përpjekje serioze që Fakulteti bën drejt ndërkombëtarizimit të programit dhe shkëmbimit të eksperiencave të mira të mësimdhënies.</p> <p>GVJ konstaton se përqindja e studentëve të përfshirë në këto mobilitete është ende i ulët dhe më shumë punë duhet bërë për njohjen e krediteve të transferuar me qëllim rritjen e numrit të studentëve përfitues.</p> <p>Fakulteti nxit gjithashtu, në përputhje me kërkesën e ligjit të arsimit të lartë, mësimin e gjuhëve të huaja në mënyrë që të përmbushë politikën e tij të ndërkombëtarizimit. Studentët kryejnë provimin e gjuhës së huaj sic kërkohet nga ligji i arsimit të lartë. Programi i studimit zhvillohet tërësisht në gjuhën shqipe. Ka përpjekje për të integruar në program leksione të shkëputura, të kryera kryesisht nga profesorët e huaj të ardhur në kuadër të projekteve të shkëmbimit. GVJ vlerëson se Fakulteti nuk ka ndërtuar një proces për vlerësimin dhe transferimin e krediteve të fituara në institucionet e huaja të arsimit të lartë, si dhe të ofrimit të leksioneve në gjuhë të huaj. GVJ sugjeron se ky duhet të jetë synimi afat shkurtër i stafit të FMV.</p>			
<p>Kriteri 8. Për programin e integruar, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe aksesit online në faqen e FMV, GVJ pohon se FMV ruan dhe arkivon në gjuhën angleze dokumente të tillë si Statuti, plani strategjik i zhvillimit të institucionit, rregullorja e studimeve universitare, programet e lëndëve, CV e stafit si dhe guidën e fakultetit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

Standardi I.4

Programi i integruar është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423 web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë</p>	<p>Programi i integruar Msc në Mjekësi Veterinare” realizohet me pjesëmarrjen e 4 departamenteve të cilët bashkojnë pasurinë e tyre intelektuale dhe infrastrukturore për të garantuar realizimin e këtij programi studimi. GVJ vlerëson si pikë të fortë bashkëpunimin e këtyre njësive të pavarura për realizimin e programit mesimor, i cili finalizohet me një diplomë të vetme. Cdo departament ka staf të mjaftueshëm dhe të kualifikuar akademik dhe ndihmës</p> <p><i>(Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse; Të dhëna Tabelore për numrin e programeve në ciklin e I-rë, të II-të dhe të III-të të studimeve, që ofrohen në Njësinë përgjegjëse– Dok. 187).</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FMV-së, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit.</p> <p>Studimet universitare zhvillohen në 5 vite, në bazë të programeve mësimore dhe kurrikulave duke siguruar në fund diplomën “Mjek Veteriner” që është ekuivalente me “Master i Shkencave” në “Mjekësi Veterinare”. Në përfundim të studimeve studentët diplomohen me 300 kredite</p> <p><i>(Rregullore e Brendshme FMV, neni 16, pika a, b, c).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Institucioni ende nuk disponon të dhëna për kodifikimin e programit të studimit në Mjekësi Veterinare, ndonëse në portal jepen informacione të detajuara të programit, konform kërkesës së ligjit për arsimin e lartë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.5</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Grupi i ekspertëve të jashtëm pohon se institucioni siguron mbarëvajtjen e programit të studimit të MV në disa nivele:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në nivel rektorati, përmes ngritjes së grupit të punës dhe hartimit të programeve të punës për hartimin e planit strategjik afatgjatë, planit vjetor të punimeve, përgatitjes së buxhetit, si dhe mbikëqyrjes dhe mbarëvajtjes së veprimtarisë së tyre për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Këshilli i etikës, si pjesë integrale e veprimtarisë së Senatit akademik si edhe e këshillave të fakulteteve, garanton veprimtarinë akademike të pedagogëve dhe studentëve në konformitet me përcaktimet ligjore, statutoare dhe ato të rregulloreve të brendshme <i>(Statuti i UBT, Kreu 3, neni 18)</i>

	<p>25; <i>Rregullore e Këshillit të Etikës</i>).</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në nivel Dekanati, ndarja e detyrave e përgjegjësisve dhe kontrolli i tyre realizohet nga Dekani, 3 Zv/Dekanët, administratori, përgjegjësit e departamenteve dhe grupeve mësimorë (<i>Statuti i UBT, Rregullore e Studimeve Universitare</i>). Programi i masterit të integruar MV administrohet nga 4 departamente, puna e të cilëve kontrollohet nga Dekanati i FMV. Grupi i ekspertëve të jashtëm vlerëson si pozitive faktin që programi i MV zhvillohet dhe mirëmenaxhohet nga bashkëveprimi dhe koordinimi i punës së katër departamenteve. <p>Prania e Zyra e Karrierës së Studentëve, prej një viti tërësisht funksionale on-line, si dhe Komisioni i Praktikës profesionale pranë Dekanatit (<i>Rregullore e brendshme FMV, neni 35;</i>) <i>Rregullore e brendshme FMV, neni 43, pika a, b, c</i>), përgjigjen për informimin dhe orientimin e studentëve apo të çdo personi tjetër të interesuar për veprimtarinë e FMV, si dhe organizmin e praktikave profesionale. GVJ konstatoi se Komisioni i Praktikës nuk funksionon si duhet. Mungon monitorimi i studentëve dhe formimi i tyre profesional lë për të dëshiruar.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ pohon se FMV/UBT ka marrëveshje të vazhdueshme bashkëpunimi dypalëshe me institucione homologe në kuadër të programeve Erasmus +, CEEPUS në disafakultete në vende të BE si psh, Gjermani, Itali, Rumani, Kroaci, etj. GVJ konstaton se duhen më shumë përpjekje për bashkëpunime në fushën e aftësisimit praktik e profesional, sidomos me aktorë biznesi të huaj.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të integruar të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Ekzistojnë marrëveshje të posaçme kryesisht me ISUV-in, si dhe stabilimentet blegtorale të kafshëve dhe përpunimit të prodhimeve ushqimore me origjinë shtazore për konsum human, në sektorë veterinarë të Qarkut të Tiranës. Në mungesë të një thetoreje në FMV, ka marrëveshje me disa pika thetore të Tiranës. Fakulteti ka akses në disa njësi përpunuese ushqimore, ferma lopësh qumështi, disa pulari.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vlerëson se ka mangësi në zbatimin e programit të studimit në praktikat jo të mirë-mbikëqyrura nga punëdhënësit e këtyre njësisve. Vendi i zhvillimit të praktikave profesionale përcaktohet nga vetë studentët sipas mundësive, preferencave dhe shkallës së njohjes së tyre, duke rrezikuar kështu përbushjen e <i>Standardit I-5</i>. GVJ rekomandon shtimin e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ pohon se UB ka marrëveshje të shumta të lidhura me universitete të huaj apo me institucione të tjera brenda vendit, për të mbështetur procesin e formimit shkencor teorik dhe deri diku praktik të studentëve (<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj; Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se FMV nuk ka hartuar raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit për</p>

marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	shkak edhe të mungesës së funksionimit të duhur të komisionit që duhej të ndjekë realizimin e këtij procesi shumë të rëndësishëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi I.6				
Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të stafit akademik dhe studentëve	GVJ vlerëson se FMV/UBT ndjek një politikë mbështetëse për publikimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore-shkencore të stafit akademik dhe studentëve (<i>Plani strategjik UBT, kapitulli 7 plani veprimtari</i>), ndërkohë që theksojnë se mbështetja financiare është shumë e vogël, duke rrezikuar kështu përmbushjen e <i>Standardit I.6</i>			
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Pranë UBT funksionon Dega e Kërkimit, Kooperimit Shkencor dhe Projekteve, e përbërë nga tri zyra: Zyra e Promovimit të Titujve Akademike dhe Gradave, Zyra e Kooperimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Zyra e Projekteve, e cila përgatit raportin e punës kërkimore shkencore të UBT-së mbi bazën e raporteve të ardhura nga njësitë kryesore, dhe bën një vlerësim të përgjithshëm të të gjithë ecurisë së rezultateve të kërkimit duke e raportuar atë pranë strukturave të Senatit akademik të UBT.			
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	GVJ vlerëson se FMV, nëpërmjet politikave të UBT, merr pjesë në konferenca shkencore të organizuara në nivel Universiteti (<i>Listë e simpoziumeve dhe konferencave 5 vitet e fundit</i>). UBT ka një revistë shkencore prestigjioze, “ <i>Albanian Journal of Agricultural Sciences (AJAS)</i> ”, e cila botohet periodikisht online, me ISSN 2218-2020 (https://ajas.ubt.edu.al/special-editions-online/). Revista është pjesë e disa database të rëndësishme si DOAJ, AGRIS (FAO), CAB abstracts dhe Global health, EBSCO dhe ProQuest database.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimorebotuese.	UBT ka një rregullore të posacme që sanksionon rregullat e pronësisë intelektuale. Pranë fakultetit të Mjeksisë Veterinare është ngritur Këshilli i Etikës, si organizëm që ndër të tjera mbron pronësinë intelektuale. GVJ konstaton, se nuk ka ende programe funksionale të kontrollit të plagjaturës në nivel Departamenti apo Fakulteti, c’ka çënon përmbushjen e <i>kriterit 4 të Standardit I-6</i> .			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Grupi i ekspertëve të jashtëm të vlerësimit pohon se institucioni ndihmon studentët dhe kërkuesit e rinj në kërkimin shkencor, përmes mundësisë të projekteve të ndryshme të tipit COST, CEEPUS, Erasmus Mundus, ose Erasmus+, me universiteteve partnere. Ekspertët konstatojnë se numri i përfituesve nga këto programe është ende i vogël. GVJ vlerëson se ka mangësi në organizimin e veprimtarive të vashdueshme trainuese për studentët dhe kërkuesit e rinj, lidhur me metodologjinë e kërkimit, metodat e reja të kërkimit, etj., gjë që rrezikon përmbushjen e <i>Standardit I-6</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Niveli i përbushjes	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i integruar i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të studimit të Mjekësisë Veterinare, GVJ pohon se, programi është ndërtuar në përputhje me legjislacionin dhe me aktet ligjore dhe nënligjore shqiptare. Kurrikula e kursit të studimit që realizohet me 300 ECTS dhe me kohëzgjatje normale pesë vite akademike është ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve (ETCS) në përputhje të plotë dhe me Statutin e Universitetit dhe me Legjislacionin Shqiptar në Fuqi (<i>Rregullore e brendshme FMV, Struktura e studimeve, neni 30, 31 55 Rregullore e programit të studimit FMV, neni 22</i>).</p> <p>GVJ rekomandon se kurrikula e programit të integruar të MV duhet ristrukturuar sipas modeleve të fakulteteve të ngjashëm evropianë, të paktën me një të tillë (për shembull, Hungaria). Kjo do të ndihmonte edhe në njohjen e diplomës së studentëve në vende të BE.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i integruar i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>GVJ nga konsultimi i dokumentacionit dhe nga takimet me stafin dhe studentët pohon se programi i integruar i MV synon të formojmëjek veteriner për klinikat e kafshëve, specialist për sëmundjet e kafshëve të egra, ekzotike, shëndetin publik, por vëren se ka mangësi në formimin e mjekut veteriner për kafshët bujqësore.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i integruar i studimit jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Nga informacioni i marrë nga takimi me stafin dhe studentët, si dhe nga vizita në laboratorët mësimorë dhe kërkimorë, GVJ vlerëson se programi i integruar i MV realizohet kënaqshëm vetëm teorikisht, duke qënë se financimi për bazë materiale dhe infrastrukturë laboratorike është i ulët. Gjithashtu, GVJ konstaton se formimi praktik, kërkimor i studentëve është i pamjaftueshëm për ti bërë ata të aftë për të zhvilluar kompetenca të përparuar dhe të pavarura, të nevojshme këto për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e tyre të specializimit. GVJ pohon se, pjesa më e madhe e studentëve e mbyllin programin e studimit me një temë diplome teorike.</p> <p>Gjetjet e mësipërme cënojnë përbushjen me sukses të <i>Standardit II-1</i>.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i integruar i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ pohon se Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore: Planet mësimore (lëndët, raportet teori-praktikë,</p>
<p>Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore</p>	<p>GVJ pohon se Programi i integruar i studimit përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore: Planet mësimore (lëndët, raportet teori-praktikë,</p>

e nënligjore.	numri i krediteve, detyrimet mësimore të moduleve, mënyrat e shlyerjes së detyrimeve, afatet, aftësimi praktik i studentëve), modulet e lëndëve, syllabuset apo programet e lëndëve.			
Kriteri 6. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	GVJ vlerëson pozitivisht praktikën e diskutimit të syllabuse në Departamentet që i mbulojnë ato dhe miratimit në mbledhjen e përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanit, gjë që garanton mbarëvajtjen e programit të studimit. GVJ mendon se FMV nuk garanton plotësisht kapacite të mjaftueshëm për realizimin e formimit praktik të studentëve. Praktikrat dhe punët e laboratorit zhvillohen në grupe me më shumë se 20 studentë që nuk përputhen me kriteret e edukimit veterinar për sigurimin e kompetencave profesionale në këtë fushë. Gjatë takimit me studentët dhe përgjegjësit e departamenteve GVJ konstatoi se plani mësimor dhe syllabuset e lëndëvetë formimit të përgjithshëm kanë nevojë të ristrukturohen, për t'ju përshtatur më mirë formimit të mjekut veterinar. Gjithashtu, shpërndarja e lëndëve në semestra, sipas rëndësisë në formimin profesional të studentëve dhe ngarkesës në orë, ka nevojë për rishikim me përparësi. GVJ pohon se programi i integruar i studimit ofron një Praktikë profesionale, e cila është e detyrueshme, në përfundim të kursit teorik, pra në semestrin e 10-të, dhe vlerësohet me 30 Kredite, të shpërndara sipas lëndëve. Diplomimi realizohet me Tezë Diplome e cila nuk ka asnjë kredit.			
Kriteri 7. Programi i integruar i studimit ka të përcaktuara kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj	Programi i integruar i studimit në FMV qartëson mënyrën e progresionit të studentit ndër vite duke përfshirë këtu dhe diplomimin dhe afatet respektive (<i>Rregullore e brendshme e FMV, neni 64, pika 1; neni 65, pika a, b; neni 66, pika a, b; neni 69, 70</i>). Programi i studimit nuk parashikon kredite ECTS të dedikuara për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të Tezës së Diplomës (Curricula FMV 2018-2019, dok. 183). GVJ rekomandon që ky element duhet të rregullohet gjatë ristrukturimit të planit mesimor të FMV.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	FMV përbëhet nga Departamentet dhe njësitë e tjera ndihmëse mësimore-shkencore. FMV vepron brenda kornizave ligjore dhe respekton rigorozisht ligjin e arsimit të lartë në fuqi si edhe përcaktimet statutoare. Strukturat e saj janë të formësuara në mënyrë të tillë që të garantojnë plotësisht arritjen e misionit si edhe përmbushjen e objektivave.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare përbëhet nga 4 Departamente, me ndarje të bazuar mbi aktivitetin formativ që zhvillojnë. Personeli akademik

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Efektiv (PAE) është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Lëndëve Klinike, në të cilin bëjnë pjesë: 10 PAE (6 Prof., 2 Prof.As., 2 Dr) - Departamenti i Lëndëve Paraklinike, në të cilin bëjnë pjesë: 10 PAE (2 Prof., 3 Prof.As., 4 Dr., 1 Msc)
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i lëndëve Morfofunktionale, në të cilin bëjnë pjesë: 9 PAE (3 Prof., 2 Prof.As., 3 Dr., 1 Msc) - Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar, në të cilin bëjnë pjesë: 12 PAE (5 Prof., 5 Prof.As., 2 Dr.)
	<p>Rezulton se Departamentet janë të strukturuar sipas kërkesave ligjore me të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë duke përbushur kështu kriteret ligjore të numrit si edhe nivelit të kualifikimit shkencor (<i>Rregullore e brendshme, kreu II, neni 11</i>).</p> <p>Nga dokumentacioni i DVV rezulton gjithashtu se Departamentet kanë në përbërje dhe personel ndihmës akademik (PNA) në të cilët bëjnë pjesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në Departamentine Lëndëve Klinike: 5 PNA (5 Msc) - Në Departamentine Lëndëve Paraklinike: 3 PNA (1 Dr, 2 Msc) - Në Departamentine Lëndëve Morfofunktionale: 4 PNA (4 Msc) - Në Departamentine Shëndetit Publik Veterinar: 1 PNA (1 Dr.) <p>(<i>Dok. 387_fm_V Personel akademik dhe ndihmes akademik 2018_19.</i>)</p> <p>Departamentet në FMV janë të organizuar në grupe të përkohshme mësimore-kërkimore. Raporti midis personelit me kohë të plotë, të pjesshëm dhe të ftuar anon dukshëm në favor të me kohë të plotë. Po kështu personeli akademik efektiv në FMV përbën mbi 70% të stafit të përgjithshëm, ndërsa pjesa tjetër e personelit janë pjesë përbërëse e fakulteteve të tjera në UBT të cilët mbulojnë lëndë me karakter ndërdisiplinor. Zyra e burimeve njerëzore mban një bazë të dhënash të përditësuar me të gjitha ndryshimet e nevojshme dhe eventuale.</p> <p>Fakulteti ka faqen e tij funksionale të internetit (http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-mjekesise-veterinare/), ku gjenden programet e studimit, syllabuset e lëndëve, informacione mbi marrveshjet e mobilitetit në kuadër të projekteve të ndryshëm.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.</p>	<p>GVJ, gjatë vizitës së tij në institucion, pohon se, për mbarëvajtjen e procesit didaktiko-kërkimor angazhohet edhe personeli ndihmës mësimor-shkencor, që përfshin persona përgjegjës të laboratorëve, klinikave që ndodhen brenda strukturës së fakultetit dhe ka të përcaktuara qartë detyrat dhe rolet gjithnjë në përputhje me objektivat dhe qëllimet e programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se nuk ka politika për trainimin e vazhdueshëm profesional të personelit ndihmës, dhe në ndonjë rast nuk ka personel ndihmës dhe rolin e tij e kryen pedagogu (laboratori i cilësisë së ushqimit). Roli i personelit ndihmës është kryesisht didaktik, ndërsa përfshirja e tyre</p>

	në kërkimin shkencor është i pa rregulluar me rregullore. Duhet punuar për përfshirjen e tyre në marrveshjet e mobilitetit në kuadrin e projekteve ERASMUS, etj.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Programi i studimit të integruar MV ka dy Koordinatorë që përgjigjen për të gjitha aspektet për organizimin, ecurinë dhe zhvillimin e programit. Këta dy koordinatorë janë Zv/dekani për anën mësimore që është autoriteti i ngarkuar me detyra dhe kompetenca për të ndjekur veprimtaritë mësimore dhe Zv/dekani për anën shkencore që është personi i ngarkuar me detyra dhe kompetenca për të organizuar dhe ndjekur veprimtaritë kërkimore-shkencore në nivel fakulteti. Detyrat dhe kompetencat e tyre përcaktohen në Statutin e UBT dhe në Rregulloren e FMV-së (<i>Statuti i AUT, dok.5</i>).</p> <p>Zv/dekani për anën mësimore është koordinatori kryesor i veprimtarisë së Komisionit të Praktikës Profesionale të Fakultetit, me strukture tjera përgjegjëse të Universitetit dhe me njësitë (subjekte, ente) ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve.</p> <p>Praktika Profesionale udhëhiqet dhe drejtohet nga pedagogët përkatës të fakultetit, në bashkëpunim me specialistët e subjekteve apo institucioneve ku ajo kryhet. Komisioni i Praktikës Profesionale të studentëve, propozohet nga Departamentet që kanë disiplina në programin e kësaj praktike dhe miratohet nga Dekani. Për drejtimin dhe administrimin e praktikave caktohet një koordinator, i cili miratohet nga Dekani.</p> <p>(Rregullore e brendshme e FMV, neni 13, shkronja d, neni 42, pika a, neni 43, pikat, a, b, c)</p>			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	<p>GVJ pohon se Koordinatorët e programit të studimit raportojnë periodikisht tek Dekani dhe përgatisin çdo informacion që lidhet me programin e studimit</p> <p>(Raporti i veprimtarisë së punës mësimore dhe kërkimore, relacione, struktura mësimore për çdo vit akademik, orari mësimor, datat e provimeve).</p> <p>(Dok 417 Raport Performanca e QKA_2018.pdf)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Pa përmbushur	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3	
Programi i integruar i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të integruar të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pohon se struktura dhe organizimi i studimeve në Mjekësi Veterinare, dhe deri diku edhe përmbajtja, janë ndërtuar në përputhje me legjislacionin dhe me aktet nënligjore shqiptare. Emërtimi Master i Shkencave (program i Integruar) në “Mjekësi Veterinare” përputhet tërësisht me kualifikimin e arritur nga të diplomuarit në këtë program studimi. Në planin mësimor të programit të studimit përcaktohen lëndët e programit të studimit të ndara sipas kategorive të veprimtarive formuese,
Kriteri 2. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë, module, praktikë e aktivitete	

formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	në vite e semestra së bashku me kreditet përkatëse (<i>Rregullore e brendshme FMV, Struktura e studimeve, neni 30, 31, 32, 33; Rregullore e programit të studimit FMV, neni 22</i>).			
Kriteri 3. Programi i integruar i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës dhe, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit në Mjekësi Veterinare organizohet në lëndë, praktika e aktivitete formuese dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) (<i>VKM nr. 41, Dt.24.01.18: Pika 2.5</i>).			
Kriteri 4. Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Programi i integruar i studimit përmban planin mësimor, ku pasqyrohet gjithë informacioni i nevojshëm për orët në auditor dhe jashtë tij, për mënyrën e frekuentimit, vlerësimit të dijeve. Programet e lëndëve gjenden në faqen online të Fakultetit dhe janë të aksesueshëm nga studentët. Po ashtu, në fillim të vitit, pedagogu i lëndës i njeh studentët me programin e lëndës. Nga takime studentët, GVJ konstatoi se në lëndë të caktuara ka ndryshim në mënyrën e vlerësimit në fund të vitit, pa dijeninë e studentëve (p.sh. lënda, <i>Të ushqyerit</i>), apo prani të metodës së vlerësimit “firmë”, emërtim ky i papërputhshëm me sistemin e Bolonjës (sipas këtij të fundit, quhen lëndë me vlerësim të vazhduar VLV).			
Kriteri 5. Programi i integruar i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ pohon se programi i integruar i MV përmban gjithë informacionin e nevojshëm që ka të bëjë me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve (<i>Rregullore e studimeve universitare UBT, neni 39, Kreu X, nenet 67-72; Tabela mbi shpërndarjen e studentëve sipas kurseve dhe fakulteteve; Tabela e stafit akademik, ndihmës dhe administrative, UBT; Tabela kapacitet UBT 04.06.2018 Final; www.ubt.edu.al; Guida e Universitetit Bujqësor të Tiranës</i>).			
Kriteri 6. Programi i integruar i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ pohon se Programi i integruar i studimit MV përmban gjithë informacionin e detajuar mbi programin e lëndëve (syllabuset), orët në auditor, praktikën, seminarët, mënyrën e vlerësimit, në përputhje me formatet e miratuara (<i>Curricula FMV_2018</i>). Këto material janë të aksesueshme nga studentët në faqen online të FMV.			
Kriteri 7. Përbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Gjatë vizitës në institucion dhe në takimet e kryera, GVJ konstatoi se gjatë 10 viteve të fundit, ka patur rishikim të pjesshëm të programeve vetëm në masën 20%. Gjatë kësaj kohe nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë për rishikimin thelbësor të kurrikulës, gjë që rrezikon përmbushjen e <i>Standardit II-3</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të integruar të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Politika e universitetit përcakton numrin maksimal të studentëve për leksion (80) seminare (40) dhe punë laboratorike (15), për të siguruar përdorimin fizik me eficiencë.</p> <p><i>(Rregullore e Studimeve Universitare neni 72, 73, 74 dhe 75 83 Rregullore e Studimeve Universitare neni 10).</i></p> <p>Vlerësimi i mësimdhënies 2017-2018 nxjerr në pah disa probleme, për shembull, investime të pakt apër shkak të buxhetit të kufizuar (<i>Analiza vjetore FMV 2017-1018</i>). Takimi me studentët konfirmoi se cilësia e laboratorëve ishte e dobët, dhe se në pjesën më të madhe të tyre shikonin vetëm demonstrime, apo punonin me 1 ose 2 mikroskopë, etj. Edhe takimi me stafin akademik konfirmoi se programet mësimore realizoheshin mirë teorikisht, por kishin mangësi në aspektin praktik.</p> <p>GVJ e konsideroi burimin e laboratorëve të mësimdhënies, që është pjesë thelbësore e formimit të mjekëve veterinarë, si një dobësi. GVJ rekomandon që fakulteti duhet të përmirësojë gjendjen e laboratorëve mësimorë.</p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>FMV ka hartuar një program të studimeve të integruara, ku emërtimi i lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja së lëndëve dhe praktikave në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore në auditor është si më poshtë:</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Leksione 1845 orë mësimore - Seminare 1305 orë mësimore - Praktikë profesionale 525 orë mësimore - Teza e diplomes 0orë mesimore <p>Gjithsej 3675 orë mësimore</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të integruar “Master i shkencave” dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p><i>(Dok. 183 CURRICULA_FMV_2018_19.pdf)</i></p> <p>Takimet e bëra me stafin dhe studentët konfirmuan formimin e dobët praktik si rrjedhojë e mangësive në financim.</p> <p>GVJ e konsideron praktikë të mirë përpjekjen e vazhdueshme të stafit për të përmirësuar programet e lëndëve dhe për t’i tërhequr studentët në punë kërkimore apo nxitur për pjesëmarrje në aktivitete referuese kërkimore si mkonferencat, simpoziumet. Të dy palët aktorë, studentë dhe pedagogë pranojnë se rezultatet e pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor nuk janë në nivelin që synon të sigurojë programi i integruar “Master i shkencave” (<i>Analizë e FMV (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional, etj</i>), dhe kjo pasqyrohet në nivelin e ulët të notës mesatare (6) dhe cilësinë e dobët të temave të diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Nga studimi i planit mësimor, GVJ konstaton se shpërndarja e krediteve të lëndëve ndërmjet semestrave nuk është e mirëstuduar; në dy vitet e para ekziston një ndarje e pabarabarte e krediteve ndërmjet semestrave (semesti II ka gati 2-3 fishin e krediteve të sem. I) ndërsa në dy vitet e fundit, lëndët janë vjetore, fakt ky qëi përqëndron provimet vetëm në semestrin II. Kjo situatë ndikon ndjeshëm në mbingarkesen e studenteve, vështirëson transferimin e krediteve, duke çenuar kështu plotësimin e</p>

	<p><i>Standardit II.4.</i></p> <p>GVJ rekomandon rishikimin rrënjësor të planit mesimor, me fokus të vecantë shpërndarjen e drejtë të krediteve të lëndëve.</p> <p>GVJ vlerëson si praktikë të mire përpjekjen e stafit për të përditësuar informacionin në programe e leksione me eksperiencat e tyre evropiane apo për të ftuar lektorë të huaj, me qëllim ndërkombëtarizimin e programit. GVJ rekomandon që institucioni duhet të bëjë më shumë për të realizuar provimin e licencës, duke mundësuar njohjen e diplomës në tregun e punës vendas apo atë evropian.</p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Stafi akademik ka përgjegjësinë për të siguruar studentët të kenë akses në literaturë e duhur dhe ta përditësojë atë me zhvillimet më të fundit. Takimi me stafin dhe studentët konfirmoi se syllabuset (programet e lëndëve) e cdo lënde nuk përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. GVJ vlerëson si praktikë të mirë përditësimin e literaturës dhe materialeve vizuale didaktikë, të viteve të fundit për për shkak të lëvizjeve të personelit akademik për arsye kualifikimi apo mësimdhënie në fakultete të vendeve të ndryshme në BE. Në përgjithësi mungon nga ana e institucionit mbështetja e personelit akademik me literaturë bashkëkohore në formën e traktateve, text book por edhe periodikëve shkencorë. GVJ rekomandon të rriten përpjekjet për të pasuruar bibliotekën me numër më të madh titujsh tekstesh apo periodikësh në gjuhë të huaj.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të integruar të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga analiza e programit të studimit MV dhe takimet me stafin dhe studentët, GVJ pohon se përmbajtja e programit të studimit të mjekësisë veterinarë në përgjithësi garanton pajisjen e studentëve me njohuritë bazë të mjekut veterinar dhe vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të thelluara të tyre. Por, GVJ konstaton se struktura e programit, në shpërndarjen e moduleve dhe krediteve, nuk përshtatet me nivelin e studimit të integruar.</p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të integruar të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ rekomandon institucionin të ristrukturojë programin MV, sipas modeleve evropiane, për të vënë në raport të drejtë lëndët bazë profesionale me lëndët dytësore, duke organizuar lëndët në module dhe rregulluar numrin e krediteve (Teza e diplomës duhet pajisur me kredite), për të siguruar një shpërndarje të drejtë të tyre në semestra, ashtu edhe të shlyerjes së detyrimit vjetor.</p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse në FMV, konfirmuan se deri më sot nuk janë konsultuar me bashkëpunëtorë dhe partnerë për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit në Mjekësi Veterinarë dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. GVJ pohon si gjetje positive faktin që Urdhri i mjekut veterinar është një nga bashkëpunëtorët më të afërt me fakultetin, që ka për qëllim kryesor mbrojtjen e interesit publik dhe shëndetit të kafshëve, duke garantuar kompetencë nga veterinerët në ushtrimin e këtij profesioni.</p> <p>Ekspertët vlerësojnë se për shkak të periudhës së shkurtër të funksionimit, urdhri i mjekut veterinar nuk ka ende eksperiencën dhe kompetencat e duhura profesionale për të propozuar përmirësime në përmbajtjen e programit të studimit në FMV. GVJ vlerëson si gjetje pozitive iniciativën e ndërmarrë institucionalisht nga QKA, për themelimin e Bordit të</p>

	ALUMNI UBT, në datë 28.02.2018 (Bordi ALUMNI), si një përpjekje fillestare në për të filluar njëproces konsultativ me partnerë. Kjo strukturë ka filluar të mbledhë të dhëna dhe informacione në lidhje me karrierën postuniversitare dhe pozicionimin e studentëve në tregun e punës, me qëllimnxitjen e procesin e përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimeve në UBT.			
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor mundëson njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	Duke marrë parasysh faktin që formimi paraktik, kërkimor është i papërmbushur për shkak të fondit të ulët për kërkim, GVJ konstaton se ky kriter nuk përmbushet plotësisht. Kjo konfirmohet edhe nga fakti se institucioni nuk ka ende nje program studimi të nivelit të tretë funksional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.	Departamenti është njësia kryesore mësimore dhe kërkimore. Departamentet përmes stafit të tyre janë përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit të MV. GVJ pohon se Departamentet që menaxhojnë programin e integruar të MV kanë personelin e duhur dhe staf akademik që plotëson kriteret e nevojshëm të cilësisë. Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të integruar të studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Programi i studimit plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket titujve akademikë apo gradave shkencore të Personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme përkatës
Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	<p>(Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit; CV e stafit akademik të programit të studimit).</p> <p>Titullarët e lëndëve për programin studimor “Mjekësi Veterinare” kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit dhe kanë eksperiencë të gjatë klinike dhe mësimdhënëse (Rregullore FMV, neni 15, pika a dhe b; CV e stafit akademik të programit të studimit).</p> <p>GVJ ka gjetur dëshmi të një Zyretë Burimeve Njerëzore e cila administron dosjet që përmbajnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të personelit efektiv dhe me kontratë të Universitetit. Kjo zyrë gjithashtu menaxhon vazhdimisht dhe përditëson bazën e të dhënave. Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik dhe ngarkesën lëndore të tyre për cdo semester</p> <p>(Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit; CV e</p>

	<p>stafit akademik të programit të studimit).</p> <p>GVJ konstaton se institucioni ka politika të qarta për rekrutimin e stafit të ri akademik dhe ndihmës. Gjatë vizitës në institucion, grupi i ekspertëve konstatoi se Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, në bashkëpunim me fakultetin dhe departamentin përcakton kriteret bazë, mbi të cilat bëhet rekrutimi i stafit të ri akademik dhe/ose joakademik, si dhe përshkrimin e pozicionit të punës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që kërkon pozicioni vakant, si dhe statusin përkatës (me kohë të plotë ose të pjesshme). Kriteret janë transparente dhe afishohen në stendën pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe në faqen online të Universitetit</p> <p>(Rregullore e Zyrës së Burimeve njerëzore).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>FMV është angazhuar në mënyrë aktive për të vënë në dispozicion personelin e duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Praktika profesionale kryhet në subjekte të përshtatshme, me nivel të njohur kualifikimi për trajnimin praktik veterinar (<i>Rregullore e brendshme FMV, neni 42, pika a dhe b, neni 43, pikat a, b dhe c</i>).</p> <p>FMV ka marrëveshje me klinikat veterinare, laboratorët diagnostikë dhe institucionet kërkimore (ISUV), stabilimentet blegtorale të kafshëve dhe përpunimit të prodhimeve ushqimore me origjinë shtazore për konsum human, në sektorët veterinarë të Qarkut, zyrat veterinare vendore, për kryerjen e praktikave veterinare (<i>Lista e marrëveshjeve me bizneset dhe institucionet, dokumenti 43</i>). Në diskutim me studentët, GVJ konstaton se studentët nuk janë të kënaqur nga cilësia e zhvillimit të praktikave, pasi ato ndiqen në grupe të mëdhenj dhe stafi akademik është i pamjaftueshëm për të mbikëqyrur në vazhdimësi sidomos në rastet kur studentët i kryejnë ato në qytete të tjera dhe në distancë të largët nga fakulteti. GVJ rekomandon se procesi i praktikave mësimore në MV duhet përmirësuar dhe institucioni duhet të ndërtojë politika që ta bëjnë stafin akademik më të interesuar për të ndjekur studentët në këtë komponent të mësimin.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>Fakulteti MV angazhon personelin akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike. GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se numri i këtij stafi është i pamjaftueshëm dhe jo gjithnjë i mirëkualifikuar për të realizuar këtë kriter. GVJ rekomandon se institucioni duhet të ngrejë strategji për të siguruar trainim për stafin ndihmës akademik, në vazhdimësi për të siguruar realizimin e planit mesimor, por edhe ndihmesën e tyre në kuadër të projekteve kërkimore apo shërbimit ndaj të tretëve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="text-align: center;">X</p>				

Standardi IL6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me

sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse në FMV, konfirmuan se deri më sot nuk janë konsultuar me bashkëpunëtorë dhe partnerë për përmirësimin e përmbajtjes së programit të integruar të studimit në Mjekësi Veterinare dhe përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. GVJ pohon si gjetje pozitive faktin që Urdhri i mjekut veteriner është një nga bashkëpunëtorët më të afërt me fakultetin, që ka për qëllim kryesor mbrojtjen e interesit publik dhe shëndetit të kafshëve, duke garantuar kompetencë nga veterinerët nështrimin e këtij profesioni.</p> <p>GVJ vlerëson se për shkak të periudhës së shkurtër të funksionimit, urdhri i mjekut veterinar nuk ka ende eksperiencën dhe kompetencat e duhura profesionale për të propozuar përmirësime në përmbajtjen e programit të studimit në FMV.</p> <p>GVJ vlerëson si gjetje pozitive iniciativën e ndërmarrë institucionalisht nga QKA, për themelimin e Bordit të ALUMNI UBT, në datë 28.02.2018 (Bordi ALUMNI), si një përpjekje fillestare në për të filluar një proces konsultativ me partnerë. Kjo strukturë ka filluar të mbledhë të dhëna dhe informacione në lidhje me karrierën postuniversitare dhe pozicionimin e studentëve në tregun e punës, me qëllim nxitjen e procesin e përmirësimit të përmbajtjes së programeve të studimeve në UBT.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në përputhje ligjore me kornizën e arsimit të lartë u ofron studentëve mundësi të jenë të përfaqësuar në strukturat funksionale të Universitetit duke përfshirë Senatin, Bordet e Menaxhimit, Komisioni i Sigurimit të Cilësisë së Studimeve, dhe Komitetin e Etikës, dhe janë në gjendje të japin feedback mbi mbështetjen për kurrikulën, mësimdhënien dhe studimet</p> <p><i>(Statuti i UBT-së, Vendim Senati, ku demonstrohet pjesëmarrja e studentit si anëtare senati; Statuti i UBT, Kreu V, neni 57, Rregullore e Studimeve Universitare, Kreu IX, neni 83).</i></p> <p>Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se vetëm në Senat, studentët ishin të përfshirë në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Studentët në FMV nuk kanë qenë të organizuar në një strukturë të tyre deri më sot. Në fillim të vitit 2019, studentët në FMV kanë krijuar këshillin e tyre. Ka përpjekje nga strukturat përgjegjëse në FMV, për të ftuar studentët në diskutime të hapura që ju mundëson atyre shprehjen e lirë të mendimeve që lidhen me procesin mësimor, por këto përpjekje derimë tani kanë qënë joeficiente.</p> <p>GVJ konstatoi se ka një përpjekje të institucionit për të marrë mendimin e studentëve përmes pyetësorëve të shpërndarë në përfundim të lëndës, dhe vetëm prej një viti, atyre u vihet në dispozicion një pyetësor online (<i>Dok. 53_Modeli i pyetësorit</i>). Studentët pranojnë se mendimi i tyre nuk merret në konsideratë; ndërkohë që stafi akademik mendon se opinionet e studentëve nuk jepen me përgjegjësi, dhe si të tillë e bëjnë të vështirë marrjen parasysh të tyre në vlerësimin e performancës së stafit akademik.</p> <p>GVJ rekomandon, që institucioni duket të gjejë rrugët që mendimi i studentëve të përthithet dhe të shërbejë për rritjen e cilësisë.</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe Qendrën e Karrierës, GVJ konstatoi se institucioni nuk mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar me qëllim që të marr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit. Kjo qëndër është e re dhe GVJ vlerëson se Qendra e Karrierës & Alumni ka tashmë një sistem database i cili duhet përmirësuar në vazhdimësi. Rezultatet e pyetësorit në lidhje me punësimin 1 vit pas përfundimit të studimeve në UBT janë të paraqitura në raportin e performancës së QKA</p> <p><i>(Dok. 417_Raporti i performancës së QKA).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor apo agjensitë e ndryshme, por GVJ konstatoi se ky bashkëpunim nuk ka ndikuar në përditësimin, përshtatjen dhe riorganizimin e programit në FMV.</p>			
<p>Kriteri 5. Në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private, institucioni përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme</p>	<p>GVJ konstatoi se një nga bashkëpunëtorët më të afërt të FMV është Urdhri i mjekut veterinar. Ky urdhër ka realizuar shumë aktivitete të përbashkëta trajnimi me qëllim transferimin e njohurive për përmirësimin e edukimit të vazhduar veterinar tek profesionistët që punojnë si në sistemin shtetëror por edhe privat. Sidoqoftë, urdhri i mjekut veterinar ka një periudhë të shkurtër që funksionon dhe nuk ka ende eksperiencën dhe kompetencat e duhura profesionale për të propozuar përditësim, përshtatje dhe përmirësim në përmbajtjen e programit të studimit në FMV në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme.<i>(shih Kriterin 1)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X		

<p>Standardi II.7</p>	
<p>Programi i integruari studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i integruar i studimit MV përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë, të cilat janë në përputhje me politikat kërkimore të Universitetit. Prioriteti i UBT përfshin aktualisht drejtime të tilla si: Zinxhiri i qëndrueshëm i prodhimit bujqësor (bimë, kafshë); Zinxhirin e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale; Strategjitë & polikat e zhvillimit rural; Zinxhirin e ushqimit dhe mbrojtjen e kafshëve (<i>Plani strategjik, pika 1.1</i>).</p> <p>GVJ vlerëson se Prioritetet e kërkimit janë të qarta dhe të përcaktuara sipas të gjitha njësive përbërëse.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të</p>	<p>FMV është e organizuar në njësi bazë, që janë departamentet konform përcaktimeve ligjore. Programi i integruar i MV realizohet dhe menaxhohet falë bashkëpunimit të 4 departamenteve, të cilët përfshijnë fusha kërkimi homogjene dhe organizohen në GMK. Këto grupe ndjekin</p>



<p>personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p> <p>Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme</p>	<p>të gjitha aktivitetet mësimore e kërkimore brenda departamenteve si dhe bashkëpunojnë mirë midis tyre. GVJ, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion të tij, vlerëson se Fakulteti dhe Departamentet, si njësitë që përgjigjen për ecurinë e punës kërkimore shkencore, nxitin dhe bashkë-rendojnë për të administruar veprimtaritë e mësimdhënies, kërkimore, duke respektuar lirinë akademike dhe kërkimore të personelit akademik (<i>Statuti neni 3, pika 1</i>).</p> <p>Financimi jepet nga shteti dhe ndahet sipas prioriteteve të vendosura nga Senati. Departamentet e FMV-së sipas përcaktimeve ligjore kanë të drejtën e tyre për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të realizimit të programit të studimit që ofrohen apo projekteve shkencore. Projektet kryesore kombëtarë janë financuar kryesisht nga AKTI, Ministria e Arsimit dhe Buxheti i shtetit, si dhe programet e bashkëpunimit dypalëshe të financuar nga BE</p> <p>(<i>Dok. 524_Lista e projekteve FMV 2014-2019</i>).</p> <p>Kërkimi shkencor mbështetet shumë në disa laboratorë kërkimorë bashkëkohorë të specializuar në histopatologji, kontrolli i analizës së ushqimit, diagnostikës laboratorike</p> <p>(<i>Dok. 532_Raporti mbi gjendjen e laboratorëve FMV; vizita në institucion</i>).</p> <p>GVJ konstatoi se organet drejtuese të fakultetit bëjnë në mënyrë periodike, analizën e performancës së punës kërkimore dhe të gjithë llojëvë të angazhimeve</p> <p>(<i>Analizat e punës shkencore FMV_2017/18</i>)</p> <p>Lidhur me mbështetjen financiare të kërkimit shkencor, GVJ pohon se prej shumë vitësh ka patur një mungesë të mbështetjes për kërkim shkencor nga Universiteti për departamentet. Është një praktikë e mirë kontributi individual i stafit kërkimor në projekte ndërkombëtare, por GVJ rekomandon që institucioni duhet të adresojë problemin dhe të ushtrojë më shumë presion ndaj autoriteteve të Universitetit apo Ministrisë për të rritur fondin e financimit për kërkim shkencor.</p> <p>(<i>Lista e projekteve FMV 2014-2019 102 http://www.paza-albania.eu/rreth-nesh/</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Personeli akademik nxit dhe mbështet studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Që nga viti 2012 ka patur pjesëmarrje të stafit dhe studentëve në konferenca/seminare të organizuara nga FMV, për t'ju mundësuar studentëve angazhimin në punime të pavarura kërkimore (<i>Dok. 517_Listë e punimeve të paraqitura në konferenca me pjesëmarrje të studentëve</i>).</p> <p>Përfshirja e studentëve përbën një praktikë të mirë. GVJ pohon se përfshirja e studentëve në punë kërkimore është ende shumë e vogël. FMV pranon se duhet bërë më shumë në drejtim të cilësisë së studentëve dhe duhen nxitur ata të realizojnë më shumë tema kërkimore sesa teorike. Kjo përbën një dobësi. GVJ rekomandon që institucioni duhet të bëjë më shumë përpjekje për të thithur projekte të mbështetur nga donatorë vendas apo të huaj.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit</p>	<p>FMV ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione kërkimore në vend.</p>

fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	me të cilat ka pika dhe interesa të përbashkëta në fushën e kërkimit, nëshërbim dhe funksion të projekteve kërkimore të përbashkëta. GVJ vlerëson si praktikë të mirë bashkëpunimin afat gjatë me Projektin PAZA, qëllimi i të cilit ishte “Rritja e kapaciteteve për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe mbështetur strategjitë kombëtare për kontrollindhe çrrënjosjen progresive të sëmundjeve zoonotike të synuara, të tilla sibruceloza, antraksi, tërbimi, tuberkulozi etj” (http://www.paza-albania.eu/rreth-nesh/).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.8	
Institucioni i arsimit të lartë,nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>FMV ka politika mbështetje institucionale për të krijuar dhe për të vendosur në dispozicion të grupeve kërkimore një infrastrukturë bashkëkohore mbështetëse të përfaqësuar nga disa laboratorë kërkimorë. Megjithatë për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare UBT nuk është në gjendje të siguroj mbështetje për projekte të propozuara nga GMK. Kjo përbën një dobësi dhe çënon plotësimin e <i>Standardit II</i>. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se infrastruktura shkencore është e vjetëruar dhe e pamjaftueshme për të mbështetur kërkimin cilësor.</p> <p>Vlerësohet si praktikë të mirë ngritja e dy laboratorëve bashkëkohorë të kontrollit të cilësisë së ushqimit dhe i diagnostikës laboratorike. Ekspertët rekomandojnë nevojën për një program të qëndrueshëm për investime për t’i sjellë pajisjet dhe mjediset shkencore në një nivel cilësor.</p> <p>FMVka vendosur bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor nëpërmjet nënshkrimit e një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të huaja, të cilat kanë pasur si qëllim lidhjen e marrëveshjeve të qëndrueshme të bashkëpunimit me institucione partnere të huaja të arsimit të lartë me interes të përbashkët, në mbështetje edhe të fuqizimit të drejtpërdrejtë të kërkimit shkencor në nivel institucioni.(<i>Dok. 525_Marrëveshje kërkimore me Milano</i>).</p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	MV ka një angazhim serioz në kërkimin shkencor, gjë që tregohet edhe nga lista e projekteve të fituara (<i>Dok. 524_Lista e projekteve FMV 2014-2019</i>). FMV pranon se fondet shtetërore për kërkim shkencor janë shumë të kufizuara dhe se personeli akademik përpiqet në mënyrë individuale tëangazhohet në veprimtarinë shkencore, kryesisht përmes angazhimit të kërkuesve të rinj, por jo vetëm. GVJ konstatoi se angazhimi i studentëve për realizimin e objektivave të kërkimit është në një përqindje të ulët dhe kryesisht në studime që kërkojnë analiza

	laboratorike si psh në fushën e parazitologjisë, sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve.			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	MV është institucionalisht i përkushtuar për të zbatuar një politikë mbështetëse për organizimin e seminareve dhe simpoziumeve shkencore duke synuar përfshirjen në to veçanërisht të personelit akademik të ri, dhe sidomos të studentëve të programit të doktoratës. FMV ka një përvojë të mirë në organizimin e konferencave dhe simpoziumeve të përbashkëta shkencore, me synim prezantimin e arritjeve kërkimore. GVJ vlerëson si një praktikë të mirë organizimin që nga viti 2013 të sesionit shkencor të përvitshëm D-Day, ku aktivizohen kryesisht studentët e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve. FMV pranon se duhet punuar më shumë në organizimin e konferencave apo aktiviteteve vjetore me pjesëmarrje të gjerë studentësh.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Institucioni nuk ka procedura të qarta apohartuar ndonjë udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. U gjet si praktikë e mirë injicimi injë filozofie të re mësimdhënieje bazuar në problematika. GVJ vlerëson se kjo praktikë është vetëm në fillimet e saj dhe përdoret më pak nga sa do te duhej. Nga analiza e raportit të vetëvlerësimit del në dukje mungesa e mjediseve dhe mjeteve teknike moderne të mësimdhënies (<i>Dok. 532_Raporti mbi gjendjen e laboratorëve FMV</i>), gjë e lidhur kjo me financimin e ulët. Kjo u konfirmua edhe në takimet me stafin akademik dhe studentët. GVJ vlerëson si praktikë të mire iniciativat individuale të stafit në FMV për të përmirësuar aftësitë individuale të mësimdhënies duke futur metoda inovatore të mësimdhënies, si p.sh. të mësuarit interaktiv kompjuterik (Projekti “Development of New Teaching Protocols in Veterinary Medicine Education” në bashkëpunim me FMV e Peruxhias, Itali).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe	Universiteti dhe FMV angazhohen në monitorimin e hollësishëm vjetor, me qëllim përmirësimin e cilësisë të mësimin dhe mësimdhënies. Në nivel universiteti ekziston Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (<i>Rregullore e NJSBC</i>) që është pjesë e Degës së Mësimin, Kurrikulave & Vlerësimin Institucional dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve

ndihmësakademik.	<p>të Studimit dhe Kërkimit Shkencor të Universitetit, ndërsa në nivel të FMV ekziston Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor</p> <p><i>(Statuti i UBT-së neni 69/2, dhe, neni 16/5,6 dhe Rregullore e studimeve FMV neni 13/2 dhe 13/4).</i></p> <p>Vlerësimi i mësimdhënies bazohet në Vetëvlerësimin dhe feed-back-un e studentëve në fund të vitit. Dekanati përmes Zv. Dekanit për mësimin dhe përgjegjësit e departamenteve në mënyrë periodike realizon vlerësimin e performancës së pedagogëve në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet. Departamentet e Fakultetit organizojnë në mënyrë periodike diskutime dhe kontrole në lidhje me aftësitë mësimdhënëse të personelit akademik duke promovuar eksperiencat më të mira <i>(Formulari i performancës akademike; Pyetësi i studentëve).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni realizon anketime periodike të studentëve, në të cilat ata shprehin vlerësimin për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik <i>(Formulari i performancës akademike; Pyetësi i studentëve).</i> Këta pyetësorë zhvillohen përpara sezonit të provimeve. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton se vetëm prej një viti anketimet zhvillohen online dhe pjesëmarrja e tyre në to është shumë e ulët. Studentët pohojnë se çështjet e ngritura prej tyre jo gjithnjë adresohen si duhet. GVJ rekomandon që fakulteti të marrë në konsideratë çështjet e vlerësimit të ngritura nga Anketimi i studentëve, për të siguruar më tej proceset e vlerësimit periodik.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në Fakultet është Dekanati, që ushtron veprimtarinë e tij përmes Zv. Dekanit për mësimin dhe përgjegjësive të departamenteve. Ata bëjnë publike rezultatet e vlerësimit në mbledhjet e Asamblesë Akademike të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare <i>(Rregullore e Studimeve të FMV, neni 13, protokoll i mbledhjes së Asamblesë Akademike).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies</p>	<p>FMV realizon në mënyrë të përvitshme analizën e punës mësimore ku një nga rubrikat kryesore që diskutohet është cilësia e mësimdhënies. FMV zbaton një plan të asistimit të pedagogëve në orën e mësimin nga strukturat drejtuese të njësive ku, vlerësohet performanca e pedagogëve. GVJ gjen si praktika të mira vlerësimin e pikëzuar të performancës së personelit akademik <i>(Dok. 526_Formulari i performancës akademike),</i> dhe promovimin e personelit akademik me stimuj moralë, si certifikata mirënjohjeje. <i>(Dok. 527_Lista e pedagogëve të motivuar me stimuj moral)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të</p>	<p>FMV realizon programin e integruar duke përdorur forma të transmetimit të dijeve dhe njohurive të miratuara nga Institucioni <i>(Rregullorja e</i></p>

<p>dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p><i>Studimeve Universitare neni 47, Rregullore e Studimeve FMV, neni 37 dhe 42, sylabusi i një lënde dhe plani kalendar si dhe programi i praktikës profesionale).</i></p> <p>Format e mësimdhënies në FMV janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, dhe praktikat profesionale.</p> <p>Programi i modulit jep informacion mbi lektorin/ lektorët që do të zhvillojnë lëndën, vitin akademik dhe semestrin kur zhvillohet, karakterin e lëndës, njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti; kohëzgjatjen e lëndës; peshën e tij në ECTS, objektivat; elementët e mësimdhënies; detyrimet e studentit; metodat e vlerësimit; literaturën. Pjesë e programit të lëndës është dhe plani kalendarik. Praktika profesionale zhvillohet me studentët e vitit të pestë në semestrin e X.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>Pedagogët pranojnë se për realizimin e një procesi mësimdhënie të suksesshëm është e nevojshme që ata të përdorin forma të larmishme të bazuara në eksperiencën e tyre por edhe në sugjerimet e studentëve. GVJ pohon se stafi akademik i FMV bën përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e procesit të mësimdhënies. Këtë gjë e dëshmon edhe numri i marrëveshjeve të mobilitetit me universitete të huaj dhe mikëpritja e profesoratis të huaj</p> <p><i>(Dok. 501_Lëvizjet e stafit të huaj FMV-2016-2017;</i> <i>Dok. 492_Lëvizjet e stafit dhe studentëve 2017-2018;</i> <i>Dok. 504_Leksione të hapura nga të huaj).</i></p> <p>GVJ vlerëson si praktikë të mirë aplikimin e metodës innovative E-learning në lëndët e Fiziologjisë dhe Sëmundjeve Infektive të Kafshëve. Kufizimi i punëve laboratorike praktike apo mungesa e tyre në disa lëndë përbën një dobësi që cënon plotësimin e <i>Standardit III-2</i>. GVJ rekomandon që institucioni të adresojë cilësinë e laboratorëve të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>FMV mbështet dhe promovon stafin akademik për kualifikime afatgjata apo afatshkurtra për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Këtë e dëshmojnë projektet e ndryshme si CEEPUS, Erasmus Plus, të ndërmarra nga FMV, përmes të cilëve është mundësuar mobiliteti i stafit, kryesisht me moshë të re</p> <p><i>(Lista e mobiliteteve Erasmus+, CEEPUS).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ pohon se FMV ka një staf akademik të kualifikuar dhe me përvojë. Pjesa më e madhe e titullarëve të lëndëve apo grup lëndëve u përkasin kategorive Profesor dhe Doktor</p> <p><i>(Dok. 388_Personeli akademi FMV).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>FMV ka politikë të vlerësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike përmes asistimeve në seancat e leksioneve dhe praktikave mësimore (<i>Vendim Dekanati për asistime të pedagogëve në seancat e leksioneve dhe praktikave mësimore</i>).</p> <p>GVJ vlerëson si praktikë të mirë iniciativën e disa pedagogëve për të</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor</p>	

metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	marrë vazhdimisht në konsideratë mendimin e studentëve për të përmirësuar metodat e tyre të mësimdhënies (dëshmi nga takimi me stafin dhe studentët). GVJ rekomandon institucionin të marrë në konsideratë çështjet e vlerësimit të ngritura nga Anketimi i studentëve me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Stafi akademik pranon se niveli i studentëve që ndjekin programin MV është i dobët dhe kjo përbën një pengesë në aplikimin e metodave me bazë zgjidhjen e problemeve apo mendimit kritik. GVJ rekomandon institucionin të hartojë politika të thithjes së një kontigjenti më cilësor të studentëve.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p> <p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p> <p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në FMV, procesi mësimor dhe shkencor realizohet në auditorë, laboratorë, klasa mësimore, klinikat veterinarë, salla nekropsie dhe anatomie si dhe në EDE-në e UBT. Procesi mësimor zhvillohet kryesisht në godinat në dispozicion të fakultetit por edhe në mjedise të tjera për lëndë të formimit bazë si: Biologji, Kimi, Informatikë, Fizikë. Disa nga lëndët klinike zhvillohen në EDE por që kushtet nuk janë të pranueshme për standartet e edukimit veterinar. Këto mjedise janë salla leksionesh si dhe klasa laboratorike ku punohet me grupe 18-22 studentë (<i>Dok. 463 Të dhënat e plotë të infrastrukturën në shërbit të programit MV</i>). Nga vizita e GVJ pranë institucionit, u konstatua se procesi mësimor në FMV realizohet në hapësira jo të mjaftueshme dhe jo shumë cilësore. Kjo vjen për shkak të numrit të madh të studentëve dhe sipërfaqeve nëdispozicion që kanë ambientet e fakultetit. FMV nuk ka një thertore, nuk ka strukturë për hospitalizimin (shtrimin) e kafshëve, si dhe nuk ka një fermë të tijën. Kjo përbën një dobësi e cila rrezikon mosplotësimin e <i>Standardit III.3</i>.</p> <p>GVJ e vlerëson si praktikë të mire përpjekjen e FMV për të nisur tashmë një projekt të ri të titulluar "Qendër e Edukimit dhe Trajnimit Profesional", me donatorë të tilla të mëdhenj si USAID dhe Bashkëpunimi Slloven për Zhvillim, i cili synon të përmirësojë standardin e cilësisë infrastrukture. GVJ rekomandon institucionin të adresojë problematikën e standardit të laboratorëve mësimore dhe shkencorë.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Në kushtet e mungesës së paisjeve didaktike vecanërisht për praktikat mësimore, personeli akademik i FMV shfrytëzon gjerësisht sisteme informatike, në dobi të procesit mësimor.</p> <p>Infrastruktura IT nuk është shumë e konsoliduar në FMV. Në funksion të mbështetjes së programeve mësimore, FMV ju garanton studentëve për</p>

	disiplinat formuese, tekste, skripte, leksione të shkruara si dhe informacion të konfiguruar në ppt në sitet e çdo pedagogu.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>FMV mbulon nevojat e studentëve për literaturë mësimi dhe kërkimi në masë dërmuese përmes teksteve dhe shumë pak përmes leksioneve të lidhura dhe skripteve në gjuhën shqip. Të gjitha materialet vihen në dispozicion të studentëve përmes librarisë së UBT. Materiale ndihmëse dhe informuese për studentët si edhe forma e leksioneve në ppt. janë të ngarkuar në faqet e secilit prej pedagogëve të FMV.</p> <p>Në mjediset e kampusit universitar, funksionon biblioteka Shkencore “Mentor Përmeti” e cila ka rreth 1100 anëtarë (pedagogë, studentë, administratë dhe punonjës të jashtëm të fushës së bujqësisë) dhe qarkullon rreth 10.000 materiale në vit. Sallat e literaturës janë të organizuara me fonde të hapura të ndara sipas degëve të shkencës. Burimi kryesor i informacionit është kryesisht bibliografik (libra, postera, harta, CD-Rom), sikundër edhe shërbim në version on-line. Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte 8.00 – 16.00, oraret e saj janë publike dhe funksionon sigurisht përmes kartelave të regjistrimit. Në Bibliotekën e UBT-së është mundësuar edhe Biblioteka virtuale COBIB.AL.</p>
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Biblioteka e UBT-së nuk garanton për të gjitha disiplinat botime të viteve të fundit por garanton hapësira të mjaftueshme për përdorim nga studentët. Në godinën e re të FMV-s është instaluar edhe një tjetër bibliotekë me kushte modeste me një kapacitet mbi 20 vendësh. Ajo ka lidhje të pandërprerë me internet dhe 10 kompjutera në funksion (<i>Rregullore e brendshme FMV, Neni 66/a, b, e; Rregullore e brendshme FMV, Neni 13/II, pika a, b, 13/IV, pika a</i>).
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	FMV vë në dispozicion të mësimdhënies dhe mësimnxënies një librari on line në fusha të ngjashme dhe të përafërta me programin e FMV-së përmes: Library Network Support Services Western Balkans Platform dhe Biblotekës virtuale COBIB.AL, AGORA, TEEAL (<i>Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit; Biblioteka</i>). GVJ, në takimin me studentët konstatoi se ka një mungesë informacioni nga studentët përsa i përket mundësive për të aksesuar këto librari on-line, gje që është e lidhur me neglizhencëne tyre, por edhe me disponibilitetin e stafit për të furnizuar platformën me literaturë.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Platforma on-line (e-learning) e FMV nuk funksionon në mënyrë korrekte. GVJ vlerëson si praktikë të mirë aplikimin e platformës e-learning në 2 nga lëndët kryesore të programit. GVJ rekomandon institucionit të aplikojë më shumë platforma të tilla në të ardhmen, krahas modernizimit të laboratorëve kërkimorë.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët, shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	<p>FMV posedon uebsite e saj funksional përmes të cilës krijon komunikim me studentët dhe bën të njohur misionin e saj. Cdo pedagog, në domenin e site manager të UBT, menaxhon uebsitee tij personal nëpërmjet të cilit komunikon me studentët dhe aktorët e sipërpërmendur.</p> <p>Të gjithë pedagogët dhe stafi administrativ i FMV zotëron dhe menaxhon një adresë e-mail, të unifikuara nën domainin e UBT, si dhe një llogari individuale në sistemin e esse3, i aplikueshëm përmes faqes</p>

	zyrtare të UBT që shërben si një mjet shumë efikas komunikimi mes Pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ (kryesisht sekretaritet lidhur me vlerësimin e studentëve, dhe së fundmi menaxhimi financiar i institucionit). GVJ vlerëson se FMV ka një mjet komunikimi të brendshëm efikas mes pedagogëve, studentëve dhe stafit ndihmës (administrativ). Studentët kanë akses në këtë sistem përmes kredencialeve të personalizuar dhe ju mundësohet të marrin informacione të ndryshme si regjistrimi për provim, të mësojnë rezultatet vjetore dhe ato përfundimtare pas dhënies së provimit, etj. Informacion i përditësuar për studentët dhe pedagogët jepet përmes faqes zyrtare të ubt: www.ubt.edu.al			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Programi i integruar i MV përmbillet me temë diplome. Personeli akademik i FMV i orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave duke ju vënë në dispozicion listën e temave që shpallen nga dekanati. Përzgjedhja e temave të diplomave kryhet në vitin e IV akademik. Departamentet, brenda muajit Tetor të vitit akademik në vazhdim, shpallin temat e diplomave, të cilat udhëhiqen nga pedagogë me grada dhe tituj shkencor (<i>Rregullore e brendshme FMV, Neni 66/a, b, e</i>). GVJ gjatë vizitës në FMV konstatoi se pjesa më e madhe e temave të diplomës kanë karakter teorik dhe shumë pak eksperimental. Stafi akademik pranon se pengesë për këtë bëhet numri i kufizuar që njëpedagog mund të udhëheqë (3 studentë/1 pedagog) dhe fondi i kufizuar për kërkim. GVJ rekomandon që institucioni të bëjë më shumë përpjekje për të rritur numrin dhe cilësinë e diplomave me karakter kërkimor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	FMV ka mekanizma aktivë për të promovuar dhe përmirësuar mësimdhënien. Pranë FMV është ngritur Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Struktura kryesore që e organizon këtë proces përfaqësohet nga Zv. Dekani për mësimin dhe drejtuesit e Departamenteve (<i>Rregullore e brendshme FMV, Neni 13/II, pika a, b, 13/IV, pika a</i>). GVJ pohon se ky komision nuk ka qënë aktiv dhe përgjegjësitëe tij nuk janë të qarta. Personeli akademik pranoi se ky komision nuk ka luajtur ndonjë rol të rëndësishëm në rritjen e vetëdijes të personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në programin e studimit.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.	GVJ gjeti si praktikë të mirë organizimin e leksioneve të hapura. GVJ rekomandon FMV të përpunojë një strategji më efektive për përmirësimin

	e cilësisë së mësimdhënies.			
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	FMV nuk ka hartuar ndonjë udhëzues institucional për mbështetjen dhe zhvillimin e eksperimentimit të metodave të reja inovative të mësimdhënies. GVJ konstaton se ky komponent realizohet mbi bazën e iniciativave personale të stafit akademik duke cënuar kështu plotësimin e <i>kriterit 3, Standardi III.4.</i>			
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	FMV nuk ka një strategji për trainimin e vazhduar të personelit akademik. Stafi pranon se ai përpiqet individualisht për kualifikimin e tij në fushën e kërkimit shkencor dhe mësimdhënien duke aplikuar në projekte ose kurse trajnimi, workshop të organizuara nga institucione të huaja duke përditësuar deri diku njohuritë në fushën e kërkimit (<i>Lista e aktiviteteve për kërkimin shkencor të stafit akademik në 5 vitet e fundit</i>) dhe duke shfrytëzuar programet e shkëmbimit si ERASMUS, CEEPUS. GVJ pohon se numri i stafit akademik përfitues është ende i vogël dhe rekomandon institucionin të hartojë plane trajnimi të rregullt për stafin akademik dhe ndihmës.			
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Institucioni ka përgjegjësinë të kenë një staf të kualifikuar për të garantuar cilësi të programit të integruar të MV. FMV nuk ka njëstrukturë të posaçme, përgjegjëse për këtë qëllim. GVJ e gjen si dobësi mungesën e një trainimi të strukturuar dhe të vazhduar të stafit. Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion, pranohet se ky aktivitet realizohet nga vetë stafi, i cili për shkak të ngarkesës nuk e përballon cilësisht këtë mision. Kjo çënon edhe procesin e implementimit të metodave të reja edhe për shkak të mungesës së trajnimeve për këtë çështje.			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.				
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Nuk ka testim të metodave të reja të mësimdhënies dhe as raportim të tyre pranë strukturave dhe njësiteve përgjegjëse.			
Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor	Njësia kryesore/bazë bën përpjekje për të rifreskuar auditorin duke mirëpritur personel akademik të ftuar, shqiptarë dhe të huaj gjatë procesit mësimor (<i>Lista e pedagogëve të ftuar FMV; Lista e stafit akademik të huaj Erasmus+, CEEPUS</i>). Ky shkëmbim pasuron me ide dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>FMV ka rregullore të qarta për format e kontrollit të dijeve dhe njohurive dhe aftësitë profesionale të studentëve përcaktohen qartë në Rregulloren e Studimeve të FMV. GVJ pohon se ato u bëhen të njohura studentëve që në fillim të vitit të parë si dhe janë të publikuara në vende të dukshme në FMV.</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Stafi akademik i FMV ka përgjegjësinë t’ju bëjnë të njohur studentëve organizimin e lëndës, raportin e orëve, shtrirjen e saj në kursin përkatës. Pedagogët pranojnë se i informojnë në mënyrë të hollësishme studentët mbi organizimin e testimit të njohurive dhe dijeve, ashtu sic ato janë parashikuar në syllabusin e lëndës. Pedagogu i ri-informon studentët edhe në leksionin e fundit, para sezonit të provimit. Format e vlerësimit të dijeve, njohurive dhe aftësive profesionale në FMV janë: me shkrim, me gojë, me shkrim dhe gojë, bazuar në Rregulloren e Studimeve të UBT dhe Rregulloren e FMV. Forma e testimit është pasqyruar edhe në silabuset e lëndëve. Pavarësisht pohimit të pedagogëve, gjatë takimit me studentët, GVJ konstaton se kjo praktikë ka mangësi; ka raste të ndryshimit të mënyrës së provimit në përfundim të lëndës (rasti i lëndës <i>Të ushqyerit</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>GVJ rekomandon që FMV të marre ne konsiderate çështjet e ngritura nga Anketimi i Studentëve, për të siguruar më tej procesin e vlerësimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Fakulteti ka rregullore të qarta për vlerësimin të cilat janë të aksesueshme nga studentët. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. Ai bazohet në aktivizimin e tij në praktikat laboratorike, në kontrollin e dijeve dhe të gjitha detyrimet përkatëse në laborator dhe praktikën klinike, në seminare, detyra kontrolli dhe detyra kursi, të pasqyruara në Syllabuset e lëndëve. Vlerësimi gjithëvjetor i studentit është deri në 40 pikë bazuar në Rregulloren e Studimeve të UBT dhe Rregulloren e FMV. Vlerësimi gjithëvjetor reflektohet në vlerësimin përfundimtar (Demonstrim, Sekretaria Mësimore e FMV).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Forma e testimit për lëndët bazë, karakterizuese dhe plotësuese në FMV është me gojë. Në këto kushte, nuk zbatohet sistemi elektronik ose i sekretuar i testimit. Për lëndët ndërdisiplinore testimi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve realizohet me shkrim dhe zhvillohet me sekretim të fletoreve (<i>Rregullore e Studimeve të UBT dhe në Rregulloren e FMV</i>).</p> <p>Përgjegjësit e njësive bazë përpara sezonit të provimeve ngrenë komisionet e provimit për çdo lëndë/modul. Ato përbëhen nga së paku 2 anëtarë (<i>Rregullore e UB dhe të FMV</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim,</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive dhe dijeve që realizohen me shkrim,</p>

zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.	zhvillohet me sekretim të fletoreve. Njësia kryesore siguron infrastrukturë të posaçme të monitorimit me personel akademik. E gjithë procedura përkatëse bazohet në Rregulloren e FMV .								
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente /feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJpohon se institucioni ju siguron studentëve feedback mbi rezultatet e provimit si edhe gjatë performancës në lëndë. Studentët e njohin procedurën e ankesave (<i>Rregullorja e studimeve FMV</i>). Cdo ndryshim në nota duhet tënjoftohet formalisht Përgjegjësi përkatës i Departamentit, duke siguruar kështu transparencën.								
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	FMV posedon një rregullore të brendshme ku përcaktohen qartë qëndrimet e institucionit ndaj kopjimit në provime dhe plagjiaturës (<i>Rregullore e FMVNeni 56, 57; Rregullore e Studimeve të UBT, Neni 62, pika c</i>). GVJpohon se institucioni nuk ka një program anti-plagjiaturë.								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Kontrolli i dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në vlerësimin gjithëvjetor dhe atë të provimit dhe bëhen transparente në kohë sipas rregulloreve në fuqi (<i>Rregullore e brendshme FMV, Neni 58, pika a, b, c; Rregullore e brendshme FMV, Neni 58, pika c, Neni 59, pika a; Demonstrim, sekretaria mësimore e FMV</i>).								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ vlerëson se FMV ka një rregullore sipas të cilës studentët kanë të drejtë të njihen me vlerësimin përfundimtar (<i>Rregullore e Studimeve të UBT, Neni 64, pika a; Rregullore e brendshme FMV, Neni 58</i>). Njohja me vlerësimin kryhet në rrugë elektronike, sipas sistemit Esse3. Sipas rregullores, FMV ka praktika të rishikimit të vlerësimit (<i>Rregullore e Studimeve të UBT, Neni 65, pika a; Rregullore e brendshme FMV, Neni 58, pika c, Neni 59, pika a</i>).								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet	FMV ka një procedurë të qartë të ankimit të studentit për zhvillimin e provimit apo në rast mos-dakortësie me vlerësimin (<i>Rregullore e Studimeve të UBT, Neni 65, pika b; Rregullore e brendshme FMV, Neni 59, pika a, b, c</i>). Studentët e njohin procedurën e ankesave.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi III.7	
Programi i integruar i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Departamentet e FMV që përgjigjen për programin e integruar të MV hartojnë programin e studimit, i cili miratohet nga Senati akademik. Bëhet kujdes që programi i studimit të MV të përmbajë të gjithë elementët përbërës të tij dhe të garantojë formimin shkencor dhe profesional të studentëve. GVJ konstatoi se orët praktike në pjesën më të

	<p>madhe të lëndëve përbëhen kryesisht nga prezantime frontale dhe demonstrime praktike.</p> <p>GVJgjen dobësi faktin që grupet e studentëve janë të mëdha (22-26 studentë) dhe jo në përputhje me standartet për profesionet e rregulluara (<i>direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara si veterinarja maksimumi 10-12 për seminare; maksimumi 5-6 për trajnime praktike</i>). Stafit dhe studentët pranojnë se burimet material për zhvillimin e punëve praktike janë të pamjeftueshme në mjaft lëndë. Sipas tyre disa salla leksionesh nuk janë të mëdha sa duhet për të akomoduar të gjithë studentët. GVJ i rekomandon institucionit të adresojë problemin e sigurimit të bazës materiale dhe rritjen e fondeve për mësimin dhe kërkimin.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit MV përmban lëndë si teknologjia e informacionit, gjuha e huaj, legjislacioni veterinar, komunikimi veterinar, mjekësia ligjore, mirëqënia e kafshëve, mbrojtja e kafshëve, gjë që mundëson zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit si psh që garantojnë edukimin me vlerat më të mira morale të studentëve dhe për të siguruar në të ardhmen praninë e specialistëve të aftë profesionalisht dhe të pastër moralisht.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.</p>	<p>Institucioni ka politika të qarta për vlerësimin e kompetencave dhe aftësive që student fiton gjatë programit të studimit. Këtë e realizon nëpërmjet vlerësimit gjithëvjetor dhe përfundimtar në lëndë dhe anketimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, stafi akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde apo moduli stafi akademik realizon në mënyrë transparente dhe ballafaqese vlerësimin gjithëvjetor të studentit ku analizohen çështjet më të rëndësishme dhe orientohen studentët për testin përfundimtar. Vlerësimi gjithëvjetor i studentit bazohet në pjesëmarrjen në leksione dhe aktivizimin e tij në praktikat laboratorike, në kontrollin e dijeve dhe të gjitha detyrimet përkatëse sipas lëndëve. Ky vlerësim është deri në 40 pikë.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJgjen si praktikë të mirë organizime orëve të hapura dhe seminareve mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë nga ana e Personelit akademik të ftuar (<i>Leksione të hapura nga të huaj, Almako, PAZA etj</i>). Por thekson se kjo praktikë është sporadike në FMV.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>FMV angazhohet në realizimin e mësimdhënies për formimin e kompetencave të studentët. GVJ vlereson përpjekjet e institucionit për të bashkepunuar me aktorë të tjerë për të mundësuar formimin e plotë teorik dhe praktik të studentëve, por gjen dobësi mbështetjen e ulët financiare që institucioni ka për mësimin dhe kërkimin.</p> <p>GVJ rekomandon një adresim më të fortë të këtij problemi pranë autoriteteve të Universitetit me qëllim realizimin e një programi studimi cilësor.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen</p>	<p>Personeli akademik i Fakultetit gjatë procesit mësimor ose jashtë tij organizon diskutime me studentë apo grup studentësh, si dhe konsulta</p>

e problemeve/çështjeve të caktuara.	ndërmjet stafit akademik për problematika apo çështje që lidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor. Studentët pohojnë se kanë stukturën e tyre, Këshilli studentor, përmes të cilit adresojnë problematika pranëstrukturave drejtuese të Fakultetit (<i>Informacion nga studentët në lidhje me problematikat e shfaqura</i>).			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Stafi akademik krijon një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet studentët në këto iniciativa (<i>Dok. 510_Lista projekteve me përfshirje studentësh</i>). Stafi pranon se niveli i studentëve dhe interesi i tyre është i ulët. GVJ sugjeron që institucioni të shqyrtojë rrugët dhe mënyrat e rritjes së pjesëmarrjes së studentëve në tema diplomë kërkimore.			
Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	FMV ndjek një politikë për rritjen e mobilitetit të studentëve me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe nivelit të ekspertizës. Institucioni merr pjesë në aktivitete të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare duke bashkëpunuar si partnere me mjaft Institucione të Arsimit të Lartë, nga Vendet e Evropës Lindore, Ballkanit Perëndimor dhe Zonës së Mesdheut. Politika favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve paraqitet qartë në aktmarrëveshjet ndërkombëtare midis fakultetit dhe Institucioneve të Huaja të Arsimit të Lartë (<i>Projektet e mobiliteteve të studentëve</i>). GVJ vlerëson si praktikë të mire integrimin e studentëve të huaj nga vendet fqinje duke përdorur programin CEEPUS.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve	FMV ndjek një politikë për rritjen e mobilitetit të studentëve me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe nivelit të ekspertizës. Institucioni merr pjesë në aktivitete të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare duke bashkëpunuar si partnere me mjaft Institucione të Arsimit të Lartë, nga Vendet e Evropës Lindore, Ballkanit Perëndimor dhe Zonës së Mesdheut. Politika favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve paraqitet qartë në aktmarrëveshjet ndërkombëtare midis fakultetit dhe Institucioneve të Huaja të Arsimit të Lartë (<i>Projektet e mobiliteteve të studentëve</i>). GVJ vlerëson si praktikë të mire integrimin e studentëve të huaj nga vendet fqinje duke përdorur programin CEEPUS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	FMV disponon një rregullore të detajuar qartë për realizimin e procesit të provimeve si dhe në lidhje me vlerësimin e studentëve e cila është e shpallur në faqen web të universitetit. Studimet e përfunduara në FMV sigurojnë (ofrojnë) diplomën që përfaqëson një kualifikim “Master i Shkencave” në “Mjekësinë Veterinare” . Fakulteti ngre komisionet përkatëse si dhe shpall në mënyrë të dukshme pranë sekretarive kriteret e nevojshme për t’u përmbushur nga studentët në lidhje me mbrojtjen e diplomës para komisionit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ndjek një politikë inkurajuese, për zhvillimin dhe rritjen e dinamikës së kërkimit shkencor duke gërshtuar punën e departamenteve me infrastrukturën mbështetëse (laboratorët mësimorë shkencore, ambiente e burime elektronike, bibliotekë, etj). Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Studenti i regjistruar në programin “Master i Shkencave” ka të drejtë të paraqitet në mbrojtjen e tezës së diplomës dhe siguron gjithë informacionin e duhur për ta realizuar në

	kohë këtë proces (<i>Rregullore e diplomimit FMV</i>).			
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	FMV ka një rregullore të detajuar për kryerjen e temës së diplomës për programin “Masteri Shkencave”. Përgjegjës për përcaktimin e procedurave për informimin e studentëve lidhur me Diplomimin janë Zv/Dekani për anën mësimore, së bashku me Kryetarin e Komisionit të Diplomimit dhe ZKS-në (<i>Rregullore e DMBNJP, neni 4</i>).			
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.	Departamentet dhe Përgjegjësat e Grupeve Mësimore Kërkimore angazhohen për orientimin e studentëve në përcaktimin e temave/tezës së Diplomës (<i>Dok. 545_Listat udhëheqës tema diplome</i>).			
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Strukturat drejtuese të Fakultetit në bashkëpunim me stafin akademik udhëheqës të temave të diplomimit të studentëve janë në kontakt të vazhdueshëm dhe orientojnë studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.			
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomes bashkëpunon me studentët për procedurat e nxjerrjes së rezultateve, përpunimit të tyre, shkrimit të tezës. Bashkëpunimi udhëheqës student për finalizimin e temës apo tezës së diplomës është i vazhdueshëm. Udhëheqësi garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit. GVJ, konstaton se tezat e diplomave janë me se shumti teorike (kompilative) dhe shumë më pak të karakterit eksperimental/kërkimor.			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë	Punimi i diplomës mbrohet para Jurisë që miratohet nga Dekani. Mbrojtja e diplomës është publike. Vlerësimi bëhet me notë brenda ditës së mbrojtjes dhe rezultatet hidhen në sistem. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin <i>(Modeli Diploma dhe Diploma supplement)</i> .			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Programi i studimit i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare sigurohet në Zyrën e Karrierës dhe Studentëve dhe është në dispozicion të studentëve të diplomuar në dy gjuhë, shqip dhe anglisht (<i>Kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar</i>).			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen	ZKS ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit të cilat përdoren sa herë që studentët kërkojnë informacion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Të dhënat e personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ përditësohen çdo vit akademik nga nga DPMNJ.</p> <p>Gjithashtu, të dhënat e reja ju dërgohen instancave dhe paralel përditësohen në uebsite e UBT por edhe në “site pedagoge” të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare. Në këto të dhëna përfshihet angazhimi i personelit akademik në program dhe angazhimi i çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në Fakultetin e Mjekësisë VeterinareGVJ vlerëson se që të gjitha dosjet për personelin akademik të brendshëm dhe të angazhuar, ruhen në zyrat e Drejtorisë së Burimeve njerëzore, po ashtu edhe përditësohen çdo vit.</p> <p><i>530_33_Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative në UBT.pdf,</i></p> <p><i>552 Rregullore e ZBNJ, UBT (1).pdf,</i></p> <p><i>553 Formati dosja personelit UBT.pdf)</i></p> <p>Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi (Ligji i Arsimit të Lartë) dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit (Rregulloren e rekrutimit UBT të Stafit Akademik, Ndihmës dhe Administrativ në UBT, Nr. 2843, date 31.12.2018).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>GVJ vlerëson se në Universitetin Bujqësor, Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, rekrutimi, stafit bëhet sipas konkursit publik, duke u mbështetur në ligjin e Arsimit të lartë, statutin si dhe rregulloret për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrative të cilin u konstatua në një tabelë shpallje një konkurs publik pranë Drejtorisë së Burimeve njerëzore.</p> <p><i>(Dok 552_Rregullore e DMBNJP nenet 4 dhe 6,</i></p> <p><i>Dok 530_33_Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative në UBT, nenet 3 dhe 4,</i></p> <p><i>Rregullore e brendshme të FMV, neni 84,</i></p> <p><i>Dok 553_Formati dosja personelit UBT.pdf)</i></p> <p><i>Dok 528_28_Kontrata individuale_Shembull R. P.pdf)</i></p> <p>Po sipas konstatimit gjatë vizitës, Institucioni respektivisht, Fakulteti Mjekësisë Veterinare (Departamentet) përpilojnë nevojat për staf, të cilat i dërgojnë në Rektorat respektivisht në Senatin e Universitetit për miratimin e tyre e mandej për publikimin e konkurseve.</p> <p>Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare zbaton Ligjin e Arsimit të Lartë për rekrutimin e punonjësve akademikë. Senati</p>



	<p>Akademik i UBT ka kritere bazë për rekrutimin e personelit dhe mënyra e vlerësimit të tyre, të cilat bëhen publike në çdo konkurs.</p> <p>UBT-ja ka përcaktuar modelin e procedurave të zhvillimit të konkurimit të rekrutimit të personelit akademik dhe joakademik si dhe ka caktuar edhe komisionin e rekrutimit sipas pozicionit të punës për çdo anëtar në mënyrë që të jetë në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p> <p>GVJ vlerëson që Institucioni, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare (Departamentet) kërkojnë stafin sipas nevojave, po ashtu Dekanati sipas ligjeve në fuqi caktohen kriteret dhe shpallet konkursi, po ashtu ata caktojnë komisionin për vlerësim.</p> <p>Institucioni në përpikmëri i zbaton procedurat dhe aktet të tjera ligjore në fuqi për rekrutimin e stafit akademik dhe ndihmës akademik. (Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative në UBT, nenet 3 dhe 4)</p> <p>Biografia e Stafit, respektivisht CV e stafit Akademik të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të cilët janë përgjegjës për lëndët të cilët i mbajnë, janë në përputhshmëri të plotë me lëndët të cilat i mbajnë. <i>(CV S. D.pdf)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>UBT-ja respektivisht Fakulteti i Mjekësisë Veterinare angazhohet vazhdimisht për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p> <p>Kazyra të mjaftueshme për stafin akademik dhe ndihmës akademik (në zyra 2 – 3 Profesorë), kishte Zyra të veçanta për përgjegjësit e departamenteve, po ashtu edhe për administratën e Fakultetit. Aktiviteti mësimor dhe shkencorë zhvillohet, por ka nevojë për hapësira të tjera.</p> <p>GVJ konstaton që shumica e pedagogëve kishin qasje në projekte si Erasmus + dhe CEEPUS. Por kishte raste që edhe pedagogë të katedrës së lëndëve Morfofunktionale nuk kishin qasje në projekte edhe po ashtu nuk kishte kompjuterë në zyrë (nga takimi me stafin akademik).</p> <p><i>(Gjendja e mjediseve të UBT, tabelat e asetëve, hapësirave dhe logjistikës përmbledhëse UBT,</i></p> <p><i>490 Lëvizjet e Stafit dhe Studenteve _UBT_2017-2018.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>GVJ pas analizimit të dokumenteve konstaton se një pjesë e madhe të Stafit akademik dhe të studentëve në kuadër të projekteve CEEPUS dhe Erasmus + I shfytëzonin këto mundësi me qëllim të avancimit të metodologjisë në mësimdhënie nga stafi akademik, kurse studentët kishin</p>

	<p>mundësin e përfitimit të përvojave në Institucionet ku shkonin. Zhvillimi i veprimtarisë shkencore themi se zhvillohet kënaqshëm, por mungojnë disa aparatura dhe reagentë për zhvillimin e aktivitetit shkencor.</p> <p>Një pjesë e madhe e stafit Akademik në kuadër të projekteve Erasmus + dhe CEEPUS kanë zhvilluar vizita nga një javore deri në një muaj në Universitetet Evropiane respektivisht Fakultetet e Mjekësisë Veterinare si ai Zagrebit, Milanos, Barit, Rumanisë, Greqisë, po ashtu edhe studentët kanë patur mundësin e lëvizjes në këto Fakultete nga një semester.</p> <p><i>(490-Lëvizjet e Stafit dhe Studenteve_UBT_2017-2018.pdf,</i> <i>491-Lëvizjet e Stafit_UBT_2016-2017.pdf,</i> <i>493-Lëvizjet e Studenteve_UBT_2016-2017.pdf,494-Staff and Student Mobility.pdf)</i></p>								
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor.</p>	<p>Gjatë vizitës në Fakultetin e Mjekësisë në disa lëndë përdoren disa metoda të reja në mësimdhënie. Metoda të reja inovative përdoren në lëndën e kirurgjisë, e cila ishte shumë atraktive për studentët.</p> <p>Stafi i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare duhet t'i shfrytëzojë mundësit nga projektet aktuale dhe projektet që do të vijnë për t'i zhvilluar njohuritë sidomos metodat atraktive dhe të reja për studentët.</p> <p><i>(Rregullore e FMV, neni 14 pika a dhe neni 15, 494-Staff and Student Mobility.pdf)</i></p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të integruar të studimeve</p>	<p>GVJ konstaton se në Fakulteti i Mjekësisë Veterinare veprimtaria kërkimore shkencore realizohet nga Stafi Akademik, por angazhimi i tyre në procesin mësimor, i merr një pjesë të kohës, ku i lënë pak hapësirë për aktivitetin kërkimor shkencor. Por në përgjithësi procesimësimor zhvillohet në mënyrë të rregullt nga ana e Stafit Akademik për përmbushjen e objektivave të programit të Integruar Master i Shkencave në "Mjekësi Veterinare".</p> <p><i>(387-FMV_PERSONEL AKADEMIK DHE NDIHMES AKADEMIK 2018_19.pdf,</i> <i>396 - Ngarkesa e plote mesimore e stafit akademik.pdf)</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ konstaton se Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në hapësirat ku zhvillohej procesi mësimor dhe praktik, përshkak të numrit të pranimit të studentëve kohët fundit (100-110/ në vit) që u konstatua edhe në sekretarinë e Universitetit Bujqësor të Tiranës, pra numri i madh grupeve gjatë mbajtjes së ushtrimeve dhe praktikave, kjo pak a shumë e</p>

<p>studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>pamundëson qasjen e të gjithë studentëve në aktivitet.</p> <p>Institucioni ka përveç klasave mësimore, bibliotekën e Fakultetit, sallën e kompjuterëve.</p> <p>GVJ gjatë vizitës ka vizituar ndërtesën kryesore, Ndërtesën e anatomisë, klinikën e kafshëve të vogla dhe klinikën e kafshëve të mëdha. Në ndërtesën kryesore u vizituan këto laboratore: Laboratorii Fiziologjisë, Biokimisë, Patologjisë, Produkteve shtazore, Mikrobiologjisë, Parazitologjisë.</p> <p>Gjatë vizitës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, u konstatua që ndërtesat janë të vjetëra përveç një salle amfiteatër dhe disa laboratorë që ishin ndërtuar kohët e fundit, kurse disa të rikonstruara edhe disa ishin duke u rikonstruuar.</p> <p>Ka laboratore, ku zhvillohej vetëm pjesa shkencore, po ashtu gjatë ushtrimeve (praktikave).</p> <p>Laboratorët aktualë dhe disa në konstruksion, përshkak të numrit të madh të studentëve kanë hapësira jo të mjaftueshme.</p> <p>Godina e Anatomisë, ishte e pajisur me mjete konkretizuese, skeletesh kafshësh, kurse për organe merren te gatshme të cilat përdoren për praktika me studentët.</p> <p>Salla e informatikës edhe biblioteka janë me hapësira të vogla, pajisja e laboratoreve nuk është si duhet, po ashtu edhe mungojnë në shumicën e rasteve reagenteve për kryerjen e ushtrimeve me studentët. Salla e mësimi ishin të pajisura me projektor.</p> <p>Në Laboratorin e patologjisë i cili ishte i pajisur mire, nuk zhvilloheshin praktikat me studentët por vetëm pjesa hulumtuese.</p> <p>Laboratori i Fiziologjisë, kishin të të programin online për zhvillimin e praktikave me studentët.</p> <p>Laboratori i diagnostikës Veterinare dhe Sëmundjeve Infektive, ishin të pajisura mire me pajisje Laboratorike, në të cilët kryheshin vetëm hulumtimet shkencore.</p> <p>Klinika e kafshëve të shoqërimit një pjesë ishte në proces të rikonstruimit, po ashtu edhe klinika për kuajt ishte në proces të rikonstruimit.</p> <p>Klinika e kafshëve të vogla, kishte spoertelin për pritjen e pacientëve, edhe dhomën e reminacionit si dhe sallën e kirurgjisë dhe anestezisë, ishte në procesin e rinovimit të dhomës për vendosjen e kafshëve pas operacionit kirurgjikal.Klinika e kafshëve të mëdha kishte nje sallë leksionesh, e cila ishte në procesin e rinovimit.</p> <p>Biblioteka ekzistuese e Fakultetit ka hapësira të mjaftueshme, diku 15-20 vende.</p> <p><i>(463 -Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit FMV.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete</p>	<p>Gjatë vizitës së klasave, laboratorëve dhe mjediseve të tjera në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare GVJ konstaton se shumica e mjediseve mësimore</p>

<p>elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies, por një pjesë e tyre ishin në procesin e rinovimit tërësor të tyre.</p> <p>Amfiteatrot dhe klasat mësimore ishin të pajisura me projektor. Ndërtesat e Fakultetit kishte internet.</p> <p><i>(463 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit_FMV.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare shumica e tyre ishin të pajisura me pajisje laboratorike të cilat shërbenin për hulumtimet shkencore të Stafit Akademik, po ashtu edhe në klinikat kishte pajisje që ishin në shërbim të studentëve për kryerjen e praktikave, por një pjesë të këtyre pajisjeve kanë nevojë për riparim e kalibrim.</p> <p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare kishte nevojë për pajisje të reja me qëllim të zhvillimit të programit e sidomos kërkimit shkencor. Në shumicën rasteve mungojnë reagentet dhe medikamentet për zhvillimin e aktivitetit mësimor, kunjëpjesë e stafit i sigurojnë vetëato.</p> <p><i>463 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit_FMV.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatonqë ka sallë kompjuterësh në kuadër të bibliotekës së Fakultetit të Mjekësisë Veterinare me një kapacitet 15 – 20 studentë, salla ishte e pajisur edhe me internet.</p> <p><i>(463 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit_FMV.pdf).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në kuadër të Universitetit Bujqësor të Tiranës ka marrëveshje bashkëpunimi me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Nr. 2666 prot, datë 24.06.2016; - Institutine Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, datë 13.03.2014, <p>GVJ rekomandon që të ripërtrihen marrëveshjet sidomos kushtet e veprimit në interes të zhvillimit të programit, po ashtu të zhvillohen edhe marrëveshjetë tjera. Hapsirat mjedisore sidomos sallat e leksioneve dhe laboratorët kanë hapësira jo të mjaftueshme për kryerjen e procesit mësimor përshkak të numrit të madh të studentëve.</p> <p><i>(463 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit_FMV.pdf).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatonqë Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka bibliotekën me hapësira të mjaftueshme (15-20), po ashtu ka edhe kompjuter në dispozicion, studentët e këtij Fakulteti po ashtu edhe Stafi Akademik munden t'i shfrytëzojnë edhe sallat e tjera në kuadër të Universitetit Bujqësor të Tiranës.</p> <p><i>(463 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit_FMV.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare GVJkonstatonqë biblioteka e cila është aktuale ka tekstet mësimore sipas programit, po ashtu ka edhe literature në gjuhë të huaja. Biblioteka e Universitetit ka fond më të madh librash mësimor në të dy gjuhët, ka revista shkencore, disa janë o-nline.</p> <p>GJV rekomandon pasurimin e bibliotekës së FMV me më shumë me literaturë në të dy gjuhët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka bibliotekën me rreth 10 kompjuterë, që i mundësojnë studentëve të përdorin këta kompjuter për përgatitje mësimore.</p> <p>TEEAL (Biblioteka Themelore Elektronike Bujqësore) në kuadër të UBT që i mundëson Stafit dhe studentëve të kenë qasje në revista shkencore, po ashtu ky program funksionon edhe në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, kjo është një gjë e mire për stafin edhe studentët që ta pasurojnë veten me informacionet e nevojshme të cilat munden ti shfrytëzojnë për punën e tyre hulumtuese. GVJ rekomandon që të pasurohet më shumë edhe të shfrytëzohet më shumë nga ana e Stafit Akademik edhe Studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se kompjuterët të cilët ndodhen në hapësirat e bibliotekës shfrytëzohen nga studentët për printim dhe për hulumtim të literaturës, dhe i kanë programet e nevojshme, të cilat munden të qasen studentët.</p> <p>GVJ konstaton që në Universiteti Bujqësor i Tiranës sipas planit të strategjisë synohet zhvillimi dhe rritja e fondit të literaturës në gjuhët e huaja edhe revistat shkencore. Biblioteka Shkencore disponon adresën në kuadër të UBT (biblioteka@ubt.edu.al) me anën e së cilës biblioteka ka mundësi të dërgojë informacion simultan tek i gjithë personeli akademik dhe ndihmës akademik. Informacionet e dërguara janë të lidhura me titujt e rinj në bibliotekë të literaturës në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, dhe janë një ndihmesë shumë e madhe për përditësimin e literaturës në kuadër të programeve mësimore por edhe të punës kërkimore. Biblioteka gjithashtu informon për aktivitetet e ndryshme që zhvillon.</p> <p>Edhe Google site përdoret shumë nga Stafi akademik, për shpërndarjen e informacionit lidhur me programin e studimit tek studentët. <i>(https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/?pli=1)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Edhe Google site përdoret shumë nga Stafi akademik, për shpërndarjen e informacionit lidhur me programin e studimit tek studentët. <i>(https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/?pli=1)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit</p>	<p>Biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare punon gjatë orarit të punës dhe vë në dispozicion hapësirat (15-20 vende) për studentët si edhe ka 10 kompjuterë në përdorim.</p>

mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	GVJ konstaton që hapsira në bibliotekën e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare si dhe kompjuterët në sallën e bibliotekës janë të mjaftueshëm për kryerjen e aktivitetit mësimor në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare. (463 - Të dhëna të plota për infrastrukturën në funksion të programit të studimit_FMV.pdf).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>UBT disponon ZSS e cila ka përgjegjësin dhe sekretaren e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, nëpërmjet kësaj zyre administrohen çdo gjë që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Universiteti ka një bashkëpunim me AKP (duke realizuar regjistrimin e studentëve nga ZSS në sistemin e AKP http://qsha.gov.al/akp/ për të vazhduar më pas me pajisjen e tyre me numrin e matrikulit. Po ashtu në këtë ZSS ruhet në mënyrë fizike dhe elektronike të gjitha të dhënat për studentët nga fillimi deri në diplomim në dosjet e tyre (të gjitha çertifikatat e notave). Gjithashtu UBT ka marrëveshje me RASH https://www.rash.al/sq/ me anë të së cilës realizon menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave.</p> <p>Në kuadër të UBT-së dhe Fakultetit të Mjekësisë Veterinare GVJ konstaton se gjatë vizitës në sekretarinë për Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, ku bëhet regjistrimi i studentëve siaps kuotave në ZSS. Të gjitha të dhënat të dhënat për disjet e studentëve ruhen në mënyrë fizike dhe elektronike, duke u mbështetur në rregulloren e administrimit të informacionit. (Rregullore e DZHKKVI, kreu IV, neni 12-17 182 ESSE3, sistemi funksionimit të sekretarisë mësimore).</p> <p>Mandej bëhet ruajtja dhe regjistrimi i të gjitha procesverbaleve të provimeve që i nënshtohen studentët deri në diplomim, ruajtja e të dhënave është konfidenciale për secilin student të gjitha niveleve.</p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e	<p>DBNJ nëpërmjet të specialistit të zyrës së burimeve njerzore menaxhon në mënyrë korrekte dokumentacionin për personelin akademik dhe ndihmës akademik, ndjek procedurat për shpërndarjen e kontratave si edhe menaxhimin e afateve kohore të kontratave.</p> <p>Departamentet në kuadër të Fakulteteve përpilojnë ngarkesat mësimore për stafin akademik si dhe përpilimin e afateve të provimeve të cilët iu nënshtrohen studentët.</p>

programit.	GVJ konstaton që Drejtoria e burimeve njerëzore, respektivisht zyrtari i zyrës së burimeve njerëzore, krijohen dosjet për stafin Akademik, ndihmës akademik dhe administrative si dhe i përditsojnë këto dosje, i shikojnë afatet kohore të kontratave, po ashtu edhe departamentet ruajnë të dhënat lidhur me stafin akademik dhe ndihmës akademik si dhe përpilojnë planin mësimor dhe afatet e provimeve përstudentët. (Rregullore DBNJP, neni 4, neni 7, Rregullore e FMV, kreu II, neni 13, pika VI)
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>UBT disponon sisteme të integruara informacioni si universiteti i parë pilot bashkëpunues në projektin e RASH. Ky projekt garanton sisteme të menaxhimit gjithëpërfshirës të informacionit duke mundësuar sigurimin e informacionit strategjik, duke kombinuar aplikacionet kryesore administrative si: të mësuarit dhe studenti, kërkimin, burimet njerëzore, kontabiliteti, etj., me anën e tre moduleve kryesore: Esse 3, UGOV, dhe IRIS.</p> <p>Gjatë verifikimit GVJ konstaton që UBT-ja ka një sistem RASH, i cili garanton regjistrimin dhe menxhimin e të dhenave të dokumentacionit të studentëve të Mjekësisë Veterinare.</p> <p>Gjithashtu UBT ka site për Departamentet dhe pedagogët. Aplikacionet Esse 3 janë lehtësisht të aksesueshme nga personeli akademik dhe nga studentët.</p> <p>(https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/).</p> <p>Personeli akademik përgatit dhe vendos informacione dhe dokumente të lidhura me programin mësimor Mjekësi Veterinare, leksione, skripte, etj.(Shembull të linkut të ESSE 3:</p> <p>https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/Home.do)</p>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	<p>Studentët kanë qasje në dokumentacion, kanë kodin unik. Po ashtu GVJ konstaton që personeli akademik, kanë të hapura adresat elektronike, të cilë ia japin informacionet studentëve në lidhje me programin e studimit. Po ashtu edhe përmes sajtit google, stafi akademik ngarkon të dhëna (tekste mësimore, ligjëratë në power point). (Shembull, Website të pedagogut:</p> <p>https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/)</p>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>Informacionet e hedhura nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare dhe personeli akademik i tij në “site pedagog UBT”, “ESSE3”, etj. si psh.: Raportet Mësimore e Kërkimore, Pyetsorët, leksionet, vlerësimet gjatë vitit, vlerësimi përfundimtar, etj. janë vizibël në kohë reale, ato janë gjithashtu të aksesueshme nga studentët dhe organet drejtuese dhe titullarët etj.</p> <p>GVJ konstaton që Menaxhimi garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative. Personeli Akademik në mënyrë elektronike përmes uebfaqes postojnë leksionet në powerpoint si dhe informata të tjera të cilët studentët kanë qasje në këto të dhëna.</p>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme,	<p>Në faqen ueb të UBT-së, respektivisht të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, GVJ konstaton se postohen të dhënat për programin dhe për oraret mësimore si dhe informata të tjera por shumica në gjuhën</p>

publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	shqipe, mirëpo postohen edhe të dhëna të tjera aplikacione për projekte ndërkombëtare në gjuhën Italiane dhe Angleze më së shumti. (www.ubt.edu.al)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Hartimi i Buxhetit fillon nga Fakultetit i Mjekësisë Veterinare, respektivisht planet buxhetore sipas kërkesave hartohen në Departamente sipas nevojave të tyre, Buxheti shpërndahet në disproporcion të barabartë për secilin Departament. Plani i plotë i Buxhetit pasi i kalon instancat e Fakultet, miratohet në UBT.</p> <p>GVJ konstaton që Fakulteti Mjekësisë Veterinare, respektivisht Departamentet hartojnë buxhetin sipas nevojave dhe shpërndarja buxhetore bëhet në mënyrë të barabartë, ku UBT-ja duke i respektuar ligjet në fuqi, së pari e shikon buxhetin e ardhur nga Fakulteti dhe mandej miratohet.</p> <p>Fakulteti nuk bënë ndonjë planifikim të plotë për një cikël studimi, por edhe mbështetja financiare nuk është sa duhet nga ana e Universitetit, duke patur parasysh nevojat që ka Programi i ciklit të dytë Mjekësi Veterinare. (Vendim Këshilli Administrimit Nr. 1, datë 08.01.2016, "Për miratimin e detajimin e buxhetit për vitin 2016).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Plani i financimit të programit të studimit të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare përmban dy kollona kryesore: të ardhurat dhe shpenzimet. Mjetet për investime janë të vogla dhe nuk figurojnë shpenzimet për mirëmbajtjen e mjediseve, pajisjeve laboratorike, kimikateve, reagensëve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line.</p> <p>GVJ konstaton që buxheti për kryerjen e veprimtarive mësimore e shkencore që hartohet nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare nuk është i mjaftueshëm për realizimin e nevojave për programin Msc (PI) në Mjekësi Veterinare, edhe pse ai plotësohet edhe nga të ardhurat kontratave dhe donacioneve nga projektet. (Vendim Këshilli Administrimit Nr. 1, datë 08.01.2016, "Për miratimin e detajimin e buxhetit për vitin 2016)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifet e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose</p>	<p>Në UBT, respektivisht për Fakultetin e Mjekësisë Veterinare konstatojmë që kryhet auditimi i brendshëm edhe i jashtëm, risqet që dalin nga auditimi (raportet) diskutohen në nivel Fakulteti dhe Senati të UBT-së, po ashtu bëhen raportet edhe publike.</p> <p>GVJ konstaton që bëhet një analize tre vjeçare për planifikimet financiare, por ende nuk bëhet ndonjë planifikim për mbështetje të</p>

ndarjen e burimeve financiare.	posaçme për ciklin e dytë të programit Mjekësi Veterinare.			
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	<i>(Buxheti për vitet 2016/2017/2018, Programi buxhetor afatmesëm i FMV 2019-2021)</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	<p>Administrata e Fakultetit të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare si edhe UBT-së në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, dokumenton raportet financiare për tre vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p> <p>GVJ Konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka në dispozicion Buxhetin të miratuar nga Shteti, tarifat e studentëve, donacionet dhe projektet e shërbime të tjera, dokumentohet raporti financiar për tre vitet e kaluara akademike, edhe buxheti aktual në njëfarë mënyre garanton realizimin e plot të ciklit të dytë master në Mjekësi Veterinare.</p> <p>GVJ rekomandon që institucioni duhet të adresojë më fort pranë institucioneve përgjegjëse, UBT-ja dhe Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave, nevojën për njëmbështetje më e madhe financiare duke qënë se programi i MV është specific.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, pranimi i studentëve në programin e integruar të studimeve Msc në "Mjekësi Veterinare" është kryer në mbështetje të të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 216, datë 20.4.2018, për vitin akademik 2018–2019 ² .

² Nga takimi me Zv.dekanin, GVJ u informua, se janë regjistruar dhe i është bërë njohja e krediteve të studentëve nga programi 2 vjeçar jouniversitar profesional në "Menaxhim Veterinar" (120 kredite) në programin Msc (PI) në "Mjekësi Veterinare", duke i regjistruar studentët në vitin e tretë (gjithsej 19 studentë në vitin 2018-2019, por kjo praktikë kishte disa vite që kryhej). GVJ u informua, se kjo praktikë nga QSHA është vlerësuar jo në përputhje me

	<p>Regjistrimi i studentëve bëhet pranë ZSS kur ata paraqesin dokumentacionin përkatës. Studentët në këtë zyrë mundën të gjejnë të gjitha informacionet. Dosjet e studentëve dhe të gjitha informatat e tjera si adresat elektronike dhe numrat e telefonit administrohen nga ZSS.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e Studentëve pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës, që ishte present referentja e studentëve për Mjekësi Veterinare, GVJ konstatoi se në këtë zyrë bëhet regjistrimi i studentëve, i caktohet numri i regjistrimit, po ashtu nga ZSS administrohen edhe adresat elektronike dhe numrat e telefonit të studentëve.</p> <p>Duhet theksuar që kuotat i përcakton Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, ato miratohen në senatin e Universitetit (sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 216, datë 20.4.2018, për vitin akademik 2018–2019).</p> <p>Fakulteti jep një garanci përcjelljen e studentëve deri në diplomim, për të gjitha procesverbalet e notave ruhen kopja fizike edhe elektronike në zyrën e studentëve po ashtu edhe të gjitha informatat e studentëve.</p> <p>Diplomimi i studentëve bëhet duke e mbrojturë punimin e diplomës, që miratohen nga Dekanati dhe bëhen publike. Komisioni si dhe Zv- Dekani për mësim menaxhojnë në tërësi procedure e diplomimit të studentëve (Rregullore e brendshme FMV, neni 75-79, Rregullore e diplomimit FMV).</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi zbatohet në përpikmëri barazia gjinore dhe konkurrenca e drejtë në mes kandidatëve.</p> <p>Pranimi i studentëve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MASR. Pranimi i studentëve të rinj bëhet pasi i janë nënshtruar maturës shtetërore nën administrimin e MASR. Kandidatët e pranuar kanë të drejtën e vazhdimit të studimeve, vetëm nëse regjistrohen në zyrën e ZSS.</p> <p>(Rregullore FMV neni 19, 21, Rregullore e studimeve universitare UBT, neni 39, Kreu X, nenet 67-72)</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë transparente dhe të hapura për publikun.</p> <p>Gjatë vizitës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, GVJ konstaton se kriteret, përzgjedhja, transferimi i studentëve bëhet në mënyrë transparente duke u mbështetur në ligjin e Arsimit të lartë dhe rregulloret e brendshme të Fakultetit. Pra të gjitha informatat janë publike. (Rregullore e brendshme FMV, neni 19, 20, 21, Rregullore e brendshme FMV, neni 75-79)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e integruar të studimeve. Institucioni bashkëpunon me</p>	<p>GVJ konstaton se gjatë analizimit të dokumentacionit mbështetës të ofruar, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, respektivisht Universiteti Bujqësor i Tiranës nuk përcaktojnë kriteret të veçanta për çdo vit, por ato i bënë Ministria e Arsimit sipas ligjit të Arsimit të Lartë, çdo kandidat që mbaron shkollën e mesme, mature shtetërore, (nota mesatare sipas ligjeve dhe</p>

ligjin 80/2015 (sipas Ligjit 80/2015 nuk lejohen njohje /transferime të krediteve në cikle të tjera për programet jo universitare). Këta studentë sipas Vendimit dhe ligjeve aktuale duhen të çregjistrohen sepse QSHA nuk i pajis me numra matrikulimi (duke u mbështetur në një vendim zyrtar nga QSHA)

Adresa: "Rruga e Durrësit" E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423 web site: www.ascal.al Faqe 58

<p>strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>regulloreve, vendimit të këshilli të ministrave) ka të drejtë të regjistrohen në programin cikli i dytë master në Mjekësi Veterinare.</p> <p>Çdo vit në programin cikli i dytë Master i Shkencave në “Mjekësi Veterinare” regjistrohen 110 studentë (duke u mbështetur në informatat zyrtare). GVJ mendon që numri 110 i studentëve në vit është i madh, përsyre të hapsirave jo të mjaftueshme në laboratore edhe përshkak të ndarjes së numrit të madh të studentëve në grupe. Rekomandohet që kuotat të analizohen mire, përsyre që cilësia e realizimit të programit cikli i dytë master në Mjekësi Veterinare të jetë më e mirë.</p> <p>Pra numri 20-25 studentë në grupe në ushtrime dhe praktika është madh, dhe përkushtimi ndaj tyre nuk mund të jetë efektiv për shkak të hapësirave.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka zyrën për karrierë, dhe ata çdo vit në kuadrin e UBT-së realizojnë panairin e karrierës, ku kanë një stendë të veçantë.</p> <p>Në këtë stendë gjendet gjithçka që kandidatët për studentë kanë nevojë, kurse kriteret e pranimit përcaktohen nga Ministria e Arsimit. Sipas Përfaqësuesesë zyrës për karrierë interesimi i studentëve nuk është i kënaqshëm. (L. 80/2015: Neni 76, Pika 3)</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Gjatë vizitës në Fakultetin Mjekësisë Veterinare, respektivisht në takimin me Dekanen dhe përgjegjësit e departamenteve, GVJ konstaton se përzgjedhja e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara realizohet në bazë të kriterëve dhe politikave të Ministrisë së Arsimit. Por Fakulteti konkludon që për këto shtresa, profesioni i Mjekut Veteriner është një profesion i vështirë për këtë arsye nuk është i favorshëm.</p> <p>(Për regjistrimin online të fituesve të shpallur nga AKP nga sekretaria mësimore në portalin e Maturës Shtetërore (matura.akp.gov.al))</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ konstaton që kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet të tjera janë përcaktuar në rregulloren e studimeve të fakultetit dhe të ligjit të Arsimit të Lartë. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare aktualisht ka programin e studimit në gjuhën shqipe, mirëpo në të ardhmen lind nevoja të ketë programe në gjuhë të huaja. Meqenëse FMV nuk ofron studime në gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe, kështu që nuk ka kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera jo shqip folëse.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë</p>	<p>GVJ konstaton që UBT harton politika në ndihmëtë studentëve (bursa) dhe kriteret bëhen publike (http://ubt.edu.al/en_US/bursat-e-studenteve/).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Kurrë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi V.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare reaspekton të gjitha procedurat në lidhje</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit” E-mail: info@ascal.al

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423 web site: www.ascal.al

<p>dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>me përparimin apo marrjen e informacionit të hollësishëm në lidhje me programin nga ana e studentëve.</p> <p>Leksionet, program me numrine kredive, syllabuset si dhe CV e stafit Akademik janë online, dhe studentët kanë qasje në këto dokumente.</p> <p>Gjatë vizitës në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, GVJ konstaton se dokumentacioni ofruar si dhe Dokumentacioni online (Kurrikula dhe CV e stafit akademik, iu mundësojnë studentëve qasje, kurse kalimi i tyre nga një vit në tjetrin është i organizuar sipas rregulloreve të brendshme të Fakultetit.</p> <p>http://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-mjekesise-veterinare/departamenti-i-moduleve-morfo-funksionale/stafi-akademik/#,</p> <p>http://ubt.edu.al/wp-content/uploads/2019/02/Kurrikula_FMV_Master-i-Shkencave.pdf),</p> <p>(Shembull google site pedagog https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/s-d/home/leksione-dhemateriale-ndihmese)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare sipas Statutit dhe rregulloreve të brendshme behet njohja e provimeve nga transferimi brenda të të njejtit cikël studimi. Po ashtu lejohet edhe nga transferimi nga Universitetet tjera, Departamenti harton mandej planin për shlyerjen e detyrimeve.</p> <p>GVJ konstaton gjatë vizitë në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, se studentëve sipas kërkesës së tyre, po ashtu shqyrtimi kërkesës për transferim, ju njihet e drejta e transferimit brenda të të njejtit cikël studimi, në të cilin Departamenti mandej harton planin e shlyerjes së detyrimeve të mbetura.</p> <p><i>(Rregullore e studimeve universitare UBT, Kreu X, neni 68, pikat a, b, c).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare kanë akses online, në syllabuset dhe programin e studimit, po ashtu ata janë të informuar për çdo gjë në fillimin e vitit akademik.</p> <p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentave të ofruara dhe të analizuara se studentët njoftohen për kriteret nga Profesorët e lëndëve në bazë të syllabuseve në fillim të vitit akademik. <i>(Rregullore e Programit të studimit në FMV)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare diplomohen me punim të tezës së diplomës. Studentët temën e diplomës e regjistrojnë në vitin e 4 të studimeve, pranë departamenteve si dhe tek Zv Dekani për Shkencë. GVJ konsaton se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, kryesisht departamentet, nxjerrin temat për punimin e diplomës (Sipas nenit 75, pika 5 e Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”), ato bëhen publike, përarsye të kërkimit shkencor edhe janë të njoftuar studentët.</p> <p><i>(Rregullore e diplomimit FMV në web FMV/UBT, Listat e tezave të diplomave, Lista Projekte me përfshirje studentët)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare është Institucion unik në Republikën e Shqipërisë. Fakulteti publikon udhëzues dhe bën informimin e studentëve të rinj përmes Panairit të Karrierës. GVJ konstaton se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare hartohen dhe publikohen udhëzues dhe organizohen</p>

informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	takime të hapura për informimin e të studentëve të ardhshëm, po ashtu, edhe përmes Panairit i cili realizohet çdo vit nga UBT dhe ku Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka standën dhe vendin e tij, ofron të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët e ardhshëm, i cili është publik dhe online në faqen ueb.(Urdhër Rektori_Vizita në shkolla të mesme)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare studentët njoftohen për të gjitha procedurat në lidhje me programin e studimit gjatë gjithë periudhës së studimit.GVJ vlerëson se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare studentët informohen për të gjitha detajet e programit nga fillimi I studimit deri në përfundimin e tyre.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare në faqen elektronike të çdo stafi akademik jepet informacioni i detajuar për lëndët mësimore si dhe për ligjëratat në powerpoint për studentët. GVJ vlerëson se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare në ueb-faqen e UBT, Stafi akademik vazhdimisht poston planin dhe planprogramin e lëndëve, në të cilën studentët njoftohen përmes kësaj faqe ueb. (https://sites.google.com/a/ubt.edu.al/sitemanager/)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare ka mangësi për informimin e studentëve për mundësitë e punësimit. GVJ konstaton se UBT-ja nuk kanë metoda adekuate për ti informuar studentët për punësim. Në kuadër të UBT egziston zyra e karrierë ALUMNI, të cilat i merr të dhënat për punësimin e studentëve, mandej këto të dhëna përpunohen dhe bëhen publike.Por UBT-ja çdo vit organizon Panairin e karrierës, që organizohet nga Qendra e Karrierës dhe Alumni. Po ashtu UBT-ja ka fituar një project ERASMUS +“Graduates advancement and development of university capacities in Albania, GRADUA” qe do ta ndihmoj shumë këtë proces. (Raportim projekti GRADUA)
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare studentët kanë qasje në informata në lidhje me programin e studimit nëpërmjet zyrave të Fakultetit, po ashtu edhe përmes faqes web të UBT-së GVJ konstaton se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare studentët vazhdimisht kanë qasje në informata si përmes tabelave që në hyrjet të korridorit në ndërtesën e Fakultetit po ashtu edhe në formën elektronike.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare informacioni i plotë në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit, i cili, gjendet lehtësisht në zyrat e FMV. GVJ

menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	konstaton se studentët e marrin informacionin zyrat e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare si edhe nga faqja uebe UBT-së.			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve. GVJ konstaton se studentët e marrin informacionin nga ana e faqes web, ku çdo pedagog zotron një llogari individuale në sistemin Esse3, ku shërben si mjet komunikimi në mes pedagogëve, studentëve e stafit administrative. (https://www.ubt.esse3.u-gov.rash.al/Home.do)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Në Fakultetin e Veterinarisë për programin e studimit mbahet statistika për numrin e studentëve të diplomuar. Kohët e fundit kjo ka evoluar shumë për shkak të zhvillimit të teknologjisë së informacionit.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare mban statistika sa i përket diplomimit të tyre ndërvite, po ashtu kohët e fundit kjo ka evoluar më shumë për shkak të zhvillimit të teknologjisë së informacionit. (Tabela për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve, sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje) <u>Numri i studentëve</u> Në sekretari u deklarua numri i regjistrimeve sipas kuotave 110 studentë në çdo vit. Në vitin 2018-2019 janë regjistruar rreth 110 studentë të rinj, por së bashku me studentët që janë në vitet ndërmjetëse janë gjithsej 690 studentë (në të 5 vitet e studimit). Studentët ishin të pajisur me numrat e matricimit (<i>shih footnote 1 Kriteri 1, Standardi V-1</i>) (Dok. 405 Evidenca e stud. regjistruar_V.2018-2019.pdf)
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e integruar të studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit. GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare disponon të dhëna statistikore për regjistrimin dhe çregjistrimin e studentëve. Në ZSS gjenden të dhëna të plota dhe të sakta për numrin e studentëve të regjistruar. (Tabela për regjistrimin, ecurinë, diplomimin e studentëve,

	<i>sipas viteve akademike, nota mesatare në hyrje dhe në dalje)</i>			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në Fakultetin e Veterinarisë të dhënat statistikore menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Esse3, i cili shërben si një mjet shumë efikas komunikimi mes Pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ dhe lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar. Në të dhënat ka akses çdo student i interesuar dhe pedagogu i lëndës. GVJ konstaton që të dhënat për studentët e ciklit të dytë Master i Shkencave në Mjekësi Veterinare, përpunohen edhe menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit Esse3, edhe në formën elektronike që kanë akses vetëm personat e autorizuar.(Statuti, neni 2, pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7; neni 59 pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6)			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare përpunon dhe harton raporte analitike sa i përket profileve të studimit, por nuk ka informacion për punësimin e studentëve mbas përfundimit të studimeve. Evidenca e notave mesatare për 5 vitet e fundit të marur nga Zyra e studimeve dhe të studentëve: <ul style="list-style-type: none"> - viti 2014-2015 nota mesatare 7.5 - viti 2015-2016 nota mesatare 6, - viti 2016-2017 nota mesatare 7 - viti 2017-2018 nota mesatare 7.6 ZKA kohët e fundit ka bërë një pyetësor, me qëllim të grumbullimit të informacionit për punësimin e studentëve. (406Mesataret e studenteve ne përfundim te studimeve.pdf)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare sipas ligjeve në fuqi, i ka angazhuar studentët në të gjitha komisionet relevante të cilat lidhen me mbikqyrjen dhe rritjen e cilësisë së Programit të studimit, po ashtu edhe në përbërje të Senatit ka tre student. GVJ konstaton që sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Statutit të UBT, studentët kanë të drejtën e përfshirjes në këshillin e Fakultetit dhe Senatit me përfaqësuesit e tyre, po ashtu edhe në komisione vendimmarrëse(Statuti_UBT, neni 64, pika 2, Statuti_UBT, neni 65)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare garanton plotësisht përfshirjen reale të studentëve në vendimmarrjet e fakultetit. Studentët marrin pjesë me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur nga trupa studentore në komisionet e vlerësimit të kurrikulave, të sigurimit të cilësisë së institucionit dhe etikës. Por kohët e fundi pjesëmarrja e studentëve nuk ka qenë aktive në

<p>lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>këto komisione. Porata e kanë të drejtë me marrë pjesë me përfaqësuesit e tyre.</p> <p>GVJ konstatongjatë takimit me studentët se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, studentët kanë përfaqësuesit e tyre në komisione për kurrikulën, etikën, mirëpo këto komisione nuk kanë funksionuar si duhet kohët e fundit.</p> <p><i>(Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese në FMV, komisionet e etikës dhe sigurisë së cilësisë në FMV)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe përgjegjësit e departamenteve GVJ konstatoi se plani mësimor dhe syllabuset e lëndëvetë formimit të përgjithshëm kanë nevojë të ristrukturohen, për t'ju përshtatur më mirë formimit të mjekut veteriner. Gjithashtu, shpërndarja e lëndëve në semestra, sipas rëndësisë në formimin profesional të studentëve dhe ngarkesës në orë, ka nevojë për rishikim me përparësi.</p> <p>Po ashtu Fakulteti ka ndarë grupet me 20-25studentë, ky numër është tejet i madh, sidomos për lëndët klinike. Meqenëse edhe studentët e kërkuan, rekomandohet që të ulet numri studentëve në grupe me qëllim sigurimin e cilësisë.</p> <p>Fakulteti garanton transferimin e studentëve ndërvite, sipas të dhënave të ofruara nga këta student gjatë kërkesës e cila shqyrtohet nga Dekanati(<i>shih footnote 1, Kriteri 1 Standardi V-1</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare kanë përfaqësimin e tyre në komisione vendimmarrëse, por këto komisione nuk funksionojnë si duhet (në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimeve).</p> <p>GVJgjatë vizitësori informacionqë ato janë të lirë t'i shprehin mendimet e tyre. Por në disa raste janë neglizhent e në disa raste aktiv.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u mundësohet të shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare.</p> <p>Gjatë takimit me studentët dhe diskutimit me ta, GVJ, konstatoi se ata kanë qasje në vlerësimin për secilin staf akademik, por pjesëmarrja nga ana e tyre në vlerësim është e ulët.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>X</p>				

Standardi V.6

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Personeli Akademik i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare merr pjesë në mënyrë të vazhdueshme në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi është i evidentueshëm në dosjet e personelit në departamente dhe në dosjet e tyre në zyrën e kualifikimit shkencor.(466 Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin)</p>

	<p><i>shkencor.pdf</i></p> <p>GVJ konstaton që Stafi Akademik i Fakultetit Mjekësi Veterinare janë aktiv sa i përket pjesmarrjes në Konferenca Ndërkombëtare. Sipas informacionit që morëm edhe vet UBT organizon Konferenca ndërkombëtare, po ashtu Stafi akademik mundën ti botojnë rezultatet e tyre shkencore në revistën nërkombëtare “Albanian Journal of Agricultural Sciences (AJAS)”.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute me qëllim realizimin e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka bashkëpunime ndërkombëtare me Universitete të huaja e konfirmuar kjo në zbatimin e programeve të partneritetit Erasmus+ dhe CEEPUS.</p> <p>GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka marrëveshje bashkëpunimi me Univeritete të tjera. Edhe Stafi Akademik edhe studentët mundën të Universitetet të jera në kuadër të Projekteve Erasmus + dhe CEEPUS, me qëllim të zhvillimit të metodologjisë mësimore dhe marrjes së eksperiencës të reja.</p> <p><i>(492 Lëvizjet e Stafit _UBT_2017-2018.pdf).</i></p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe të publikojnë studime e punime shkencore.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, është angazhuar për të siguruar një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj vendas në projekte kërkimore shkencore, por përfshirja e studentëve në këto projekte shkencore nuk është e kënaqshme.</p> <p>GVJ vlerëson që Stafi akademik kryen veprimtari kërkimore shkencore, por studentët nuk përfshihen në këtë veprimtari shkencore, arsya është tek mungesa e komunikimit jo duhet Profesor/Student.</p> <p><i>(467 UBT_FAKULTETI KUALIFIKIMI DHE KERKIMI SHKENCOR 2014-2019.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore-shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare kërkimi shkencor realizohet nga ana e stafit akademik si departamentet me të dhënat që posedojnë për publikimet e Stafit i raportojnë punën shkencore të tyre në Fakultet. Rezultatet e kërkimit bëhen publike nëpërmjet botimeve në revista shkencore. Fakulteti ka realizuar botime të vecanta të realizuara në kuadrin e konferencave shkencore apo evenimenteve si psh 65 vjetori i Fakultetit.</p> <p>GVJ vlerëson që në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, UBT në bazë të informacionit nuk krijon ndonjë mbështetje financiare, me qëllim të realizimit të publikimeve shkencore, Stafi Akademik publikon rezultatet e tyre në revista të Ndërkombëtare dhe Vendore (në ratin e evenimentit të 65 vjetorit të Fakultetit Stafi edhe studentët si proceedings kanë publikuar rezultatet e tyre. Por në përgjithësi studentët nuk janë aktivë sa duhet në publikimet shkencore.</p> <p><i>(466- Të dhëna të plota të aktiviteteve për kualifikimin dhe kërkimin shkencor.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare personeli akademik angazhohen shumë pak në studime inovative dhe patenta për shkak të mjaft vështirësive që paraqiten gjatë kërkimit Shkencor.</p> <p>GVJ konstaton që në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare personeli akademik përshkak të vështirësive financiare që i paraqiten gjatë</p>

	kërkimit shkencor, angazhohen shumë pak në studime inovative dhe patenta.			
Kriteri 6. Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare Personeli akademik mbështet studentët në kryerjen e analizave, matjeve, studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të temave të diplomës. GVJ vlerëson, që në bazë të informacionit që kemi, Personeli Akademik mbështet dhe ndihëmon student për kryerjen e analizave, me qëllim të përfundimit sa ma të mire të punimit të diplomës dhe diplomimit të tyre. (545-Lista_Udhëheqës_Temat e Diplomes_1819.pdf)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.7	
Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare respektivisht UBT-jaka bashkëpunime me organizmat shkencorë kombëtarë me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit. Fakulteti ka marrëveshje bashkëpunimi me ISUV, me Ministrinë e Bujqësisë, Utoritetin Kombëtar të Ujërave etj. Këto marrëveshje mundësojnë realizimin e praktikave nga studentët. GVJ konstaton që në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, UBT ka bashkëpunime me institucione të tjera me qëllim të realizimit të praktikave dhe hulumtimit nga ana e studentëve (Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, viti 2016 me numër protokoli 2666, të dates 24.06.2016, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të dates 13.03.2014), këto marrëveshje duhen të ripërtërihen dhe të evidentohet në këto marrëveshje. Ripërtirja e këtyre marrëveshjeve si dhe realizimi i marrëveshjeve të tjera do të jetë në dobi të stafit akademik dhe studentëve të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare.
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare ka një përvojë të mirë në metodologjinë e kërkimit prej stafit dhe prezantimin e arritjeve kërkimore. Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare është realizuar shkolla e doktoraturës. Kanë përfunduar nga më shumë se 100 studentë të ciklit të tretë të studimeve. GVJ konstaton se nga Stafi akademik përdoren metoda hulumtuese, edhe po ashtu publikojne punime shkencore në Revista Ndërkombëtare. Para disa viteve ka qenë e hapur program për ciklin e tretë (Doktorata), të cilët studentët kanë publikuar punimet e tyre. Duhet të theksojm që Fakulteti sëbashku me drejtuesit të mendojnë module për hulumtimet shkencore, që të mundësohet tek studentët marrje eksperiences, sepsederi më tani përfshirja e studentëve në hulumtimet shkencore nuk është e kënaqshme.
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare nuk ka patur angazhim të

të përfshirjes së studiuesve të rinj vendës dhe të huaj në projekte kërkimore.	studentëve të huaj në projekte kërkimore, kjo pasi edhe numri i projekteve me natyrë kërkimore ka qenë i pakët, po ashtu edhe studentët e fakultetit përfshihen pak në kërkimet shkencore.			
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare angazhohet të sigurojë projekte kërkimore që ti përfshijë studiuesit e rinj, por përfshirja e studentëve është e ulët në këto projekte, nuk ka patur projekte të kërkimit shkencor ku janë përfshirë studentët të huaj. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare si dhe UBT-jakabashkëpunime me kërkuesit shkencorë të huaj. Kërkuesit e huaj janë vazhdimisht të pranishëm në evenimentet shkencore të fakultetit, bashkëpunimit në fushën e projekteve të përbashkëta dhe botime serioze ndërkombëtare, të cilat i publikojnë punimet shkencore së bashku në revista me recension ndërkombëtar. GVJ konstaton në bazë të CV të stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të ofruara dhe informacionit që kemi, ky institucion ndjek një politikë bashkëpunimi, ku Profesorët Vendas kanë publikime shkencore të botuara së bashku me Profesor të huaj. (501-Lëvizjet e Stafit të Huaj FMV 2017-2018.pdf)			
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare në mënyrë të vazhdueshme, veçanërisht gjatë 5 viteve të fundit ka një numër të madh të rritur në mënyrë më progresive të mundshme të mobilitetit të studentëve në kuadër të projekteve CEEPUS dhe ERASMUS +.			
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	GVJ konstaton se Fakulteti ka projekte si: Erasmus + dhe CEEPUS, ku një pjesë e madhe e studentëve kanë patur mundësin për një semestër të ndjekin ligjëratat teorike e praktike në Universitete të huaja. Po ashtu edhe në Fakultetin e Mjekësisë e kanë vizituar shumë studentë të huaj. (439- Lëvizjet e Studenteve UBT 2016-2017.pdf) Fakulteti i Mjekësisë Veterinare për shkak të përfitimit të stafit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar, fton për veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik të huaj, për periudha të ndryshme kohore si programet e mobiliteteve CEEPUS dhe Erasmus+. GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar, shumë Profesor të huaj dhe student të huaj e kanë vizituar Fakultetin përmes Projekteve Erasmus+ dhe CEEPUS, Profesorët vendor së bashku me Profesorët e huaj kanë publikuar së bashku. (501- Lëvizjet e Stafit të Huaj FMV 2017-2018.pdf)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.8

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Në Universitetin Bujqësor të Tiranës prej 5 vitesh informimi i studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve realizohet në Qendrën e Karrierës dhe ALUMNI.</p> <p>GVJ konstaton në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare viteve të fundit studentët informohen për projekte të ndryshme, po ashtu edhe për shërbimin e tyre përmes webfaqes së UBT-së po ashtu edhe përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumni, por në bazë informacionit nga kjo zyrë interesimi i studentëve nuk është aq i madh. Por edhe kjo Zyrë është aktive në informata vitin e fundit.</p> <p><i>(516- 10_Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale për studentët e diplomuar_Emrat me te verdhe.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka ngritur prej 5 vitesh Qendrën e Karrierës dhe Alumni. Qendra e Karrierës dhe Alumni ka ndërtuar një database të studentëve që diplomohen në UBT me synimin për të ndjekur punësimin e tyre deri në pesë vjet. GVJ konstaton se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare se vitin e fundit Zyra e Karrierës dhe Alumni dhe ajo e këshillimit për studentët është më aktive për të informuar studentët për programin e studimit, po ashtu edhe për të patue një informacion për të diplomuarit dhe të punësuarit e Studentëve, kanë bërë një pyetësor. GVJ rekomandon që të punohet më shumë rreth informimit sa më të drejtë të studentëve për mundësi të ndryshme.</p> <p><i>(549- 49_Trajnimet profesionale të mëtejshme, për studentët e diplomuar.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Punësimi si veteriner klinikist në drejtim të përmirësimit të shëndetit të kafshëve të shoqërimin, konsiderohet një nga mundësitë më të mëdha të punësimit në këtë profesion. ZKS në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare nuk mund të themi që është në lartësinë e duhur në mënyrë që të orientoj dhe mbështes studentët, në funksion të paraprirjes së një karriere të suksesshme.</p> <p>Grupi Vlerësues konstaton se studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumni dhe Zyrën e Këshillimit për Studentët mund të informohen drejt për programin e studimit. Por meqenëse stafi që i përfaqëson këto zyra është shumë i vogël, aktiviteti i tyre nuk është aq sa duhet të shërbejë për këshillimin dhe orientimin e studentëve të Mjekësisë Veterinare. QKA dhe ZKS nuk realizojnë studime të mirëfillta mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit gjatë mbarimit të studimeve. QKA ka ndërmarrë një veprimtari të tillë në nivel institucional nëpërmjet përfshirjes në një anketim të studentëve të cilët kanë mbaruar studimeve vitin e fundit.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>GVJ konstaton që Zyra e Karrierës dhe Alumni vitin e fundit është më aktive, po ashtu këta e kanë zhvilluar një anketë për studentët që kanë diplomuar, këto të dhëna i kanë përpunuar, me qëllim të marrjes së informatave të sakta rreth punësimit të studentëve mbas diplomimit, numri i anketuesëve nuk ka qenë aq i madh. (Raporti QKA dhe pyetësori) GVJ rekomandon që Zyra e Karrierës dhe Alumni të punojë më shumë rreth mundësisë sa më të drejtë të orientimit të studentëve, dhe punësimit të tyre në profesionin e tyre. Pasi që kontribuojnë në</p>

	mbrojtjen e shëndetit Publik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË INTEGRUARA TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare për të siguruar cilësinë e brendshme mbështetet në statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT), rregulloren e funksionimit të tij, rregulloren e Fakultetit dhe rregulloren e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Neni 103, pika 1.</p> <p>GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare respekton Statutin e UBT-së dhe ligjin e Arsimit të lartë, si dhe rregulloret e brendshme të cilësisë të cilët në aktet juridike parashohin metodat e mundshme për sigurimin e cilësisë. Në bazë të Informacionit të ofruar nga Fakulteti i Mjekësisë Veterinare para tre viteve është caktuar komisioni për vlerësimin e cilësisë së brendshme, por ky komision nuk ka dhënë ndonjë kontribut sa i përket sigurimit të cilësisë brendshme.</p> <p>GVJ rekomandon që të punohet më shumë në këtë drejtim.(419-Palet e angazhuara ne Sistemin e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf)</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës funksionon Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI). Pjesë e strukturës së kësaj dege është Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI). Në faqen uebofrohet edhe informacion i duhur për dokumentacionin e ofrimit të cilësisë. Kanë hartuar edhe manualin e Sigurimit të cilësisë, i cili është një dokument i rëndësishëm që përshkruan parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë për miratimin dhe vlerësimin e kurseve, programeve, njësisive në UBT.</p> <p>GVJ vlerëson se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare në bazë të dokumentacionit të ofruar, para tre viteve ka themeluar një komision, mandati i të cilit ka qenë të përplojë të sigurojë cilësinë e brendshme përmes mekanizmave mates, duke u mbështetur gjithmonë në Statutin e UBT-së dhe Ligjin e Arsimit të Lartë. Komisioni nuk ka krijuar mekanizma (përpilimin e rregulloreve), andaj rekomandohet që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare të themelojë Komisionin e ri që t'i përpilojë mekanizmat për matjen e cilësisë</p>

	<p>së brendshme.</p> <p>UBT-ja ka Degën e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, degë e së cilës është edhe Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional. Këto kanë krijuar manualin për sigurimin e cilësisë në kuadër të Universitetit.</p> <p><i>(Manuali i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, neni 23 të rregullores, pika 4, 5, 6 7 dhe 8)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka hartuar raportin e vlerësimit të brendshëm në vitin 2014 – 2015 dhe po në vitin 2015 është kryer një vizitë konsultative nga ekspertë të Shoqatës Evropiane e Institucioneve për Edukimin Veterinar (EAEVE), të cilët kryen një analizë sipas Sistemit European të Vlerësimit të Trajnimit Veterinar (ESEVT). Raporti i ekspertëve përbën një bazë të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së edukimit veterinary në kuadër të Fakultetit.</p> <p>GVJ konstatonqë Fakulteti ka bërë Vlerësimin e brendshëm 2014-2015. Po ashtu me kërkesë të tyre në vitin 2015 është kryer një vizitë konsultative nga ekspertë të Shoqatës Evropiane e Institucioneve për Edukimin Veterinar (EAEVE), ekspertët kanë nxjerr një raport, të cilat krijojnë mekanizma për zbatimin e këtyre rekomandimeve për arsye të sigurimi të cilësisë të programit të studimit.</p> <p>Fakulteti çdo semester para provimeve organizon pyetësor për cilësinë e mësimdhënies dhe për vlerësimin e performancës të Stafit Akademik. <i>(Raporti i vlerësimit të brendshëm, dhe SER_EAEVE)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional në Universitet merret me respektimin e standardeve për hartimin e dokumentacionit që rregullon realizimin e procesit mësimor në nivel Universiteti. Ajo kujdeset që dokumentacioni që prodhohet fakultetet të përputhet me standardet kombëtare të cilësisë sipas cikleve të studimit. Pavarësisht se disponohet baza ligjore dhe rregulloret përkatëse që garantojnë sigurimin e cilësisë së brendshme, shkalla e implementimit ende nuk është në nivelin e duhur.</p> <p>GVJ vlerëson që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, respektivisht UBT-ja ka krijuar mekanizma për sigurimin e cilësisë, rregulloret, manualin, duke u mbështetur në ligjet aktuale në fuqi. Mirëpo duhet të fillohet të punohet me të gjitha mekanizmat, vetëm që të sigurohet cilësia, dhe të implementohet rekomandimet e nxjerrura nga vlerësimet që iu bëhen mësimdhënjes, Stafit Akademik e studentëve përmes pyetësoreve të hartuara nga Zyra për sigurimin e Cilësisë në Kuadër të Universitetit Bujqësor të Tiranës.</p> <p><i>(Manuali i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë neni 24, pika 1, 2, 3, 4,)</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka të ngritur komisionin e vlerësimit dhe përmirësimit të kurrikulës. Gjithshtu, zv. Dekani për mësimin mbështet dhe orienton politikat për zhvillimin e monitorimin e kurrikulës së Fakultetit.</p> <p>GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare respektivisht Departamentet sëbashku me Zv/dekanin për mësim e monitorojnë procesin mësimor të programit të ciklit të dytë Msc në Mjekësi Veterinare, mirëpo duhet të punohet më shumë në këto kushte duke patur parasysh mendimet e të gjithëve si Stafit Akademik dhe Studentëve në interes të përmirësimit të Cilësisë së programit mësimor e shkencor.</p> <p><i>(Statuti UBT pika 4.1, rregullore e studimeve universitare dhe rregulloren mbi organizimin e funksionimin e degës së zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit institucional (DZHKKVI), specifikisht nenet 18-21)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në nivel universiteti funksionon zyra e zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit institucional, e cila ka hartuar rregulloren e njësisë së monitorimit të kurrikulës të miratuar nga strukturat përkatëse. Dega harton standardet e përgatitjes së kurrikulës, kontrollojnë ecurinë e zbatimit të saj, si dhe vlerëson propozimet mbi ndryshimet e mundëshme të programit mësimor.</p> <p>GVJ vlerëson që UBT- ja ka zyrën për zbatimin e cilësisë si degë zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit kanë rregulloret dhe manualin për mbajtjen e cilësisë apo zbatimin e kurrikulave të miratuara, po ashtu edhe Departamentet në kuadër të Fakultetit monitorojnë zbatimin e kurrikulës. Por ende duhet të bëhet më shumë në interes të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare në për zbatimin në përpikëri të kurrikulës, apo syllabuseve në bazë të përmbatjes që kanë.</p> <p><i>(Raportet e vlerësimit të aktiviteteve mësimor dhe kërkimor)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakultetit i Mjekësisë Veterinare në kuadër të Universitetit Bujqësor të Tiranës në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie ka një strukturë specifike në organogramën e saj që është DZHKKVI. Misioni i saj veç funksioneve të tjera është koordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor, si edhe proceseve të vetëvlerësimit të të gjitha njësive të UBT.</p> <p>GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare apo Universiteti Bujqësor i Tiranës ka mekanizma të cilët e monitorojnë procesin mësimor. Po ashtu studentët në bazë të dëshmimeve të ofruara dhe informacionit që kemi, kanë të drejt të plotësojnë pyetësorë si kopje fizike apo online për performancë e Stafit Akademik. Po ashtu disa mësimdhënës realizojnë pyetësor individual me studentët për ta vlerësuar lëndën të cilën e ligjërojnë.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në nenin 11, pikat 9, 11 të rregullores, njësia e zhvillimit të kurrikulave parashikon dokumentimin e vlerësimeve dhe njoftimin e gjetjeve tek autoritetet përgjegjëse e vendimmarrëse. Ky kriter që të implementohet duhet të përmisohet.</p> <p>GVJ vlerëson që Institucionet që merren me monitorimin dhe vlerësimin</p>

	e cilësisë në kuadër të UBT-së, duke u bazuar në Statutin dhe rregullortet në fuqi të gjitha rezultatet e raporteve iu bëhen të njohur Menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare.			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Stafi i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare vazhdimisht kontribuon në hartimin e raportit të vlerësimit që përmban gjetjet esenciale, përputhshmërinë me standardet kombëtare e ndërkombëtare, si edhe përshkruan masat për reduktimin e dobësive në lidhje me programin e studimit. Universiteti organizon sondazhe me studentët përmes pyetësorëve si dhe d merren masa për përmirësimin e cilësisë, në përputhje me rregulloren përkatëse të cilat dalin nga raportet e këtyre sondazheve. GVJ konstaton që raportet që dalin nga pyetësorët dhe sondazhet, në bazë të informacionit që kemi, merren masa adekuate për përmirësimin e cilësisë së programit të ciklit të dytë Msc në Mjekësi Veterinare, por duhet të bëhet akoma më shumë. <i>(443- Raporti vjetor i UBT_ MASR 2017-2018 Final.pdf)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësisia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Fakulteti i Mjekësisë Vetrinare ka themeluar komisionin e përhershëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë, por ky komision nuk ka të dhëna për aktivitetin e tij. Komisioni i ri që do të themelohet duhet të jetë funksional duke i zbatuar në përpikmëri rregulloret e brendshme dhe të hartojë vazhdimisht raporte periodike mbi aktivitetet dhe problematikat e evidentuara. Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka kryer procesin e vetëvlerësimit të brendshëm që nga viti 2014. Pastaj komisioni ad hoc, i cili kreu procesin e vetëvlerësimit e pasuar nga vizita konsultative e Eksperteve të EAVE-së, të cilët këta ekspert kanë hartuar edhe një raport me rekomandime. GVJ konstaton se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, komisioni për vlerësimin e cilësisë nuk ka funksionuar, në vitin 2014 kanë bërë një vetëvlerësim përshkak të vizitës konsultative të Ekspertëve të EAVE-së. Rekomandojmë që sa më pare të formohet komisioni që të monitoroj dhe të jetë në gjendje të përmirësimit të cilësisë së Programit cikli i dytë Msc në Mjekësi Veterinare. <i>(419-Palet e angazhuara ne Sistemin e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf, 513-SER_EAEVE_Raporti i vlerësimit)</i>
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare për ta realizuar e vlerësimin e programit të studimit është përdorur Analiza e SER_EAEVE, Raporti i vlerësimit si dhe raporti i vlerësimit APAAL. Po ashtu Fakulteti përdor metoda e instrumente të ndryshme të vlerësimit, të posaçme e të

<p>akademike të programit të studimit.</p>	<p>përshatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit siç janë puna mësimore-shkencore dhe Pyetësorët e studentëve. Dega zhvillimit të kurrikulave, karrierës dhe vlerësimit institucional harton standardet e përgatitjes së kurrikulës, kontrollon ecurinë e zbatimit të saj, si dhe vlerëson propozimet mbi ndryshimet e mundëshme të programit mësimor.</p> <p>GVJ vlerëson se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, edhe në bazë të takimeve me Stafin Akademik, studentët dhe Zyrtarët e zyrës për sigurimin e cilësisë, theksojnë që Fakulteti apo Universiteti Bujqësor i Tiranës, Dega e Kurrikulave dhe Zyra e cilësisë bëjnë pyetësor me studentët me qëllimin më të mirë të evitimit të problemeve dhe përmisimit të cilësisë, por duhet akoma të bëhet më shumë dhe të ndërhyhet në përmisimin e cilësisë së programit.</p> <p><i>(Rregullore e Degës Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional, Neni 9, pikat 1, 2, 3, 5, 6, 8)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare kryhet vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies përmes matjes së performances akademike, si dhe realizimi i pyetësorëve me studentë përpara sezonit të provimeve.</p> <p>GVJ konstaton që studentët i nënshtrohen shumicës së provimeve në fund të vitit akademik, po ashtu në bazë të pyetësorëve që i nënshtrohen studentët matet performance e mësimdhënies dhe Stafit Akademik. Aktualisht nuk ka provim të Shtetit për profesionin e Mjekut Veterinar.</p> <p><i>(417-Raport Performanca e QKA_2018.pdf, 397-Tabela permbledhese e performances akademike.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare në kuadër të vlerësimeve të bëra si dhe mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor vetëm vlerësimin e pyetësorëve të studentëve dhe informacionin e Qendrës së Karrierës, në kuadër të Panairit të Karrierës.</p> <p>GVJ vlerëson se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare sondazhet që kryhen nga studentët përmes pyetësorëve, po ashtu zyrtarja e qendrës së karrierës dhe alumni takimet që bëjnë me studentët, të dhënat që ipërpunojnë publikojnë.</p> <p><i>(522 -18_Foto të pjesëmarrjes në Panairin e Karrierës.pdf)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri I. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Politikat dhe procedurat e brendshme të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të cilësisë bazohen në planin strategjik dhe rregulloren e</p>

<p>dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>DZHKKVI. Statuti i UBT, neni 16, Plani strategjik i Universitetit në pikën 5.2 deri 5.6 parashikon mënyrat sigurimit dhe rritjes së cilësisë së brendshme duke përfshirë aktorët e brendshëm dhe ato të jashtëm. Në funksion të saj janë edhe nenet 22 dhe 23 të rregullores së DZHKKVI.</p> <p>GVJ konstaton që Fakulteti sa më pare duhet që të themelojë Komisionin për cilësi dhe të hartoj rregulloret e harmonizuara sipas ligjeve në fuqi që të garantoj përfshirjen e të gjithë akterëve në përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Në Kuadër të UBT-së që kanë hartuar planin strategjik kanë të përfshira politikat dhe procedurat e brendshme të vlerësimit.</p> <p><i>(4-AUT_Strategic Plan_2016-2025_English.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë veterinare ka të ngritur komisionin e përhershëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Po ashtu rregullorja e DZHKKVI, përcakton detyrat, funksionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Në bazë të Informacionit GVJ vlerëson që dega e zhvillimit të kurrikulave në kuadër të UBT-se ka rregulloret e veta që përcaktojnë hapat që duhet të merren nga aktorët që të sigurohet cilësia. Rekomandojmë që komisioni i Fakultetit të Mjekësisë Veterinare të jetë aktiv dhe të hartoj rregulloret sa më pare që të sigurohet cilësia e programit.</p> <p><i>(419- Palet e angazhuara ne Sistemin e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka të ngritur komisionin e përhershëm të sigurimit të brendshëm të cilësisë në të cilin bën pjesë edhe një student. Gjithashtu, Dekanati mbështet dhe orienton politikat për zhvillimin e monitorimin e kurrikulës së fakultetit dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Por komisioni duhet të jetë më aktiv dhe të hartojë raporte dhe rekomandime.</p> <p>GVJ konstaton që për të aktualizuar politikat, strategjinë me qëllim të përmirësimit të cilësisë, studentët iu nënshtrohet pyetësorëve që përgatiten nga Universiteti në matjen e performances së Stafit Akademik, por pjesëmarrja e studentëve është jo e kënaqshme.</p> <p>Po ashtu në kuadër të Fakultetit egziston komisioni për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të cilin bën pjesë edhe një student, ky komision duhet të jetë sa më aktiv, që të dalë me rekomandime me qëllim të përmirësimit të cilësisë.</p> <p><i>(419- Palet e angazhuara ne Sistemin e Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf)</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka respektuar integritetin akademik dhe ka shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit realizohet nga studentët e çdo kursi në mënyrë anonime duke ruajtur konfidencialitetin e tyre.</p> <p>GVJ vlerëson se në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, edhe në bazë dokumenteve aktuale, konstatohet që ruajtja e integritetit Akademik që bazohet edhe Statutin, gjatë matjes së performances së tyre përmes pyetësorëve nuk cenohet. <i>(419- Palet e angazhuara ne Sistemin e</i></p>

	<i>Sigurimit te Brendshem te Cilesise.pdf</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare që prej fillimit të studimeve i bën me dije studentëve rëndësinë e këtij profesioni duke ju treguar të gjitha rrugët e mundshme që ata të ndërgjegjësohen për përgjegjësitë që ata do të kenë. Po ashtu stafi akademik i angazhuar sipas lëndëve në organizon takime të hapura me grupe studentesh ku paraqet vështirësitë siç janë mungesë fondesh dhe infrastrukturë e kufizuar, duke kërkuar kështu sëbashku rrugët e mundshme për përmirësimin e cilësisë. GVJ konstaton se Fakulteti i Mjekësisë Veterinare dhe UBT-ja kanë bashkëpunime me institucione të tjera, mirëpo këto nuk ndikuar në ngritjen e cilësisë. Raporti i ekspertëve të EAEVE të realizuar nga vizita e tyre është një faktor i fort për ngritjen e cilësisë së programit të ciklit të dytë master në Mjekësi Veterinare.(513-8_SER_FVM_EAEVE.pdf)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nëse përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika e sigurimit të cilësisë në UBT është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionët e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Statutin e UBT-së dhe rregulloret përkatëse. (Plani Strategjik i Universitetit, pika 5.5). Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është e ngritur në nivel institucional; aktualisht Fakulteti i Mjekësisë Veterinare ka Komisionin e Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor. Gjithë ecuria e sigurimit të cilësisë jepet në raportet e punës mësimore shkencore (raportet e viteve 2017-2018).GVJ vlerëson se raportet e punës mësimore shkencore e dalura nga Zyra e Sigurimit të cilësisë në kuadër të UBT-së, bëhen transparente për të gjithë, po ashtu edhe diskutohen në mbledhjet e këshillit të Fakultetit dhe Senatit të Universitetit.(446-Raporti vjetor i UBT_ MASR 2017-2018 Final.pdf, 448-Analiza Mesimore FMV 2017-2018.pdf)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Në uebsite të UBT cdo vit publikohen rezultatet e vlerësimit të programit të studimit të FMV si pjesë e raportit përfundimtar në nivel institucional. GVJ konstaton që Fakulteti i Mjekësisë Veterinare publikon raportet, po ashtu gjenden edhe në Website të UBT-së rezultatet e vlerësimit të programit të studimit të FMV-së.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e	Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare i kushtohet një vëmendje e veçantë nga raportet mësimore – shkencore për sigurimin e cilësisë ku për cdo problematikë të paraqitur bëhet ky vlerësim duke përcaktuar

mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>një plan masash për përmirësimin e gjendjes</p> <p>GVJ vlerëson se gjatë raporteve dhe diskutimeve në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare edhe në Senatin e UBT-së nxirren masat përshtatshme që duhet përmirësohen, por në pjesën më të madhe ka vështirësi në realizimin e tyre, rekomandojmë që masat që dalin nga këto raporte duhet të merren seriozisht nga UBT-ja dhe Fakulteti i Mjekësisë Veterinare me qëllim të përmirësimit të cilësisë së programit. <i>(443- Raporti vjetor i UBT_ MASR 2017-2018 Final.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare që përmes Zyrës Alumni, të sigurojë të dhëna dhe të krijojë marrëdhënie bashkëpunimi me autoritetet e linjës (Ministria e Bujqësisë), Agjensitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe AKU për të siguruar efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Por komisioni i krijuar nuk ka funksionuar si duhet.</p> <p>GVJ vlerëson që Fakulteti Mjekësisë Veterinare ka komisionin për ngritjen e cilësisë që nuk është aktiv. Zyra e Karrieres dhe Alumni duke bashkëpunuar me Institucione të tjera dhe sondazheve të nxjerra nga pyetësorët sadopak ndikon në përmirësimin e imazhit dhe cilësisë të Fakultetit të Mjekësisë Veterinare. Por hapësira e punës praktike me kafshë kërkon më shumë përmirësime. <i>(418- Bordi ALUMNI.pdf)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtarj periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare ka një angazhim kohët e fundit të studentëve për të kërkuar nëpërmjet propozimeve të tyre përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. UBT ende nuk ka organizuar veprimtari periodike në nivel institucional me personelin dhe studentët, për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre, për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton që Stafi Akademik dhe Studentët njoftohen për mundësit që duhet të jenë me qëllim të përmirësimit të cilësisë.</p> <p>Nga takimet me Stafin Akademik dhe Studentët, u konstatua që përkrahja institucionale nuk është e kënaqshme sa i përket ndihmesës financiare, furnizimit me kimikate e pajisje me qëllim realiziminsat më të mirë praktikave në kuadër të programit që ndikojnë në ngritjen e cilësisë. Duhet të ketë me shumë iniciativa për bashkëpunim në nivel lokal dhe ndërkombëtar me partnerët tjerë për kërkim shkencor. Më shumë bashkëpunim me universitete Perëndimore mund të jenë të dobishme për ngritjen e standardeve. <i>(424- Marreveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit.pdf, 425 -Tabele permbledhese me institucionet bashkëpunuese, per programin e studimit.pdf)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të Integruartë studimit të ciklit dytë Master i Shkencave” në “Mjekësi Veterinare” në “Universitetin Bujqësor të Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

- 1) *Misioni i programit studimor* është në përputhje të plotë me misionin e institucionit dhe në përputhje me misionin e shtetit për integrim Evropian, përmes plotësimit të kritereve teknike të përafrimit të standardeve me ato të vendeve të BE e cila mund të realizohet vetëm me rritjen e kapaciteteve njerëzore në fusha teknike specifike;
- 2) *Vizioni i Fakultetit* rreth së ardhmes së institucionit dhe zhvillimit të programit është mjaft i qartë dhe realist;
- 3) *Programi i integruar i studimeve* në Mjekësi Veterinare është i vetmi i këtij lloji që ofrohet në vendin tonë.
- 4) *Organizimi i studimeve* në FMV është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë nga niveli i ciklit të dytë të integruar deri në nivelin e doktoraturës.
- 5) *Angazhimi i një stafi akademik* me përvojë dhe me moshë mesatare të re në realizimin e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- 6) *Interesimi i studentëve* për programin e propozuar të studimit;
- 7) *Reputacioni* pozitiv në komunitetin e jashtëm;
- 8) *Përvojë të mirë* në kërkimin dhe zbatimin e projekteve kërkimore;
- 9) *Ekzistenca* e disa laboratorëve kërkimorë, të pasur me pajisje dhe aparatura moderne laboratorike.
- 10) *Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar* me institucione vendase dhe universitete homologë europiane përmes realizimit të veprimtarive dhe projekteve të përbashkëta.

Pika të dobta

- 1) *Plan mësimor me problem* në shpërndarjen e krediteve dhe ngarkesës mësimore ndër semestra e vite në përputhje me rëndësinë e tyre në formimin profesional të studentëve; nevojë për një rishikim të thellë, për të vënë në raport të drejtë lëndët bazë profesionale me lëndët dytësore, dhe përafrim me modelet më të mira dhe të suksesshme rajonale/evropiane në fushën e veterinarisë (Modeli Hungarez, Kroat, Italian);
- 2) *Kufizimet buxhetore* si për realizimin e veprimtarisë mësimore ashtu edhe asaj shkencore, për përmirësimin e infrastruktures;
- 3) *Hapësira e kufizuar* (auditore të vjetëruar për zhvillimin e leksioneve) në objektin ku aktualisht operon Fakulteti i Mjekësisë Veterinare vështirëson arritjen e objektivit realizimin në përpikmëri të programit të studimit;
- 4) *Burime të kufizuara* në laboratorët e mësimdhënies (hapsira fizike dhe bazë materiale); numër i lartë studentësh në praktika dhe punët laboratorike (grupe me më shumë se 20 studentë); Kufizim në numër i punëve laboratorike (laboratore demonstrative) apo dhe mungesa e tyre e plotë në disa lëndë.
- 5) *Mungesa* e një spitali për të gjitha llojet e kafshëve, thertoreje dhe ferme të administruara nga FMV.



- 6) *Mungesa e politikave për trainimin e vazhdueshëm profesional të personelit ndihmës, dhe në ndonjë rast mungesa e personelit ndihmës dhe kryerja e rolin të tij nga pedagogu (laboratori i cilësisë së ushqimit);*
- 7) *Numri shumë i vogël i tezave të diplomës me karakter kërkimor (eksperimental), gjë që çënon formimin e plotë profesional dhe aftësimin e studentëve për të ndjekur studimet e thelluara të ciklit të tretë;*
- 8) *Praktika profesionale jo shumë efiçente, për shkak të mosfunksionimit si duhet të Komisionit të Praktikës dhe problemeve logjistike.*
- 9) *Ekzistenca e një sistemi të brishtë të sigurimit të cilësisë; mungesa e një programi të kontrollit të plagjaturës në nivel Departamenti dhe Fakulteti; mungesa e mekanizmave të adresimit të mendimit të studentëve në procesin e menaxhimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit;*
- 10) *Mungesa e provimit të licencës në kuadër të profesioneve të rregulluara, gjë që do të mundësonte njohjen e diplomës në tregun e punës vendas apo atë evropian.*
- 11) *Mungesa e studimevetë mirëfillta për nevojat e tregut të punës, dhe planifikimit vjetor të numrit të studentëve që pranohen në këtë program studimi (pranimi i një numri më të madh studentësh se sa nevojat e tregut).*

Rekomandime:

GVJ rekomandon sa me poshtë:

- 1) Të ristrukturohet Programi i integruar i MV, sipas modeleve evropiane, organizim i lëndëve në module dhe rishpërndarje e krediteve (Teza e diplomës duhet të pajiset me kredite), për të vënë në raport të drejtë lëndët bazë profesionale me lëndët dytësore, shpërndarjes së tyre në semestra, ashtu edhe të shlyerjes së detyrimit vjetor.
- 2) Të trajtohet cilësia e laboratoreve të mësimdhënies për të mbështetur mësimin e bazuar në praktike (si në infrastrukturë ashtu edhe në numrin e studentëve për punët në laborator).
- 3) Të merren në konsiderate dhe të trajtohen çështjet e vlerësimit të ngritura nga Anketimi i Studentëve, për të siguruar vlerësimin e metëjshëm. Të aktivizohet menjëherë komisioni për cilësi me qëllim të realizimit objektivave dhe cilësisë së Programit të FMV.
- 4) Të rritet cilësia e praktikave profesionale dhe të ndërtohen politika për ta bërë stafin akademik me të interesuar në ndjekjen e tyre.
- 5) Të mbështetet dhe promovohet kërkimi shkencor, si i studenteve (temat e diplomave duhet të kenë gjithnjë e më shumë karakter kërkimor) ashtu edhe i stafit akademik, me qëllim përmirësimin e formimit profesional në përputhje me zhvillimet e kohës.
- 6) Të rritet numri i marrveshjeve të bashkëpunimit me më shumë Institucione kërkimore dhe përfaqësues të biznesit vendas, për realizimin e praktikave të punësimit (internship) me synim punësimin e studentëve më të mirë.
- 7) Të punohet për të realizuar provimin e licencës, duke mundësuar njohjen e diplomës në tregun e punës vendas apo atë evropian.
- 8) Të pasurohet biblioteka me një numër më të madh titujsh tekstesh apo periodikësh në gjuhë të huaj.
- 9) Të hartohen politika të thithjes së një kontigjenti më cilësor të studentëve.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT		X		
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Dr. Valbona Aliko



Prof. As. Dr. Fatzim Latifi

